- Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”;
- VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit”.

2.3 *KUADRI LIGJOR SHQIPTAR PËR VNM*

Korniza ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM)¹ në Shqipëri bazohet në ligjin Nr. 10440 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, miratuar më 07.07.2011 dhe më vonë i ndryshuar / përditësuar me Ligjin Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Një aspekt i rëndësishëm ligjor për VNM është gjithashtu VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për rregullat, përgjegjësitë, afatet kohore për procedurën e VNM dhe procedurën e transferimit të vendimit për deklaratën mjedisore” e ndryshuar.

Në përgjithësi, procedura për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) në Shqipëri mund të përmbledhet në tri fazat e mëposhtme:

¹ Legjislacioni shqiptar i referohet shkurtimit VNM dhe jo VNMS. Në rastet kur i referohemi procedurës shqiptare, do të përdoret akronimi VNM. Në rastet kur i referohemi qasjes më të gjerë të projektit TEC Korça, do të përdoret akronimi VNMS.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- 1) **Faza e Shqyrtimit (Screening):** propozuesi duhet të kryejë një analizë të shqyrtimit të projektit të synuar bazuar në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (i ndryshuar)" për të kategorizuar paraprakisht projektin bazuar në Shtojcat e ligjit. Aplikanti duhet të dorëzojë një përkthim/raport paraprak të projektit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), e cila më pas e përcjell në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), me qëllim që të përcaktojë në mënyrë të duhur nëse projekti kërkon një VNM paraprake apo një VNM të thelluar. AKM gjithashtu komunikon me zhvilluesin për çështjet që duhet të analizohen me më shumë detaje në VNM-në e thelluar;

- 2) **Faza e Dëgjësës me Publikun:** ka si qëllim kryesor marrjen e deklaratës formale "pa kundërshtime" nga pushteti vendor (komunat, njësitë administrative dhe publiku). Për VNM-në e Thelluar ky proces përfshin hapat e mëposhtëm:
 - i) Propozuesi/Zhvilluesi dërgon një përmbledhje Jo-Teknike të VNM-së dhe plotëson formularin e dëgjësës/konsultimit me publikun. Këto dy dokumenta publikohen në faqen zyrtare të AKM-së dhe qëndrojnë minimalisht 20 ditë kalendarike në mënyrë që komuniteti lokal dhe publiku i interesuar ti shikojë dhe vlerësojë;
 - ii) Propozuesi/Zhvilluesi në bashkëpunim me AKM dhe Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM), organizon një Dëgjësë Publike ku ftohen pjesëmarrës nga Bashkia, Njësitë Administrative, komuniteti lokal dhe palët e tjera të interesuara mbi projektin e propozuar;
 - iii) Këshilli i Bashkisë shpreh mendimin e tij në lidhje me projektin dhe gjithashtu merren parasysh mendimet e dhëna nga Njësitë Administrative, komuniteti lokal dhe palët e tjera të interesuara;
 - iv) Sugjerimet, komentet, pyetjet dhe përgjigjet e dëgjësës me publikun regjistrohen dhe përfshihen në raportin e VNM-së së Thelluar.

- 3) **Miratimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM):**
 - i) Pas dorëzimit të raportit përfundimtar të VNM-së dhe vlerësimit nga ana e AKM-së, Ministria miraton deklaratën mjedisore për subjektin.
 - ii) Aplikimi për Lejen Mjedisore dërgohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), e cila më pas i përcjell dokumentat në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM-së);
 - iii) AKM shqyrton dokumentet dhe vlerësimet e saj, kryen vëzhgime në terren në bashkëpunim me DRM dhe përgatit kërkesat/opinionet mbi projektin duke përfshirë kërkesa specifike për lejen;
 - iv) Duke marrë në konsideratë opinionin e AKM-së, MTM miraton lejen dhe e dërgon atë në QKB, e cila më pas ia përcjell aplikantit.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

2.4 *Standardet dhe Udhëzimet më të mira ndërkombëtare*

Institucionet ndërkombëtare të huadhënies ofrojnë udhëzime për kërkesat e tyre për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe vendosin theksin në arritjen e rezultateve të qëndrueshme mjedisore, sociale dhe shëndetësore. Ato ofrojnë standarde mjedisore dhe kufizime për shkarkimet dhe emetimet. Gjithashtu janë të specifikuar një numër masash të rëndësishme për zbutjen e ndikimeve të projektit, si rizhvendosja (nëse është e nevojshme).

Projektimi i përgjithshëm i projektit të propozuar dhe kjo VNMS bazohen në udhëzimet përkatëse të publikuara nga Grupi i Bankës Botërore dhe Korporata Ndërkombëtare e Financimit (IFC) dhe për këtë arsye pritet të përmbushin kërkesat mjedisore të institucioneve potenciale huamarrëse. VNMS do të bazohet në të dhënat mjedisore, sociale dhe të tjera bazë, karakteristikat specifike të vendit dhe specifikimet teknike të projekteve dhe masat zbutëse si të zbatueshme për termocentralet në përputhje me Direktivat e BE-së, politikat e Bankës Botërore dhe Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë; Standardet e performancës së IFC dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe procedurat zyrtare. Si i tillë, është rënë dakord me IFC-në që projektet e zhvilluara në kuadër të këtij programi do të kërkohej t'i referohen Standardeve të Performancës.

Në paragrafin në vijim paraqitet një pasqyrë e Standardeve të Performancës. Dispozitat e aplikueshme nga këto dokumente do të identifikohen dhe përfshihen në raportin e VNMS, aty ku është e aplikueshme.

2.4.1 *Standardet e Performancës së IFC-së*

IFC zbaton Standardet e Performancës për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet sociale e mjedisore dhe për të rritur mundësitë e zhvillimit në sektorin privat. Standardet e Performancës mund të aplikohen nga institucione të tjera financiare që zgjedhin t'i zbatojnë ato në projekte në tregjet/vendet në zhvillim.

Së bashku, tetë Standardet e Performancës përcaktojnë standardet që një projekt duhet të përmbushë gjatë gjithë jetëgjatësisë së një investimi nga IFC ose institucione të tjera financiare përkatëse. Bazuar në Standardet e Performancës së IFC mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale, të miratuara më 1 Janar 2012, këto standarde të performancës mund të renditen si më poshtë:

- **Standardi i Performancës 1:** Vlerësimi i Ndikimeve dhe Menaxhimi i Rreziqeve Mjedisore dhe Sociale;
- **Standardi i Performancës 2:** Kushtet e Punonjësve dhe Kushtet e Punës;
- **Standardi i Performancës 3:** Eficenca e Burimeve dhe Parandalimi i Ndotjes;
- **Standardi i Performancës 4:** Shëndeti i Komunitetit dhe Siguria;
- **Standardi i Performancës 5:** Marrja e tokës dhe rizhvendosja e pavullnetshme;

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- **Standardi i Performancës 6:** Ruajta e biodiversitetit dhe menaxhimi i qendrueshëm i burimeve natyrore të gjalla;
- **Standardi i Performancës 7:** Popujt Indigjenë;
- **Standardi i Performancës 8:** Trashëgimnia Kulturore.

Në respekt të kërkesave të ligjit Shqiptar për VNM, aplikimi i Standardeve të IFC kërkon proceset e mëposhtme shtesë:

- 1) **Faza e Studimit (Scoping):** përfshin një proces ku zhvillohen konsultime me palët e interesuara në mënyrë që të identifikohen çështjet kryesore për tu investiguar si pjesë e procesit të VNMS. Në vazhdim, kryhet një identifikim paraprak i ndikimeve apo ndërveprimeve të mundshme të aktiviteteve të projektit me elementët mjedisorë ekzistues dhe aspektet sociale. Ky raport i studimit është përgatitur në zbatim të këtyre kërkesave për këtë fazë.
- 2) **Plani i Angazhimit me Palët e Interesuara:** paraqet një qasje gjithëpërfshirëse për komunikimin dhe konsultimin me palët e interesuara të identifikuara gjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së projektit.
- 3) **Focus në Çështjet Sociale:** ndërsa legjislacioni shqiptar kryesisht i referohet ndikimeve mjedisore, qasja e IFC-së fokusohet në identifikimin e ndikimeve të mundshme në komunitetin/et e ndikuara dhe përcaktimin e masave të nevojshme zbutëse.

2.4.2 Udhëzimet e Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë

Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (MSHS) janë dokumente teknike reference me shembuj të përgjithshëm dhe specifikë të praktikave të mira ndërkombëtare të industrisë (IFC, 2007). Këto Udhëzime të Përgjithshme janë hartuar për t'u përdorur së bashku me Udhëzimet përkatëse të Sektorit të Industrisë, të cilat ofrojnë udhëzime për përdoruesit për çështjet e MSHS në sektorë specifikë të industrisë. Për projekte komplekse mund të jetë e nevojshme përdorimi i udhëzimeve të shumta të sektorit të industrisë.

Udhëzimet e përgjithshme të MSHS janë të organizuara në 4 kategori të gjera, duke përfshirë Mjedisin, Shëndetin Profesional dhe Sigurinë, Shëndetin dhe Sigurinë e Komunitetit dhe Ndërtimin dhe Dekomisionin. Brenda secilës prej këtyre kategorive të gjera, është hartuar një listë me udhëzime më specifike.

Udhëzimet e tjera relevante për Sektorin MSHS për këtë projekt përfshijnë:

- Udhëzimet MSHS për Termocentralet;
- Udhëzimet MSHS për Shpërndarjen e Gazit (Prill 2007);
- Udhëzimet MSHS për Sistemet e Transmetimit të Energjisë Elektrike dhe Shpërndarjes (Prill 2007); dhe,
- Udhëzimet MSHS për Ujin dhe Kanalizimet (Dhjetor 2007).

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

2.4.3 *Dokumenti Referues i BAT (BREF) për Impiantet e Mëdha më Djegie²*

BREF janë dokumente udhëzuese që ofrojnë informacione për sektorë specifikë industrialë/bujqësorë në Bashkimin Europian, në lidhje me teknikat dhe proceset e përdorura në këto sektorë, emetimet dhe nivelet e lëjuara, teknikat që duhen marrë në konsideratë në përcaktimin e teknikave më të mira në dispozicion (BAT) dhe teknikave në zhvillim. Në përgjithësi, BREF për Impiantet e Mëdha me Djegie mbulon instalimet e impianteve djegëse me të dhëna termike hyrëse që tejkalojnë 50 MJ/s. Kjo përfshin industrinë e prodhimit të energjisë dhe ato industri ku përdoren lëndë djegëse konvencionale dhe ku njësitë e djegies nuk mbulohen nga një sektor tjetër BREF.

² Në përmbushje të Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) (Rishqyrtuar).

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

3 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 HYRJE

IVICOM Consulting propozon të zhvillojë një termocentral me gaz me fuqi 500 MË pranë qytetit të Korçës, i cili do të prodhonte dhe furnizonte me energji rrjetin kombëtar të energjisë në Shqipëri. Gazi do të prokurohet në nivel lokal dhe do të furnizohet përmes një linje të dedikuar tubacioni rreth 2.1 km nga tubacioni i Projektit TAP.

Kapitulli në vijim ofron një përmbledhje të shkurtër të projektit të propozuar dhe aktiviteteve të lidhura me të.

3.2 PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

3.2.1 Komponentët e Projektit

Termocentrali i propozuar do të jetë një impiant me cikël të kombinuar kogjenerimi (CCCPP) i cili përbëhet nga komponentët dhe specifikimet e listuara më poshtë:


- 500 MW termocentral me gaz (CCCPT);
- 2.1 km tubacion në veri të zonës së propozuar për ndërtimin e TEC-it për të mundësuar furnizimin me gaz nga Projekti Trans Adriatic Pipeline (TAP);
- 11.2 km linjë dyfishe transmetimi 400 kV për lidhjen e TEC Korçë me nënstacioni ekzistues në Zëmlak;
- rehabilitimi i dy rrugëve të aksesit për qëllime shërbimi, rruga hyrëse 1 me gjatësi 2550 m dhe rruga hyrëse 2 me gjatësi 160 m.
- Uji hyrës për procesin e ftohjes së TEC-it do të merret nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane në afërsi të zonës së propozuar dhe në rast emergjence do të përdoren dy puse brenda zonës së projektit;
- 80 MW për prodhimin e avullit të ngrohtë, i cili do të sigurojë ngrohjen qëndrore të qytetit të Korçës në të ardhmen;
- 5 MW për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

Energjia e gjeneruar në impiant do të transmetohet nëpërmjet linjës së dyfishtë 400 kV në stacionin ekzistues të energjisë NS Zëmlak dhe do të prodhojë 500 MWe. Ndër avantazhet e tjera (p.sh. zvogëlimi i humbjeve të linjës, sigurimi i kapaciteteve shtesë dhe sigurimi i një burimi alternativ të energjisë për sektorin energjetik shqiptar), energjia e gjeneruar nga ky Projekt pritet të lehtësojë operacionet e rrjetit në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të tensionit dhe stabilitetit të sistemit.

Në hartën e mëposhtme paraqitet një Projektim Konceptual Paraprak i TEC Korçës.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 3.1 Projektimi konceptual paraprak i TEC Korçë



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

3.2.2 *Përshkrimi Teknik i TEC-it dhe Proceset e Impiantit*

TEC-i i i Korçës do të prodhojë energji elektrike në kapacitet prej 500 MW, si dhe prodhimin e avullit prej maksimum 80 MW për ngrohjen qendrore të qytetit të Korçës (DH). Gjithashtu do të kemi një prodhim të përhershëm prej rreth 6 MW për ujin e ngrohtë sanitar. Të dhënat për ujin e ngrohtë për projektimin për dimër DH: hyrje 60-70°C, dalje maksimumi 130°C, fuqi 80 MWt. Të dhënat për ujin e nxehtë për projektimin për verë DH: hyrje 50- 60°C, dalje maksimumi 70°C, fuqi 4 -8 MWt.

Impianti do të operojë me gaz natyror i cili do të furnizohet nëpërmjet linjës së lidhjes së tubacionit të gazit. Do të sigurohen edhe lehtësira për filtrimin, matjen, ngrohjen dhe zvogëlimin e presionit të furnizimit me lëndë djegëse. Sistemi me cikël të kombinuar me bosht të vetëm është zgjedhur si teknologji e përshtatshme për termocentralin. Ai përbëhet nga një turbinë gazi, një turbinë me avull, dhe një gjenerator me avull për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG), me turbinë gazi dhe turbinë me avull të lidhura në secilën anë të gjeneratorit turbo të vetëm për të formuar një linjë me bosht të vetëm. Avantazhi kryesor i teknologjisë me bosht të vetëm është lehtësia e tij në operim, e cila rrit besueshmërinë me 1% më shumë në krahasim me blloqet me shumë boshte. Fleksibiliteti operacional vjen nga fakti se turbina me avull mund të shpëputet, duke përdorur një shtrëngim vetë-sinkronizues gjatë fillimit ose për operimin e ciklit të thjeshtë të turbinës së gazit.

Për sa i përket investimit të përgjithshëm, kostoja fillestare e boshtit të vetëm është më e ulët se teknologjia me boshte të shumta. Impiantet me bosht të vetëm arrijnë kursime si për njësinë e fuqisë edhe për balancën e impiantit. Kostot e njësisë së fuqisë kursehen me anë të reduktimit të pajisjeve elektrike: në këtë rast, nevojitet vetëm një gjenerator, një tub përcjellës dhe një transformator ngritës. Kursimet për balancën e impiantit vijnë nga kostot e ulëta ndërtimore dhe strukturore për shkak të një teknologjisë kompakte krahasuar me teknologjinë me boshte të shumta.

Projekti Konceptual Paraprak paraqet një përshkrim të shkurtër të komponentëve dhe sistemeve kryesore të termocentralit. Ky impiant energjie përfshin një modul me bosht të vetëm 1+1 të përbërë nga Turbina e Gazit N.1, turbina me avull për rikuperimin e energjisë N.1, turbina me avull N.1 e lidhur me kondensator sipërfaqësor; Turbina e Gazit dhe Turbina e Avullit lidhen në një gjenerator elektrik me ftohje hidrogjeni.

Sistemi i impiantit elektrik do të projektohet duke marrë në konsideratë pajisje të përshtatshme ndihmëse, burimin rezervë të energjisë dhe pajisjet e mbrojtjes për të siguruar vazhdimësinë maksimale të shërbimit dhe gjithashtu për të siguruar veprimtarinë e pajisjes themelore gjatë kushteve të emergjencave. Shpërndarja e energjisë elektrike në ndihmësit e impiantit do të konsistojë në katër nën-sisteme kryesore:

- Furnizimi me energji të AC;
- Furnizimi me energji DC vitale për furnizimin me energji të AC;
- Furnizimi në rast emergjencash.

Lidhje kryesore për operacionet e impiantit janë:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		


- Qarkullimi i ujit në hyrje dhe dalje të tubacionit drejt kondensatorit dhe sistemit të mbyllur të ujit ftohës;
- Gazi natyror i furnizuar nga tubacioni kombëtar i presionit të lartë;
- Lidhja me rrjetin elektrik HV (tension i lartë); uji për qëllime industriale i furnizuar nga burime vendore të jashtme;
- Ujë higjeno-sanitar (ujë i pijshëm), i furnizuar nga burime lokale të jashtme;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura.

TEC-i do të llogaritet mbi bazën e të dhënave të mëposhtme për gazin në hyrje. Bojlerët e ujit të nxehtë do të llogariten mbi bazën e të dhënave të mëposhtme për gazin në hyrje dhe vetëm në emergjencë në hyrjet e mëposhtme të të dhënave për lëndën djegëse të lehtë ekstra. Godinat kryesore dhe sistemet brenda zonës së projektit janë:

- Dhoma kryesore e kontrollit dhe Godina Elektrike;
- Godina e qëndrimit për zhvillimin e takimeve;
- Impianti i trajtimit të ujit;
- Kompresor / godina e pompës zjarrfikëse;
- Impianti i pastrimit me lëndë të kondensuar;
- Pompat e furnizimit me ujë;
- Godina e pompës së ujit dhe ajo elektrike;
- Konteinerë mbajtës H₂;
- Kabina;
- Zona e pikës së furnizimit me lëndë djegëse;
- Sistemi monitorimit të emetimeve;
- Seti DG i Emergjencës;
- Sistemi i kampionimit;
- Godina e administratës dhe kontrollit.

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 3.2 Planimetria e skemës së TEC Korçë



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		


Balanca e termocentralit me gaz

Në vazhdim, termocentrali me gaz në Korçë do të përbëhet nga komponentët dhe pajisjet e tjera ndihmëse si:

- Sistem by-pass për avullin;
- Sistemi kryesor për avullin dhe sistemi ndihmës për avullin;
- Sistemi për ujin hyrës (të nevojshëm për procesin teknologjik);
- Sistem vakumi;
- Sistem dranazhimi;
- Sistem uji për ftohje me cikël të mbyllur;
- Sistem ngrohje, ventilim dhe ajër kondicionimi (HVAC);
- Vinça dhe sisteme ngritëse;
- Sistem për ruajtjen e gazeve dhe shpërndarjen e tyre;
- Sistem marrje mostrash;
- Laborator kimik;
- Impiant demineralizimi dhe filtrimi për ujin e kondensuar;
- Impiant për ujin hyrës;
- Stacion për reduktimin e presionit të gazit, filtrimin, matjen dhe ngrohjen;
- Kulla ftohëse hibride me pompa uji për ftohje;
- Impiant për trajtimin e ujit të ndotur;
- Sistem për hedhjen e kimikateve;
- Stacion për ajrin e kompresuar;
- Godina e komandimit të termocentralit;
- Sistem uji kundër zjarrit;
- Sistem dedektimi dhe alarmi;
- Zjarrfikëse.

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 3.3 Planimetri e zonës ku do ndërtohet TEC Korçë



Sistemi Ndhmës i Bojlerit për Ngrohjen e Ujit (80 MWt) dhe Stacioni i Pompave


Një impiant ndihmës i bojlerit për prodhimin e ujit të ngrohtë është planifikuar për të mundësuar prodhimin e pavarur të ngrohjes në rastet kur TEC-i është jashtë funksionit. Sistemi i bojlerit do të përbëhet nga 5 njësi bojlerësh. Katër njësi do të kenë prodhim nominal prej përafërsisht 18.5 MW (për ngrohje qendrore) dhe një njësi do të ketë prodhim nominal prej përafërsisht 6 MW (për ngrohjen e ujit sanitar). Kështu fuqia totale do të jetë 80 MWt.

Të gjitha njësitë e dhomave do të vendosen në të njëjtën godinë bojleri. Çdo njësi bojleri do të lidhet me oxhakun e vet të lartë prej 30 m. Centrali ndihmës i bojlerit dhe Stacioni i Pompimit do të vendosen në jug të njësisë kryesore. Në stacionin e pompës janë planifikuar të instalohen dy ngrohësa të ujit, 40 MW secila, faza e parë dhe e dytë e pompave të ujit të nxehtë, rezervuari i ujit hyrës dhe rezervuari i ujit në dalje. Rezervuari i ujit hyrës dhe rezervuari i ujit në dalje do të sigurojnë ujë të mjaftueshëm për procesin.

Stacioni i reduktimit të gazit do të zvogëlojë presionin e gazit deri në përafërsisht 1 bar (presioni i kërkuar për ndezësit e bojlerit). Një rezervuar për ruajtje 5 ditore të vajit të lehtë (vetëm si lëndë djegëse rezervë) me stacionin e shkarkimit do të vendoset në anën e djathtë të godinës së bojlerit.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 3.4 Planimetri e Bojlerit për Ngrohjen e Ujit



Principet e TEC-it të Korçës (CCPP)


Kogenerimi është një teknikë ku prodhimi i nxehtësisë dhe energjisë elektrike ndodh në një proces të vetëm ose në termocentral. Një termocentral modern që prodhin energji nga lëndët fosile (në rastin në fjalë lëndë djegëse është gaz) transformon rreth 60% të përmbajtjes së energjisë primare të lëndës djegëse në energji elektrike dhe çliron pjesën tjetër si prodhim të nxehtësisë. Kogenerimi ose kombinimi i nxehtësisë dhe energjisë (CHP), përdor një pjesë të kësaj nxehtësie për të plotësuar një kërkesë për ngrohje, e cila përndryshe do të kërkonte energji nga një burim tjetër, zakonisht një lëndë djegëse tjetër. Ngrohja është shpesh në formën e gazeve të nxehtë të shkarkimit, avullit dhe/apo ujit të nxehtë. CHP kështu përmirëson efikasitetin e përgjithshëm të përdorimit të lëndës djegëse dhe kursen në energji primare në krahasim me prodhimin konvencional të veçantë (të ndarë) të energjisë dhe ngrohjes, por më shumë, kur përmbajtja e karbonit të nxehtësisë së harxhuar shqyrtohet nga pikëpamja e parimeve termodinamike, rezulton të jetë në mënyrë të konsiderueshme më pak se sa mënyrat e tjera të sigurimit të nxehtësisë.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Në Sistemet me Cikël të Kombinuar Kogjenerimi (CCCPP) energjia e lëndës djegëse konvertohet pas krijimit të punës mekanike në energji elektrike dhe fuqi termike të avullit. Termocentralet më cikël të thjeshtë ose të ndarë përbëhen nga një turbinë me gaz që është e lidhur me gjeneratorin elektrik dhe prodhon energji elektrike. Cikli i thjeshtë ka një efikasitet të ulët dhe në rastin tonë për TEC Korçën përmirësohet me anë të ciklit të kombinuar CCCPP në të cilin:

- Gjeneratori i avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG) kap ngrohjen e shkarkimit nga turbina me gaz (që përndryshe do të shpëtontë përmes kullës së shkarkimit) dhe krijon avull duke e dërguar atë në turbinën e avullit.
- Turbina me avull i dërgon energji shtesë boshtit të gjeneratorit ku konvertohet në energji shtesë dhe në procesin e kogenerimit, të parashikuar për Korçën, pasi janë kryer punët mekanike të një pjese të avullit, ai nxirret/ekstraktohet dhe përdoret si burim nxehtësie për ngrohjen e ujit për ngrohjen qendrore.

Figura 3.5 Pamje ilustruese e një sistemi CCCPP dhe principet e tij




Pjesët kryesore të termocentralit të propozuar (CCCPP) janë:

- 1) **Turbina e gazit** - Përzierjet e gazit natyror dhe ajrit digjen në dhomën e djegies së turbinës së gazit (GT). Për shkak të djegies së njëpasnjëshme turbina e gazit GT ka veti të shkëlqyera kur punon me ngarkesë të pjesshme. Ngarkesa minimale e impiantit me cikël të kombinuar të energjisë elektrike në përputhje me kufijtë e lejuara të emetimeve, mund të arrijë 40% ose edhe më poshtë. TEC-i mund të

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		


operohet nën ngarkesën e impiantit me 20% pa djegësin e njëpasnjëshëm SEV (Sequential Environmental Combustor) në punë gjatë fazës së funksionimit.

Figura 3.6 Përzierja e gazit natyror dhe ajrit në turbinën e gazit gjatë diegjes së njëpasnjëshme



Një tjetër turbinë e mundshme për ndërtim (djegie jo e njëpasnjëshme).

Figura 3.7 Turbina e gazit me diegie jo të njëpasnjëshme



- 2) **Turbina e Avullit** - Turbina e avullit është e një përbërje të kryqëzuar, me tre cilindra të llojit reagues/bashkëveprues; ajo përbëhet nga një seksion i vetëm i presionit të lartë të rrjedhës (HP), një seksion i vetëm i presionit të ndërmjetëm të rrjedhës (IP)


			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

dhe një seksion me presion të ulët (LP) me shkarkim lateral/anësor. Fluksi i avullit rrjedh nga gjeneratori i avullit të rikuperimit të nxehtësisë nëpërmjet valvulës së ndalimit dhe kontrollit më anë të difuzorit në seksionin e turbinës HP, ku zgjerohet përmes reaksionit të reagimit për shkak të rinxehjes së presionit të ftohtë. Pas largimit të seksionit HP përmes lidhjes së shkarkimit, e vendosur në gjysmën e poshtme të shtresës së jashtme, avulli rrjedh në riedukues përmes linjës së ngrohjes së ftohtë. Më pas avulli rrjedh përmes linjës së ngrohjes së nxehtë, futet në seksionin IP përmes dy valvulave të kombinuara të ndalimit dhe kontrollit dhe kalon bllokimin e reaksionit të seksionit IP.

Avulli LP pranohet në shkarkimin e seksionit të IP dhe përzihet me avullin e zgjeruar në seksionin IP. Pasi largohet nga seksioni IP, avulli përmes tubave të kryqëzuar, hyn në seksionin LP ku edhe zgjerohet deri në arritjen e presionin e kondensatorit.

Kondesatori i ftohjes së ujit - Qëllimi kryesor i një kondesatori sipërfaqësor është që të kondensojë avullin e shkarkimit që vjen nga seksion LP (Loë pressure – presion i ulët) i turbinës së avullit (ose të anashkalojë) për të marrë ujë të kondensuar kështu që të mund të ushqehet në gjeneratorin e avullit të rikuperimit të nxehtësisë përmes pompave të nxjerrjes së kondesimit.

Figura 3.8 Kondesatori i ftohësit të ujit



- 3) **Gjeneratori i avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG)** - HRSG gjeneron avull për turbinën e avullit, duke shfrytëzuar nxehtësinë e larguar nga shkarkimi i turbinës së gazit (GT). HRSG do të jetë me presion të trefishtë, me rregullim horizontal, qarkullim natyror, mbështetur në llojin më të avancuar, me porta të mëdha avulli dhe për instalim në natyrë.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 3.9 Pamje e gjeneratorit të avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG)



- 4) **Gjenerator i zakonshëm për Turbinën me Gaz dhe Avull** - Gjeneratori sinkron 2-polësh me 3 faza është një makineri e vetë-ajrim (ventilim) në sajë të helikave aksiale të vendosura në rotorin dhe kanalet e ventilimit të shpërndara në mënyrë adekuate në qendrën e statorit ftohës dhe në brendësi të dhomave. Këmbyesit e hidrogjenit / ujit të vendosur në mënyrë vertikale në fundet kornizave, ftojnë hidrogjenin e ngrohtë, të nxehur në makineri.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 3.10 Planimetria e një gjeneratori të zakonshëm për turbinën e gazit dhe turbinën e avullit





Figura 3.11 Pamje 3-D e TEC Korçës



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

3.3 FAZAT E PROJEKTIT

Aktivitetet e Projektit do të kryhen në tre faza të përshkuara në paragrafet më poshtë.

3.3.1 Faza e ndërtimit

Faza fillestare e ndërtimit do të përfshijë pastrimin e vegjetacionit, rrethimin dhe nivelimin e vendit, si dhe punimet e gjurmimit. Aksesit të zonës së propozuar do të kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të rrugëve ekzistuese të zonës për të ndihmuar lëvizjen e makinerive të rënda, automjeteve, kamionëve dhe transportin e pajisjeve të TEC-it gjatë fazës së ndërtimit. Do të rehabilitohen dy seksione të shkurtra rrugë, Rruga e aksesit Nr. 1 me gjatësi 2550 m dhe Rruga e aksesit Nr. 2 me gjatësi 160 m, të cilat do të përfundojnë gjatë periudhës së përgatitjes së zonës për ndërtim, duke marrë parasysh gjatësinë e tyre të shkurtër.

Tubacioni i gazit do të shtrohet brenda muajve të parë të punimeve ndërtimore dhe lidhja e gazsjellësit me termocentralin do të ndodhë në muajt e fundit të kësaj faze. Gjatë së njëjtës faze do të kryhet ndërtimi i linjës së dyfishtë të transmetimit 400 kV e cila do të lidhë termocentralin me nënstacionin Zëmlak. Komponentët e ndryshëm të projektit (TEC-it) do të shpërndahen, montohen/ bashkohen dhe ndërtohen në zonën e kantierit gjatë një faze të vetme. Ndërtimi i njësisë kryesore, turbina me gaz, turbina me avull, kondensatori, HRSG, gjeneratorët, transformatorët, godina ndihmëse e bojlerit me ujë të ngrohtë do të fillojnë të ndërtohen në të njëjtën periudhë, por kohëzgjatja e punimeve dhe montimi do të ndryshojnë në bazë të kërkesave specifike të secilit komponent apo pajisje të TEC-it.

Me kalimin e muajve dhe ndërtimit të objekteve, aktiviteti i në kantier do të zvogëlohet pasi Projekti të kalojë në fazën e para-komisionimit dhe komisionimit ku do të ketë një grup të vogël inxhinierësh dhe teknikësh shumë të kualifikuar që do të kryejnë provat dhe autorizojnë fillimin e punës për termocentralin.

3.3.2 Faza e funksionimit

Termocentrali është projektuar për të punuar minimalisht 7500 orë në vit dhe më shumë për një jetëgjatësi shërbimi prej 200,000 orë pune. Impianti është projektuar për të arritur një shkallë të lartë të automatizimit dhe operimit të centralizuar duke përdorur një Sistem Kontrolli të Shpërndarë për operimin dhe kontrollin e TEC-it. Impianti do të projektohet për funksionim nga një numër i konsiderueshëm punonjësish të operimit dhe mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat për besueshmëri, siguri, fleksibilitet operacional dhe praktikë më të mira.

Teknologjia e parashikuar është BAT (Teknikat më të mira të disponueshme) dhe BREF (Dokument referencë i BAT), që përdor teknologjinë e gjenerimit të energjisë së pastër sipas sistemeve të gjenerimit të lëndëve djegëse më efikase, me kosto efektive dhe më pak të dëmshme për mjedisin. Impianti do të pajtohet me të gjitha kërkesat ligjore të publikuara

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

dhe të zbatueshme në Standardin Ndërkombëtar, veçanërisht ligjet mjedisore për shkarkimet e gazta, të lëngëta, emetimet e zhurmave, gjenerimin e mbetjeve, sigurisë së personelit dhe lejeve të ndërtimit. Ngarkesa minimale në impiant përcaktohet me teknologjinë BAT dhe emetimet në ajër. Impianti do të projektohet për të qenë në përputhje me të gjithë kërkesat dhe kushtet e detyrueshme të vendosura nga menaxheri i rrjetit elektrik për lidhjen e impiantit me rrjetin elektrik kombëtar.

Në kushte emergjence, impianti do të funksionojë me Turbinë Avulli (ST) jashtë shërbimi, Turbinë Gazi (GT) në operim, dhe avull të prodhuar nga HRSG-të duke kaluar në kondensator. Impianti do të mund të operojë në të gjitha kushtet klimatike të zonës, duke përmbyshur kërkesat e të gjithë klientëve, shkarkimin / shpërndarjen e ngarkesës, fillimin e punës, mbyllja e kontrolluar dhe transmetimin. Impianti do të mund të ndizet, fiket, operojë dhe të mirëmbahet në gjendje të fikur pa dëmtime, në të gjitha kushtet mjedisore të parashikuara në zonë për jetëgjatësinë e projektit të TEC.

Gjatë operacioneve të marrjes dhe vendosjes së makinerive / pajisjeve do të ketë rritje të trafikut në zonë pasi impianti do të kërkojë një shumëllojshmëri shërbimesh. Ky fluks pune do të rritet gjatë periudhave të mbylljeve vjetore dhe periudhave të mirëmbajtjes në shkallë të lartë. Numri i hapjeve të mundësive për punë gjatë fazës së ndërtimit do të jetë përafërsisht 600, duke përfshirë punonjësit dhe nënkontraktimin e kompanive lokale. Gjatë operimit është parashikuar që do të ketë përafërsisht 123 punonjës për operimin e impiantit, mirëmbajtjen në të ardhmen dhe rregullimin periodik vjetor të impiantit.

Përdorimi i Ujit

Projekti është shumë efikas në përdorimin e ujit. Kërkesa për ujë teknologjik për procesin e ftohjes do të jetë 12.5 m³/orë (sipas projektit) dhe 4 m³/orë. Burimi kryesor për sigurimin e ujit teknologjik do të jetë impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Korçë i cili ndodhet pranë vendndodhjes TEC-it dhe dy puseve shtesë që do të përdoren vetëm në rast emergjence.

Vetëm nevoja për ujë të pijshëm do të sigurohet nga rrjeti i furnizimit me ujë të qytetit të Korçës. Kërkesat për ujë (për kullat e ftohjes dhe sistemin e ftohjes së mbyllur, si dhe kërkesa për ujë për të gjitha proceset e tjera) gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të propozuar do të sigurohen nga uji i trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe përdorimi i ujërave nëntokësore si burim rezervë uji (vetëm në rast emergjence do të nxjerr ujë nga dy puset në zonë). Kërkesa totale për ujin për ftohje gjatë verës nevojitet të jetë në kufirin e 30°C dhe lagështia Relative (RH) 50% do të jetë 460 m³/orë (128 l/s). Pas procesit të ftohjes në lumin pranë do të shkarkohet rreth 20% e sasisë totale të ujit për ftohje, e cila do të jetë rreth 25 l/s. Temperatura e ujit të shkarkuar do të varet nga temperatura atmosferike dhe do të jetë më e lartë për rreth 10°C. Uji pastaj do të përpunohet në impiantin e trajtimit të ujit për të përmbyshur kërkesat e ndryshme të impiantit. Kapaciteti i puseve do të jetë 20-30 l/s secili. Kapaciteti total i impiantit të ujërave të ndotura në 2016 ishte 4,407,813 m³ dhe një mesatare mujore prej 139 l/s.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Trajtimi i Ujit

Ujërat e ndotura të gjeneruara nga veprimtaria e TEC Korçë mund të përfshijnë:

- ujërat e ndotura nga sistemi i trajtimit të ujit;
- ujërat e ndotura nga pompat e vajit të lëndës djegëse, të cilat mund të përmbajnë vaj;
- ujërat e ndotura shtëpiake nga kuzhina dhe kanalizimet.

Sasia e përafërt e ujërave të ndotura urbane (ose ujëra të zeza) do të jetë 15 m³/h. Të gjithë efluentët dhe sasi të ujërave të ndotura urbane do të ndahen dhe do të dërgohen në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur për trajtim dhe/apo depozitim. Ujërat e ndotura urbane nuk do të shkarkohen pa trajtim paraprak.

Emetimet, Efluentët dhe Mbetjet e Ngurta

Funksionimi i impiantit të propozuar mund të rezultojë në emetime potenciale të SO₂, NO_x, CO₂, VOC-ve dhe grimcave të ngurta në ajër. Megjithatë, turbinat me gaz do të jenë të pajisura plotësisht me një sistem ftohës spërkatës (sprinkler) për të rritur prodhimin e impiantit, i cili njëkohësisht redukton temperaturën e gazeve të shkarkimeve dhe do të rezultojë në reduktim të ndjeshëm të emetimeve të NO_x. Për më tepër, pritet që emetimet e gazeve të impiantit të jenë brenda niveleve të lejueshme të shkarkimeve për gazet në përputhje me Direktivat e BE-së, Standardet e IFC dhe ligjet shqiptare.

Burimet kryesore të ndikimeve të mundshme në cilësinë e ajrit të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit të projektit të propozuar janë paraqitur më poshtë:

- Gjenerimi i pluhurave për shkak të përgatitjes së zonës së kantierit, punimeve të gjermimit, dhe lëvizjes së makinerive dhe automjeteve;
- Emetime potenciale të SO₂, NO_x, VOC dhe PM₁₀ nga makineritë e ndërtimit dhe automjetet, si dhe nga gjeneratorët statikë që përdoren për prodhim energjie;
- Emetime potenciale të tymit gjatë saldimit dhe VOC-ve nga punimet e saldimit të tubave, pastrimit të sipërfaqeve dhe lyerjes me bojë;
- Emetime potenciale nga magazinimi i lëndëve djegëse, vajrave lubrifikues dhe kimikateve të tjera që çlirojnë VOC.

Gjatë fazës së funksionimit, shkarkimet në ajër do të jenë kryesisht nga burime pikësore stacionare, burimet e lëvizshme dhe burimet fugjitive të emetimeve. Burimet e pikësore stacionare do të përfshijnë kullat e bashkangjitur me Gjeneratorët dhe njësitë HRSG. Burimet e emetimeve fugjitive përfshijnë depozitat, valvolat, fllanxhat dhe lidhjet e tubave. Burimet e lëvizshme përfshijnë automjetet e përdorura për transportin e punëtorëve dhe të materialeve. Ndotësit kryesorë të lëshuar nga burime të tilla përfshijnë NO_x, SO₂, CO, PM₁₀, UHC dhe Komponimet Organike të Avullueshme (VOCs). Më shumë detaje për shkarkimet e gazeve, sasi të tyre dhe përqëndrimet do të përfshihen në fazën e vlerësimit të ndikimeve për procesin e VNMS.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Gjatë ndërtimit, sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara do të jenë dherat natyralë të tepërt nga procesi i gërmimit. Në lidhje me llojet kryesore të mbetjeve që mund të gjenerohen ato përfshijnë mbetjet ushqimore, mbetjet e zyrave, materiale organike, mbetje të ambalazheve të materialeve (plastike, letër, karton, etj), mbetje të vajra për lubrifikim dhe materiale paketimi, etj.

Gjatë funksionimit, sasitë kryesore të mbetjeve të ngurta parashikohen që të jenë mbetjet e gjeneruara nga përdorimi i kimikateve në impiantin e demineralizimit (De-Mi ëater) dhe mbetjet e zyrës, duke përfshirë kartonin/letrën, qelqin, mbetjet ushqimore dhe kanaçet. Impianti nuk do të lejohet që të kryejë shkarkime të pakontrolluara të ujërave në mjedis. Është parashikuar që sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme do të gjenerohen në formën e mbetjeve të vajrave/karburanteve, solventë pastrues dhe llum nga rezervuarët e vajit. I gjithë vaji i përdorur do të mblidhet dhe largohet nga vendi dhe do të dorëzohet tek një kompani riciklimi e aprovuar. Së fundi, të gjitha mbetjet e lidhura me punëtorinë do të mblidhen dhe largohen nga vendi i Projektit në vendet e miratuara të depozitimit të mbetjeve. Mbledhja, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i këtyre mbetjeve do të diskutohet në detaje në fazën e vlerësimit të ndikimeve në mjedis për VNMS.

Shkarkimet aksidentale në zonat e ndërtimit mund të rezultojnë kryesisht nga derdhjet gjatë ngarkim-shkarkimit, transportimit dhe përdorimit të materialeve të rrezikshme. Pastrimi i derdhjeve të tilla gjeneron dhera të ndotur, rrobat e lagura me vaj dhe spastrime të dysHEMEVE. Në rastet kur përdoren bombola të gazit të ngjeshur ose gazra saldimi, ekziston mundësia e rrjedhjeve aksidentale gjatë ruajtjes dhe përdorimit.

Rreziqet e lidhura me HSD dhe përdorimin e Gazit Natyror

Siguria do të ketë një rëndësi të madhe në projektimin dhe operimin e impiantit, dhe do të hartohen procedurat operacionale për të reflektuar sa më mirë këtë çështje. Elementet e sigurisë do të integrohen në projektimin e impiantit dhe do të përfshijnë valvula ndihmëse, sisteme alarmesh dhe ndezje/fikje, në mënyrë që operatorët të jenë të aftë të zbulojnë situata jonormale apo problematika dhe të reagojnë sipas rastit.

Të gjitha kimikatet e përdorura në zonën e projektit do të ruhen në mënyrë korrekte dhe në sasi minimale. Sode kaustike, acidet, etj., do të ruhen në zona të kufizuara, ndërsa të gjithë kimikatet e tjera do të ruhen dhe përdoren nën praktikë normale të sigurt në enët nën presion përkatëse, tanke ose rezervuarë të posaçëm. Gjithashtu, do të instalohet një sistem i veçantë i kullimit për kimikatet.

Tubacioni dhe pajisjet që mund të jenë objekt i kushteve të ngrirjes (pra në temperatura të ulëta) do të mbrohen në mënyrën e duhur sipas udhëzimeve. Ndriçimi i nevojshëm i brendshëm dhe i jashtëm do të sigurohet nëpërmjet stacionit të energjisë për të lehtësuar operimin normal dhe aktivitetet e mirëmbajtjes, si edhe mbrojtjen dhe sigurinë. Në rastet kur do konsiderohet e nevojshme do të sigurohet fuqia DC (Kullës Ftohëse) për emergjenca për

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

të bërë mbylljen e sigurt të impiantit dhe ndriçimin gjatë mungesës /shkurtimit të furnizimeve me AC.

Struktura e baterisë do të projektohet për të përfshirë të gjitha rreziqet e shpërthimit, rrjedhjes dhe emetimeve të gazit. Në stacionin elektrik dhe përreth tij do të vendoset një strukturë tokësore për mbrojtjen e pajisjeve dhe stafit; kjo strukturë do të futet në tokë në një thellësi të duhur sipas specifikimeve dhe do të pajiset me elektroda tokësore në një hapësirë të përshtatshme.

Uji për fikjen e zjarrit

Do të sigurohet një sistem për zbulimin e zjarrit i cili mund të rezultojë për shkak të elektricitetit, sistem alarmi dhe mbrojtje për të mbuluar rreziqe të ndryshme për zonën e stacionit të energjisë. Sistemi do të përfshijë depo uji, sistem pompimi dhe shpërndarje, sistem i fiksuar sprucues, sistem spërkatës, rrotull zorrë dhe fikse zjarri të lëvizshme, si dhe një sistem zbulimi. Uji për fikjen e zjarrit do të depozitohet në një seksion të dedikuar të çisternës së zakonshme për depozitim të ujit të patrajtuar dhe një tubacion kryesor tokësor unazor do të shpërndajë ujë nga pompat në zonat e impiantit të mbrojtur nga sisteme me bazë ujin.

Sistemet automatike të sprucimit të ujit me shpejtësi të lartë do të ofrohen për të mbrojtur fushat e mëposhtme të impianteve:

- Transformatorët e njësisë;
- Transformatorët e gjeneratorit me turbinë me avull;
- Sistem lënde djegëse me pompim nga bojleri me presion të madh;
- Sistem lënde djegëse për gjeneratorë me benzinë për emergjenca;
- Skelet mbështetës për vaj lubrifikues të turbinave me avull;
- Çisterna depozitimi të lëndës djegëse rezervë;

3.3.3 Faza e Dekomisionimit

Projekti i propozuar ka jetëgjatësi prej 26.67 vitesh. Aktualisht nuk ekziston asnjë marrëveshje që përcakton se çfarë do të ndodhë me objektin në fund të ciklit të jetës, por pritet që vendi i Projektit të kthehet në gjendjen e tij origjinale. Plani i mbylljes dhe restaurimit të zonës do të zhvillohet përpara fillimit të aktiviteteve të nxjerrjes nga përdorimi.

E gjithë infrastruktura do të çmontohet dhe hiqet. Makineritë, hekuri dhe materialet e shkatërruara do të riciklohen aty ku është e mundur dhe do të depozitohen në vendet të aprovuara depozitimi.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

3.4 ANALIZA E ALTERNATIVAVE

Për të siguruar qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale të Projektit, VNMS do të përfshijë një analizë të alternativave potenciale të Projektit. Kjo do të përfshijë alternativat e ndryshme të shqyrtuara gjatë fazës së plotë të projektimit të TEC Korçë dhe gjithashtu në kuadër të procesit të VNMS, përkatësisht:

- Alternativa 'Pa Projekt';
- Alternativat e vendndodhjes për termocentralin;
- Alternativat e projektimit dhe teknologjisë.

Gjatë fazës së studimit janë marrë në konsideratë alternativat e projektit, teknologjisë, projektimit, alternativës "pa-projekt" dhe alternativave të vendndodhjes së projektit. Projekti i propozuar i përshkruar në këtë Raport Studimi të VNMS rezulton të ketë opsionin më të mirë në drejtim të:

1. Llojit të lëndës djegëse (gazit natyror) që do të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike;
2. Llojit i teknologjive të lëndëve djegëse nga burimet fosile në lidhje me avantazhet konkurruese midis tyre;
3. Konsumit relativ të lëndës djegëse dhe efikasitetit të termocentralit (rreth 60%);
4. Emetimeve miqësore në mjedis (emetimet e gazrave serrë) për shkak të përdorimit të teknologjisë moderne; dhe,
5. Bazuar në avantazhet e listuara më poshtë të vendodhjes së propozuar për TEC-in dhe për shkak të afërsisë së zonës së projektit me të gjithë infrastrukturën e nevojshme siç janë:
 - i) tubacioni i gazit natyror (Projekti TAP),
 - ii) energjia elektrike e tensionit të lartë, nënstationi i Zëmbllak,
 - iii) afërsi me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane në Korçë; dhe,
 - iv) afërsi me qytetin e Korçës (për shpërndarjen e ngrohjes me avull në sistemin qendror të parashikuar për qytetin në të ardhmen e afërt)

Alternativa e preferuar do të merret parasysh gjatë vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis. Një analizë më e hollësishme e alternativave të projektit do të përfshihet në Raportin e Thelluar të VNMS.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

4 TË DHËNAT EKZISTUESE PËR MJEDISIN BIO-FIZIK DHE SOCIO-EKONOMIK

4.1 HYRJE

Ky kapitull përshkruan kushtet ekzistuese mjedisore dhe socio-ekonomike të zonës. Fushëveprimi për fazën e studimit (scoping) përqëndrohet në rajonin e përgjithshëm rreth zonës së Projektit të propozuar.

Kushtet mjedisore ekzistuese të përshkruara në këtë kapitull janë, në shumë raste, të përshkruara në nivel rajonal apo edhe kombëtar, pasi ato bazohen kryesisht në të dhënat sekondare të mbledhura gjatë kësaj faze studimi duke marrë parasysh faktin se ekzistojnë të dhëna të kufizuara për mjedisin në nivelin lokal ose vendor. Kushtet lokale specifike të mjedisit përshkruhen aty ku është e mundur, bazuar në informacionin nga burimet dytësore dhe informacionet e grumbulluara nga Projekti TAP gjatë studimeve mjedisore dhe socio-ekonomike në ose pranë zonës së propozuar për zhvillim.

Përshkrimi i detajuar i aspekteve mjedisore dhe socio-ekonomike referuar vendndodhjes së saktë të projektit të propozuar dhe kushteve ekzistuese, do të përcaktohet në mënyrë të hollësishme gjatë studimit në terren dhe do të përfshihet në Raportin e Thelluar të VNMS. Në rastet kur do nevojitet informacion i mëtejshëm plotësues për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, do të mblidhen të dhëna primare të zonës si pjesë e studimeve të detajuara/specifike të VNMS, të cilat do të mbushin çdo boshllëk apo mangësi njohurish dhe informacioni për kushtet ekzistuese të mjedisit në raportin e VNMS. Gjithashtu, në Kapitullin 8 paraqitet një përmbledhje e Termave të Referencës (ToR) për studimet shtesë që do kryhen gjatë procesit të VNMS.

4.2 BURIMET BIO-FIZIKE

4.2.1 Të dhënat e përgjithshme për vendodhjen e projektit

Bashkia e Korçës shtrihet në pjesën jug-lindore të Shqipërisë dhe përfaqëson qendrën më e madhe të banuar me të njëjtin emër. Korça shtrihet midis malit të Moravës në lindje, "Malit të Thatë" në verilindje, në Çërravë në veri, Malësinë e Gorës, Voskopojë dhe Vithkuq në perëndim dhe Qarri në jug. Ajo ka një lartësi mesatare prej 850 m mbi nivelin e detit, me një gjerësi prej 40 km nga lindja në perëndim dhe 32 km nga veriu në jug dhe mbulon një sipërfaqe prej 730 km².

4.2.2 Klima dhe Meteorologjia

Zona e studimit i përket klimës së nën-zonës Jugore Mesdhetare Para-malore. Sipas të dhënave në dispozicion, vërehet se temperaturat e ajrit janë më të ftohtat në Shqipëri, ku ka një ndikim të rëndësishëm kontinental. Temperatura mesatare vjetore në Korçë është 10.5°C,

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

me temperaturë mesatare prej 20°C në korrik dhe temperaturë mesatare 0.5°C në janar. Korça regjistron temperaturat më të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë për shkak të depërtimit të masave të ftohta ajrore.

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 4.1 Temperatura mesatare mujore dhe mesatare vjetore e ajrit (°C) (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Mesatarja Vjetore
Korçë	0.5	2.2	4.9	9.2	13.9	17.6	20	20.2	16.5	11.3	6.8	2.5	10.5

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 4.2 Temperatura minimale absolute e ajrit (°C) (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Minimale Absolute
Korçë	-20.9	-17.3	-16.5	-10.5	0	2.6	4.9	6.6	-0.5	-7.5	-10.2	-19	-20.9

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 4.3 Temperatura maksimale absolute e ajrit (°C) (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Maksimale Absolute
Korçë	17.4	21.8	26.3	26.7	31.6	34.3	38.7	36.5	33.1	27.6	25	18.1	38.7

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 4.4 Numri i ditëve me temperaturë ≤ 0 °C sipas muajve dhe totali vjetor (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Totali (vjetor)
Korçë	23.8	17.0	14.0	2.6	-	-	-	-	0.1	1.7	7.6	21.1	87.9

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Sipas të dhënave të rreshjeve, zona karakterizohet nga rreshje të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Gjithashtu, vërehet një shpërndarje gjeografike jo e rregullt rreshjeve vjetore. Në verë, rreshjet përfaqësojnë vetëm 13.4% të rreshjeve vjetore, si rezultat i ndikimit të klimës kontinentale. Ndërkohë që, precipitimet e borës ndodhin më së shpeshti në periudhën Nëntor-Prill.

Tabela 4.5 Sasia mujore dhe sezonale e rreshjeve (mm) (1951 - 1990)

Stacioni	Muaji											
	Dhje	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën
Korçë	98	78	73	59	60	74	43	32	31	48	85	109
	Sezoni											
	Dimër			Pranverë			Verë			Vjeshtë		
Korçë	249			193			106			242		
	Totale (Vjetore) = 790											

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 4.6 Numri i ditëve me rreshje ≥ 1.0 mm sipas muajve dhe totali vjetor (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shat	Tet	Nën	Dhje	Totali (vjetor)
Korçë	8.9	9.2	9.2	9.2	9.3	6.7	4.4	4.1	5.4	7.2	9.7	10.8	94.1

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 4.7 Numri i ditëve me rreshje (1951 - 1990)

Stacioni	Ditët		
	Rreshje ≥ 0.1 mm	Rreshje ≥ 1 mm	Rreshje ≥ 10 mm
Korçë	130.7	94.1	25.8

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 4.8 Sasia maksimale mujore e rreshjeve (mm) (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shat	Tet	Nën	Dhje	Maksimale Vjetore
Korçë	50	44	33	53	50	80	49	45	63	63	85	77	85

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Tabela 4.9 Numri i ditëve me borë sipas muajve dhe totali vjetor (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Totali (vjetor)
Korçë	12.3	11.4	3.8	5.3	-	-	-	-	-	-	0.7	6.3	34.8

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 4.10 tregon frekuencën (f) dhe shpëjtësinë (sh) e erës sipas drejtimeve të ndryshme në stacionin e monitorimit të IHMSH me vendodhje në Sheqeras.

Tabela 4.10 Drejtimet e erave të matura në stacionin e Sheqeras, Korçë


Stacioni	Periudha e qetë (%) (<i>Ëind Calm</i>)	V		VL		L		JL		J		JP		P		VP	
		f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh
Sheqeras, Korçë	10.4	14.9	3.4	5.3	2.8	28.9	4.7	8.2	3.9	4.8	4.1	2.6	2.6	6	3.3	18.9	3.7

Burimi: Insitituti Hidometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Erat

Figura 4.1 Trëndafili i erave në Sheqeras, Korçë



Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Sipas të dhënave të paraqitura më sipër, në Korçë dominojnë erërat nga Veri-Perëndimi dhe Lindja. Shpejtësitë mesatare të erës të regjistruara në stacionin e meteorologjik të Sheqeras (11.5 km distancë ajrore nga zona e studimit) variojnë nga 2.6 m/s në 4.7 m/s, brenda intervaleve të ilustruara në figurën e mësipërme.

4.2.3 Toka dhe Gjeologjia

TEC-i Korçës është propozuar të ndërtohet në skajin lindor të Qytetit të Korçës. Formacionet gjeologjike sipërfaqësore përbëhen nga depozitat mollasike prej mergele, argjile dhe rërat. Relievi është prekur ndjeshëm nga erozioni si pasojë e rezistencës së ulët të depozitave Burdigaliane, si dhe prej terrenit të pjerrët, aktivitetit të ujërave sipërfaqësore dhe faktorëve atmosferik. Në anën e djathtë të rrugës Bilisht-Korçë, terreni është krejtësisht i sheshtë dhe përfaqësohet nga ultësira e Korçës e cila nuk është prekur nga erozioni. Afërsisht 2 km në perëndim të fshatit Zëmlak ka një çarje tektonike aktive, e cila shkon në drejtimin jug-perëndimor (nga fshati Zëmlak në Pendavinj).

Në pjesën perëndimore terreni është i sheshtë dhe i shënuar nga depozitat Kuarternare të Ultësirës së Korçës. Trashësia e këtyre depozitave rritet nga jugu drejt veriut, ndërsa madhësia e grimcave sedimentare zvogëlohet nga jugu (rrjedha e sipërme e lumit Dunavec) në veri (bashkimi i Lumit Dunavec me Lumin Devoll). Në të dy anët e fushës së Korçës janë aktive çarje neo-tektonike të cilat kufizohen në lindje dhe në perëndim.

Në skajin jugor të fushës së Korçës, depozitat aluvioni-colluviunale janë dominante, ndërsa në pjesën veriore formacionet gjeologjike sipërfaqësore përfaqësohen nga depozitat aluviale-kënetore.

Në zonën e Fshatit të Turanit, depozitat aluviale janë të përbëra nga shtresa silti-argjilore të alternuara me shtresa zhavorri ujëmbajtës. Aquiferi zhavorror i Kuarternarit të Korçës është përdorur për të furnizuar qytetin e Korçës me ujë të pijshëm. Puset hidro-gjeologjike dhe depozitat qendrore të ujit shtrihen në zonën e fshatit Turan.

Ndërsa në zonën kodrinore të Zëmlakut, e cila është shumë e ndikuar nga erozioni, territori përfaqësohet nga depozitat flishe të Eocenit të Mesëm, të cilat janë të përbërë kryesisht nga argjila, rëra dhe konglomerate. Në zonat ku gjenden konglomeratet, bimësia është shumë e pakët. Në këto pjesë relievi është i zhveshur, sepse konglomerate janë të betonuar; për këtë arsye ata janë rezistente ndaj erozionit. Ndërsa në zonat ku depozitat rëre dhe lymit shfaqen në sipërfaqe është vënë re një rritje e lehtë e erozionit. Ky erozion është më i theksuar në shtretërit e vegjël të lumenjve, ku ndodhen dhe depozitat e argjilës dhe mermerit.

Rrjedhimisht, konglomeratët e moshës Eocene të Mesme zëvendësohen me formacionet Burdigaliane, të përbëra kryesisht nga marna, argjilë, rërë dhe shtresat të rralla ranore. Terreni është prekur ndjeshëm nga erozioni si pasojë e rezistencës së ulët të depozitave

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Burdigaliane, si dhe për shkak të terrenit të pjerrët, aktivitetit të ujërave sipërfaqësore dhe faktorëve atmosferike.

4.2.4 *Relievi dhe Peizazhi*

Terreni i zonës së propozuar për zhvillim karakterizohet nga një reliev pothuajse i sheshtë. Zona e projektit ndodhet në tokë bujqësore (Fusha e Korçës), pranë impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në Korçë. Fusha e Korçës është zona më e madhe dhe më e njohur e Shqipërisë, e vendosur rreth 824 metra mbi nivelin e detit. Ajo shquhet për relievin e saj të sheshtë në të gjithë sipërfaqen e saj. Të gjitha zonat përreth vendit të propozuar për zhvillim përfaqësohen nga toka bujqësore të mbuluara me të mbjella dhe prodhime bujqësore. Mbulesa e tokës klasifikohet si model i ndërthurur i kultivimit të prodhimeve bujqësore. Sidoqoftë, projekti i termocentralit do të zhvillohet brenda një zonë me grup aktivitetesh të ngjashme (impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, panelet diellore), kështu që ndikimi i parashikuar për vendodhjen e projektit do të sjellë më pak ndryshime në perizazhin e përgjithshëm.

4.2.5 *Toka dhe karakteristikat pedologjike*

Në Zëmbllak dhe zonën përreth, karakteristikat kryesore të tokës përfaqësohen nga toka pjellore, tipike të Arenosole. Në dekadën e fundit mollët janë pemët frutore që kultivohen më shumë dhe ky trend duket se është duke u vazhduar. Më shumë se 90% e sipërfaqes së tokës është e punueshme, kryesisht e kultivuar me pemishte 45% (mollë dhe kumbulla), perime 30% (fasule) dhe foragjere 25% (misri dhe jonxhe). Këto toka janë të ujitura (nëpërmjet rrjeteve të kanaleve ujitëse), të plehëruara dhe të punuara, me një shkallë të lartë intensiteti.

Përgjithësisht në zonë mbizotërojnë shkëmbinjtë vullkanikë, me lloje aluviale të "pakonsoliduara". Klasa teksturale është argjilore, me prani gurësh në sipërfaqe (10 - 20%), tokë e thellë (1.5 m) dhe e drenazhuar mirë. Tokat janë klasifikuar të Klasës II.

Në zonën e Terovës, tokat janë formuar nga ndikimi i lumit Devoll, zakonisht janë gjetur Arenosole Fluvike me histosole në pjesët më të ulta të fushave, të cilat janë tokat më pjellore të klasifikuara në klasën e I-rë. Bujqësia është intensive dhe e dominuar kryesisht nga drithërat dhe foragjeret. Më shumë se 90% e sipërfaqes së tokës është e punueshme, ujitet nëpërmjet rrjeteve të kanaleve, e plehëruar dhe me një shkallë të lartë intensiteti. Drithërat kryesore janë gruri dhe misri, duke mbuluar 80% të të gjithë sipërfaqes, foragjerët (veçanërisht jonxhë) me 15% dhe disa pemishte (5%). Origjina e materialit nënë është gëlqerore e llojit 'shkëmb sedimentar dhe e tipit lumor-aluvial e "pakonsoliduar". Klasa teksturale është argjilore dhe gëlqerore. Në sipërfaqe fragmentet shkëmbore janë më pak se 6%, sipërfaqja është e sheshtë (pjerrësia <6%) me një shkallë të ulët të erozionit dhe

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

drenazhim jo të mirë. Llojet e tokës janë Fluvic Arenosole Fluvice dhe Histosole, të klasifikuar respektivisht si të klasës II dhe I.

Ndërsa cilësia dhe karakteristikat kryesore të tokës në zonën e Çiflikut janë të përfaqësuara si më poshtë. Bujqësia në këtë zonë është intensive dhe dominohet kryesisht nga drithërat dhe foragjeret. Më shumë se 90% e sipërfaqes së tokës është e punueshme e cila ujitet, plehërohet dhe punohet me makineri me një shkallë të lartë të intensitetit të prodhimit. Të mbjellat kryesore përfaqësohen nga drithërat, si misri dhe gruri, me 60% dhe foragjeret, jonxha, me 40%. Origjina e materialit nënë është e llojit aluvialen të "pakonsoliduar".

Tekstura është argjilore dhe me dhe, pa prani gurësh në sipërfaqe (<10%), e thellë (> 75 cm), me sipërfaqe të sheshtë (pjerrësia e shpatit <6%), me një shkallë të ulët erozioni dhe drenazhim të mirë me tuba qeramike. Në sipërfaqe ka të çara dhe lloji i tokës është Eutric Luvisol, i cili është klasifikuar, gjithashtu, si pjesë e klasës së II-të.

Duke iu referuar zonës së propozuar për zhvillim, karakteristikat kryesore të dheut dhe mbulesës së vegetacionit janë të përshkruara si më poshtë në paragraf. Bujqësia nuk është intensive në këtë zonë dhe mbulesa e bimësisë dominohet nga foragjeret dhe bimët barishtore të ulëta. Ekziston edhe prania e pemëve Mështekna e bardhë (*Betula pendula*) dhe plepi (*Populus tremula*). Materiali prind është lloji aluvial 'i pakonsoliduar'. Struktura është argjilore, pa gurë në sipërfaqe (<10%), e thellë (> 75 cm), sipërfaqe të sheshtë (<6% pjerrësi), me shkallë të ulët të erozionit dhe të drenazhuar mirë. Lloji i tokës klasifikohet si klasa V. Në përgjithësi tokat në klasën V kanë pak ose aspak rrezik të erozionit, por kanë kufizime të tjera që kufizojnë përdorimin e tyre kryesisht në kullota, pyje apo mbulesë për ushqim të gjallesave të tjera të egra. Tokat në klasën V kanë kufizime që limitojnë llojin e bimëve që mund të rriten dhe që parandalojnë lëvrimin normal të kulturave bujqësore. Zakonisht këto toka janë pothuajse të niveluara/sheshta, por shpesh herë 'përmbysten' nga rrjedha ujore, apo janë të mbushura me rrëqe, janë të ngurta, kanë kufizime klimatike ose kombinime të ndryshme të këtyre kufizimeve.

4.2.6 Flora

Në zonën e Korçës ndodhen mbi 30 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike, ku mund të përmendim Bar gjarpri (*Ceterach officinarum*), Karotë e egër (*Daucus carota*), Dëllinjë e zezë (*Juniperus communis*) dhe Dëllinjë e kuqe (*Juniperus oxycedrus*).

Në pjesën më të madhe, kanalet e kullimit, bimësia breglumore dhe kullotat gjysmë-natyrore, janë të dominuar nga *Populus nigra*, *Salix alba*, *Populus canadensis*, *Bromus erectus*, *Alopecurus pratensis*, *Arrhenatherum elatius*, *Poa trivialis*, *Tragopogon pratensis*, *Leucanthemum vulgare*, *Campanula patula* dhe *Sambucus ebulus*. Prodhimet bujqësore më të rëndësishme që kultivohen në këto zona janë gruri, misri, fasulja, elbi dhe jonxha.

Ndërkohë, përta i përket bimësisë ujore dallohen disa lloje, të tilla si *Cladophora glomerata*, *Chara gymnophylla*, *Potamogeton crispus*, *Potamogeton fluitans*, dhe algat filamentoze të

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

gjelbra në pellgje, të cilat janë vërejtur në trupat ujorë të studiuar më parë. Shumëllojshmëria e bimëve ujore është relativisht e lartë, me 19 specie të regjistruara. Kryesisht dominohet nga specie makrofitesh të zhytura dhe në sipërfaqe, të cilat janë të përqendruara në zonat moçalore dhe ku rrjedha e ujit është e ngadaltë. Llojet më të shpeshta që hasen janë algat e gjelbëra *C. glomerata* me një shkallë mbuluese prej 4%.

Zona e propozuar për zhvillim dhe zonat përreth saj janë toka bujqësore. Kulturat kryesore kryesore të kultivuara në këto zona janë gruri, misri, fasulja, elbi, panxhari dhe jonxha. Pjesa më e madhe e tokës në vendin e propozuar është tokë e braktisur, e mbuluar nga bimët barishtore të ulëta. Ekziston edhe prania e pemëve Mështekna e bardhë (*Betula pendula*) dhe plepi (*Populus tremula*).

Flora ekzistuese brenda zonës së Projektit dhe zonës së studimit (zonës së influencës) do të investigohet më tej në detaje gjatë fazës së studimit në terren për raportin e VNMS.

4.2.7 *Fauna*

Siç u përmend më sipër, tokat bujqësore janë të shpërndara gjerësisht në fushën e Korçës. Sipërfaqet e tokave në këtë fushë janë të përbëra nga tokave bujqësore dhe toka të punueshme të braktisura, të cilat janë shndërruar në kullota. Habitati përfaqësohet nga një llojshmëri e lartë e llojeve të shpendëve, kryesisht të Rendit të Passeriformes. Në dimër fushat e hapura përdoren nga tufat e harabelave, nën shoqërinë e Passeriformes të vogël. Ndërsa në verë, fushat e hapura janë baza për shumimin e thëllëzave.

Pemët frutore të terrenit vizitohen nga gushëkuqat, harabelat, pupëzat dhe pëllumbat. Llojet më karakteristike të gjitarëve janë Miu i shtëpisë (*Mus musculus Domesticus*), Miu i pyllit (*Apodemus sylvaticus*) dhe Miu i Ondriasit (*Microtus epiroticus*). Gjithashtu, plantacionet me pemë frutore janë të përhapura edhe pranë zonës së Cangonji-Zëmbllak. Edhe pse të themeluar relativisht vonë (10-15 vitet e fundit), ky lloj habitati është ende në zgjerim, meqënëse fermerët janë të interesuar në zhvillimin e mëtejshëm të hortikulturës në fushat e Devollit dhe të Korçës. Plantacionet e pemëve frutore të mollës, kumbullës dhe qershisë ofrojnë disa strofulla ekologjike për zvarranikët (si p.sh, hardhuca e Gjelbër Evropiane dhe hardhuca e murit, Passeriformes të ndryshme, ngrënësit e bletave, pupëzat, etj). Shumica e llojeve të gjitarëve të zakonshme janë dhelpra (*Vulpes vulpes*), Baldosa (*Meles meles*), Nuselalja (*Mustela nivalis*), urithi dhe miu. Zogjtë grabitqarë, të tillë si skifteri kthetrazi shpesh herë vërehen mbi plantacionet e pemëve frutore. Githashtu janë gjetur jashtëshqitje të ujkut (*Canis lupus*) në kullotat me bagëti të vogla.

Nënshtresa e poshtme në disa pjesë të fushës përbëhet nga sedimente gëlqerore të vogla, të cilat janë pjesërisht të mbuluara me bimësi të ulët duke krijuar një habitat tërheqës për invertebratet bentike. Në këto habitate janë identifikuar të paktën 15 lloje, të cilat në pjesën më të madhe i përkasin familjes së insekteve, si p.sh, 10 lloje të ndryshme të larve të insekteve, duke përfshirë: pilivesën (1), flatraqimorët (3), Order Plecoptera (1), mizë maji (1),

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

bletë (1), brumbull (1) dhe miza (2). Në vijim është vërejtur prania e oligochaet-ve (3), molusqet (1), dhe krustaceve (1).

Fauna ekzistuese brenda zonës së influencës së Projektit do të investigohet më tej në manyrë të detajuar gjatë studimeve në terren për procesin e VNMS.

4.2.8 Zonat e Mbrojtura

Zona e studimit përfshihet në një territor me karakter urban, me infrastrukturë mbështetëse, e cila ndërthuret me karakterin rural ku dallohen tokat bujqësore dhe kultivimi i prodhimeve bujqësore. Bazuar në kërkimet gjatë fazës së studimit për projektin e propozuar, nuk pritët që ndërtimi dhe operimi i TEC Korçës të rezultojë në ndikime potenciale në Zonat e Mbrojtura. Në vijim, gjatë fazës së studimit janë identifikuar paraprakisht tre zona të mbrojtura të cilat ndodhen në distancë të konsiderueshme nga zona e propozuar e projektit për zhvillim. Zonat e mbrojtura të identifikuar renditen si më poshtë:

- i) Parku Kombëtar “Bredhi i Drenovës” - Ndodhet në pjesën Jug-Lindore të zonës së propozuar për ndërtimin e TEC-it, përafërsisht 6.9 km në distancë ajrore.
- ii) Rezervati Natyror i Menaxhuar Cangonj - Ndodhet në pjesën Veri-Lindore të zonës së propozuar për ndërtimin e TEC-it, përafërsisht 10 km në distancë ajrore.
- iii) Rezervati Natyror i Menaxhuar/Park Natyror Krastafillak - Ndodhet në pjesën Veri-Perëndimore të zonës së propozuar për ndërtimin e TEC-it, përafërsisht 8.7 km në distancë ajrore.

Vlen për tu theksuar së ka një studim për Zonat me Interes të Veçantë të Ruajtjes, të cilat identifikohen me Rrjetin Emerald (ASCI). Identifikimi i ASCI për Shqipërinë është kryer në periudhën 2002-2008. Si rezultat janë identifikuar dhe studiuar 25 zona potenciale Emerald, midis të cilave zona “Peizazhi i Mbrojtur i Moravës”. Sipas VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, zona me emërtimin “Peizazhi i Mbrojtur i Moravës” (e vlerësuar si Kategoria IV sipas IUCN), e cila përfshin Parkun Kombëtar “Bredhi i Drenovës” dhe Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Cangonj”, është propozuar si zonë e mbrojtur, por nuk është e miratuar. Pra, sipërfaqja që mbulon dy zonat e përmendura më sipër nuk është miratuar zyrtarisht. Megjithatë, nëse do të konsiderojmë distancën e TEC Korçë nga zona e emërtuar “Peizazhi i Mbrojtur i Moravës”, ajo është përafërsisht 1.55 km në distancë ajrore.

Gjatë fazës së studimit, janë identifikuar dy monumentet natyrore më ta afërta në zonë, të cilat pavarësisht kanë një distancë të konsiderueshme nga zona e propozuar për zhvillimin e projektit:

- i) Monumenti natyror i parë i identifikuar është përafërsisht 2.5 km në distancë ajrore nga zona e propozuar për ndërtimin e GPP Korçës (me vendodhje në pjesën lindore të termocentralit të propozuar);


			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- ii) Monumenti natyror i dytë i identifikuar është përafërsisht 1.8 km në distancë ajrore nga zona e propozuar për ndërtimin e GPP Korçës (me vendodhje në pjesën jug-perëndimore të termocentralit të propozuar).

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 4.2 Harta e vendodhjes së zonave të mbrojtura, monumenteve natyrore dhe zonave arkeologjike

Map of protected areas, natural and archaeological monuments/sites for GPP Korça



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Të gjitha zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore brenda Zonës së Influencës së Projektit do të investigohen më tej në detaje gjatë fazës së studimit në terren për procesin e VNMS.

4.2.9 Ujërat Nëntokësorë

Zona e Korçës është e pasur me burime ujorë nëntokësore. Kjo zonë karakterizohet nga prania e akuiferëve me shkëmbinj porozë të përshkueshëm. Këto lloje akuiferësh janë të dy llojeve sipas vëllimeve nëntokësore që ata mund të prodhojnë:

- Akuiferët me produktivitet të lartë përfaqësohen kryesisht nga aluvialet e Kuaternarit dhe shtresat zhavorrore që zakonisht mbushin luginat e lumit dhe disa pjesë të Ultësirës Pre-adriatike, rreth Qytetit të Korçës (afër burimit të Lumit Devoll). Depozitat e zhavorrore kanë një origjinë lakustre ose alluvionale në Ultësirën ndërmaalore të Korçës dhe trashësia e tyre maksimale është 300 m. Ato janë shumë shtresore, të përfaqësuar nga akuiferë të mbyllur, prej material zhavorri me një trashësi që varion nga 100 m deri në 150 m në çdo shtresë. Për shkak të ashpërsisë së materialit dhe prej lidhjes së shkëlqyer hidraulike të akuiferëve me lumenjtë, depozitat e zhavorrit mund të prodhojnë sasi të mëdha ujërash nëntokësore, të cilat përdoren intensivisht për furnizimin shtëpiak dhe industrial me ujë. Thellësia e puseve të shfrytëzueshme zakonisht varion nga rreth 30 m në mbi 100 m. Puset në zonën e Korçës kanë kapacitet ujëmbajtës që varion midis 2-20 l/s. Përbërja e ujit është e kontrolluar kryesisht nga cilësia e rimbushjes së tij (zakonisht prej lumenjve të vegjël), nga litologjia, shkëmbimi i joneve dhe përzierja me ujë të kripur. Në përgjithësi, cilësia e ujërave nëntokësore në afërsi të zonës së rimbushjes është e mirë, pasi kanë një përmbajtje të ulët minerale (tretjet totale të ngurta zakonisht janë më pak se 500 mg/l). Akuiferët bregdetare prej zhavorri përmbajnë pak ujë të kripur pasi ata janë depozituar në një mjedis të dominuar nga marina gjatë transgresionit të Holocenit të fundit (Custodio 2010);
- Akuiferët me produktivitet të ulët ndodhen në fund të depozitave Kuaternare në Shqipërinë lindore dhe perëndimore. Ato janë të vendosura midis qyteteve të Trestenikut dhe Korçës.

4.2.10 Ujërat Sipërfaqësorë

Zona përreth territoreve të Korçës dhe zonës së propozuar për zhvillim është drenazhuar nga një lum i madh, lumi Devoll. Në zonën e Korçës ka burime të tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum). Lumi Devoll rrjedh fillimisht në verilindje, përmes Miras, pastaj në veri përmes Bilishtit dhe në veriperëndim përmes Progërit, Pojanit (në veri të Fushës së Korçës), Maliqit, Moglicës, Kodovjatit, Gramshit, ku ndodhet një liqen i madh dhe Gostimë, ku kthehet në drejtim të jugut. Ai bashkohet me lumin Osum pranë qytetit të Kuçovës, për të formuar Semanin.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Uji i këtij lumi përdoret kryesisht për bujqësi dhe për përdorime të ndryshme shtëpiake. Përgjatë rrjedhës së tij, raportohet se shkarkohen ujëra nga industrinë, ujëra të ndotura shtëpiake dhe ujë të trajtuar. Lumi Devoll kalon në afërsi të fshatit Zëmbllak, ku do të ndërtohet linja e transmetimit në nën-stacionin e Zëmbllakut. Është afërsisht 10 km në distancë ajrore nga vendi i propozuar për TEC Korçën.

Një çështje e rëndësishme për tu marrë në konsideratë për ujërat sipërfaqësore janë kanalet e kullimit dhe kanalet e ujitjes të zonës. Një kanal kullimi ndodhet në pjesën perëndimore të vendit të propozuar për zhvillimin e TEC-it. Ky kanal nënkuptohet se ushqehet/përdoret nga impianti i trajtimit të ujërave të zeza.

Gjendja biofizike dhe biologjike e të gjitha trupave ujorë sipërfaqësorë do të vlerësohet në hollësi gjatë procesit të studimit në terren dhe përgatitjes së raportit të VNMS.

4.2.11 Cilësia e Ajrit

Në përgjithësi për Shqipërinë, ka pak të dhëna në lidhje me parametrat e cilësisë së ajrit dhe nëse ka në dispozicion, këto të dhëna nuk janë matura periodikisht, prandaj nuk mund të merren në konsideratë në këtë raport. Megjithatë, duke iu referuar informatave zyrtare, gjatë sezonit të dimrit në qytetin e Korçës ka emetime të tymrave dhe grimcave të ngurta për shkak të përdorimit të madh të sobave me dru nga banorët. Një kontribues tjetër i emetimeve në ajër është lëvizja e lartë e automjeteve në qytet për shkak të rritjes së turizmit gjatë gjithë periudhës së vitit.

Përsa i përket zonës dhe qytetit të Korçës, parametrat e cilësisë së ajrit parashikohen të jenë më të mira gjatë sezonit të lagësht për shkak të rreshjeve të shiut, i cili largon ndotësit në ajër. Parametrat e cilësisë së ajrit në zonën e influencës së projektit do t'i nënshtrohet një studimi të detajuar dhe do të investigohen gjatë procesit të kryerjes së VNMS.

4.2.12 Zhurmat, Vibrimet, Ndriçimi

Zhurma ekzistuese antropogjene në zonë është e lidhur me aktivitetet bujqësore dhe shtëpiake. Një kontribues për nivelet aktuale të zhurmës në zonë vjen si pasojë e lëvizjes së automjeteve përgjatë rrugëve të aksesit në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura të Korçës.

Në përgjithësi, për zonën, nivelet e zhurmës në mjedis pritet të jenë më të larta gjatë sezonit të thatë (verës) për shkak të ardhjes së emigrantëve, rritjes së lëvizjes së automjeteve dhe aktiviteteve bujqësore. Nivelet e zhurmës në mjedis do të investigohen gjatë fazës së studimit në terren për VNMS-në.

Aktualisht, në zonën e propozuar nuk u vërejtën burime të vibrimeve gjatë vizitës paraprake në terren. Zona gjithashtu ndriçohet përgjithësisht gjatë natës për shkak të funksionimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

4.3 **BURIMET SOCIO-EKONOMIKE**

4.3.1 **Të Dhëna të Përgjithshme për Zonën**

Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Ai shtrihet në pjesën juglindore të vendit, në rrëzë të malit Morava, rreth 850 metra mbi nivelin e detit. Relievi është kryesisht malor dhe kodrinor. Lartësia mesatare është 1145 metra. Korça, si rajon, është e rrethuar nga një numër i konsiderueshëm kodrash dhe malesh, në lindje të qytetit kufizohet nga mali Morava dhe në perëndim me zonat e Gora, Voskopoja dhe Vithkuq, të cilat janë zonat malore kryesore. Në jug shtrihet mali i Qarrit dhe në pjesën veriore është Mali i thatë. Zona e ulët përfshin Fushën e Korçës, një fushat më të mëdha në Shqipëri dhe zonën e Devollit të Sipërm. Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishmi është lumi Devoll me degët Dunavec dhe Osum.

Qyteti i Korçës është një nga qytetet më të zhvilluara në Shqipëri, përfaqëson një qytet multi-kulturor dhe kryesisht është vizituar nga një numër i madh turistësh gjatë dhjetë viteve të fundit. Qyteti ka një universitet, i specializuar në fushën e humanizmit, biznesit dhe shkencës. Korça është një qytet i rëndësishëm si për Kishën Ortodokse ashtu edhe për myslimanët sunitë, pasi është selia e peshkopit metropolitan ortodoks dhe vendi i xhamisë më të vjetër në Shqipëri.

Një nga zonat më të rëndësishme në rajon është Fusha e Korçës e cila është e njohur gjerësisht për prodhimin e bimëve dhe është zona kryesore e rritjes së grurit në Shqipëri. Fusha e Korçës është rreth 824 m mbi nivelin e detit. Vendi i propozuar për ndërtimin e TEC Korçës ndodhet në Fushën e Korçës, pranë impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, si vendodhje lokalizohen në pjesën veri-lindore të qytetit të Korçës. Distanca ajrore e përafërt e zhvillimit të propozuar është 2.7 km nga qendra e qytetit të Korçës dhe rreth 920 m nga periferia e qytetit. Megjithatë, në zonë ka banesa të identifikuar të cilat ndodhen në distancë më të afërt që variojnë nga 450 m në 920 m.

4.3.2 **Demografia**

Bashkia e Korçës përfshin 9 njësi territoriale administrative. Qendra urbane e territoreve është qyteti i Korçës, i cili në aspektin administrativ përcaktohet si qyteti kryesor me rëndësi kombëtare në vend. Zona funksionale përfshin njësitë administrative Drenovë, Mollaj, Bulgarec, Pojan, Voskop, Voskopoja, Vithkuq, Lekas, etj, të përcaktuara kryesisht si zona të sheshta bujqësore, malore ose të përziera, të cilat nuk plotësojnë kushtet për të qenë qendra e zonës funksionale. Sipërfaqja e përgjithshme e Bashkisë së Korçës është përafërsisht 857 km². Sipas të dhënave të fundit të publikuara (Ministria e Brendshme, datë 30.11.2017), popullsia e Bashkisë së Korçës është 135,568 banorë. Përafërsisht 55% e popullsisë në këtë bashki jeton në zonën urbane dhe 45% në zonat rurale.

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 4.11 Popullsia e Bashkisë Korçë

Units of Korça Municipality	Population
Qyteti i Korçës	87,824
Njësia Administrative Drenovë	10,446
Njësitë Administrative Mollaj dhe Vithkuq	8,873
Njësia Administrative Qëndër Bulgarec	14,069
Njësia Administrative Voskop	5,877
Njësitë Administrative Voskopojë, Moglicë dhe Lekas	3,301
Njësia Administrative Pustec	5,178
Total (Bashkia Korçë)	135,568

Burimi: Ministria e Brendshme, datë 30.11.2017

Demografia e zonës brenda projektit dhe përreth saj do të studiohen më tej gjatë procesit të VNMS.

4.3.3 Etnia dhe Feja

Për shekuj me rradhë Korça ka qenë një qendër e rëndësishme fetare për të krishterët ortodoksë dhe myslimanët, duke strehuar një komunitet të rëndësishëm ortodoks, si dhe komunitete të tjera të rëndësishme suni dhe bektashiane brenda dhe në rrethinat e qytetit. Qendra kryesore e bektashinjve të zonës është Teqeja Turan. Në kohët moderne, janë evidentuar edhe një numër më i vogël i katolikëve protestantë në qytet, si dhe persona jofetare. Kisha e dytë protestante shqiptare u hap në Korçë. Në vitin 1940, Kisha Ungjillore e Korçës u mbyll nga forcat fashiste italiane.

Gjuha zyrtare e qytetit të Korçës është shqip, madje qytetarët e Korçës dallohen për dialektin e tyre karakteristik në gjuhën e folur të përditshme. Shumica e popullsisë së Korçës përbëhet nga ortodoksët e krishterë dhe muslimanët, me një pjesë të vogël të popullsisë që praktikon fetë e tjera.

Mbledhja e të dhënave shtesë gjatë fazës së studimit do të nxjerrë informacione më të hollësishme për përbërjes aktuale etnike të zonës në kuadër të zhvillimit të projektit.

4.3.4 Jetesa dhe Mikroekonomia

Gama e aktiviteteve bujqësore raportohet kryesisht në zonën e studimit. Fermat dhe aktivitetet e nënprodukteve të qumështit janë një nga aktivitetet kyçe të ekonomisë në zonën

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

e studimit dhe ka të paktën 1 fabrikë qumështi në çdo ish-komunë (njësi administrative). Qumështi ose shitet direkt në qumështore për përpunim dhe prodhim të djathit ose shitet derë më derë nga fermerët individualë. Banorët në fshatrat përreth raportojnë se shumica e familjeve mbajnë së paku 1 lopë dhe disa dele për konsum personal, edhe nëse nuk janë të varur nga blegtoria për qëllime ekonomike.

Gruri është gjithashtu një kulture e rritur nga shumica e familjeve i cili përdoret ose për shitje ose për përdorim vetjak në shtëpi për të bërë bukë, së bashku me misrin, i cili përdoret edhe si ushqim për kafshët. Përveç prodhimeve kryesore bujqësore që gjenden në të gjithë zonën e studimit, ekzistojnë fusha specifike përgjatë gjurmës së projektit që specializohen në prodhime të caktuara. Kjo përfshin prodhimin e mollës dhe frutave të pyllit në rrethin e Korçës dhe Devollit.

Përdorimi i përgjithshëm i tokave bujqësore brenda zonës së studimit, duke lejuar identifikimin e zonave të kulturave të përhershme dhe përdorimit të përzierë të tokës bujqësore në nivelin e vendbanimit. Disa nga këto zona, kryesisht të përqendruara në rrethin e Devollit, janë identifikuar si me ndjeshmëri kryesore për projektin për shkak të produktivitetit të lartë dhe shqetësimeve të mundshme.

Çdo vendbanim i anketuar në zonën e studimit ka të paktën një dyqan kafeje dhe një dyqan ushqimor për produktet vendase dhe ushqime të paketuara. Numri i dyqaneve rritet proporcionalisht me rritjen e popullsisë.

Aktivitetet industriale dhe komerciale në zonën e studimit janë aktualisht në një shkallë të vogël me drejtim familiar ose në shkallë të mesme në zonat urbane dhe në periferi të tyre. Aktivitetet kryesisht përfshijnë fabrikat e përpunimit të ushqimit, fabrikat e tekstilit, bizneset e ndërtimit, etj.

4.3.5 *Përdorimi i Tokës*

Në zonën e Korçës, kulturat mbizotëruese sezonale janë të ndërthurura me zona të kulturave të përhershme (pemë molle). Vendbanimet e Turan-Ravonik (Njësia Administrative Drenovë) dhe Bulgarec-Çiflik janë rurale, por rriten me shpejtësi në zonat gjysmë urbane. Rruga Korçë - Pogradec kalon në jug të fshatit Çiflik dhe Bulgarec. Në zonë ka shumë biznese të vogla të vendosura përgjatë rrugës. Një zonë urbane është caktuar nga të dyja anët e rrugës dhe është fokusi për zhvillimin urban në nivel rajonal. Plantacionet e mollës me intensitet të lartë rrethojnë vendbanimin e Zëmlakut (Njësia Administrative Pojan) dhe në perëndim vendbanimet e Mollaj (Njësia Administrative Mollaj).

Në Devoll identifikohen kultura të përziera sezonale dhe të përhershme. Në zonën e Njesisë Administrative Proger, toka është pyjore malore dhe me të mbjella të përhershme (mollë) në lugina. Rreth vendbanimeve takohet përdorimi i tokës gjysmë urbane (Vishocicë, Kuç dhe Vranisht). Ndërsa, Fusha e Korçës njihet kryesisht për aktivitetin bujqësor dhe prodhimin e kulturave të ndryshme si gruri, misri, fasulja, elbi, panxhari dhe jonxha.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

4.3.6 *Pronësia mbi tokën dhe fragmentimi i saj*

Gjatë periudhës së komunizmit, të gjithë tokat ishin në pronësi kolektive nga shteti. Në vitin 1991 u zbatua ligji i ri (Ligji 7501/1991 mbi Tokën), i cili ka çuar në një reformë të plotë të sistemit të pronësisë mbi tokën. Disa çështje të rëndësishme të tokës mbeten të hapura dhe krijojnë paqartësi dhe pengesa në sistemin e pronësisë së tokës dhe transaksioneve. Mosmarrëveshjet mbi çështjet e tokës dhe pronësisë mbi të mund të pengojnë procesin e identifikimit, vlerësimit dhe kompesimit të tokës, sidomos parcelat private. Ky kontekst i tranzicionit po krijon një numër të madh mosmarrëveshjesh, me të cilat sistemi gjyqësor i vendit po përpiqet ti “përballojë”.

Regjistrimi i të drejtave të pronësisë mbetet ende një çështje e pazgjidhur dhe si pasojë e çështjeve të sipërpërmendura, regjistrat kadastralë janë jo të plotë. Çështja e kthimit/kompensimit të të drejtave të pronësisë është ende e pazgjidhur. Kthimi i tokës bujqësore ka qënë objekt debati që prej viti 1993, kur ligji origjinal 7698 për kthimin e pronës tek pronarët e ka përjashtuar këtë kategori. Zbatimi i këtij ligji ende vazhdon të jetë jo i plotë.

Shpërndarja relativisht e barabartë e tokës bujqësore në familjet rurale në vitet 1990 ka rezultuar në një fragmentim ekstrem të pronësisë mbi tokën. Numri i madh i pronarëve të tokave komplikon zhvillimet në vendim-marrje, si dhe shfrytëzimin bujqësor në shkallë të gjerë të tokës. Disa parcela të tokës janë me cilësi të dobët për përdorim bujqësor dhe familjet që kanë emigruar kanë braktisur të tjera.

Ndërtimet pa leje: Gjatë viteve 1990 shumë parcela u ndanë dhe u ndërtuan strukturat/banesa në toka pa autorizim ligjor (leje ndërtimi). Këto veprime rezultuan në krijimin e zonave joformale urbane në periferi të qyteteve, në zonat e përqëndruara të hoteleve dhe shërbimeve turistike, në ndërtesat e tregtisë dhe të shërbimit të shpërndara në autostrada dhe në shtëpi bujqësore jashtë qendrave të fshatit. Të tilla parcela të paautorizuara të tokës dhe ndërtimet e paligjshme tani përbëjnë një pjesë të madhe të të gjitha pronave të paluajtshme.

4.3.7 *Remitancat dhe Ndihma Ekonomike*

Të ardhurat nga dërgesat e emigrantëve kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë shqiptare që nga vitet 1990. Në vitin 2007, në Shqipëri u dërguan mbi 1 miliardë dollarë remitancash, që përfaqëson 15% të PPB1-së. Remitancat në Shqipëri janë tri herë më të larta sesa investimet e drejtpërdrejta neto të huaja dhe pothuajse dyfishi i ndihmës zyrtare për zhvillim të marrë nga Shqipëria. Një pjesë e madhe e emigrantëve (68.6%) dërgojnë remitancat në Shqipëri me 90% të këtyre remitancave hyrëse me origjinë nga vendet evropiane (UNDP, 2009).

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

4.3.8 *Përdorimi i Energjisë*

Prodhimi i energjisë në Shqipëri dominohet nga impiantet hidroelektrike (hidrocentralet), të cilat përlllogariten të përfaqësojnë gjysmën e konsumit të energjisë në Shqipëri. Pavarësisht nga prodhimi i hidrocentraleve në Shqipëri, brenda zonës së studimit, familjet raportuan se përdorin drurin, energjinë elektrike dhe gazin si burimi kryesor të energjisë në familje. Shumica e familjeve në rajonin e Korçës përdorin drurin si burim kryesor të ngrohjes dhe gatimit, ndërsa 82% e banorëve të Devollit përdorin gazin në bombula për gatim.

4.3.9 *Trashëgimia Kulturore dhe Vlerat Socio-Kulturore*

Rajoni i Korçës përfaqëson një territor me zhvillime intensive kulturore që janë shumë domethënëse dhe përfaqësuese për karrierën njerëzore në pjesën tjetër të Evropës Juglindore. Prej studimeve të kohëve të fundit, dëshmitë më të hershme për veprimtarinë njerëzore janë të datuara nga Paleoliti i Sipërm, pas gjetjeve sipërfaqësore të traditës së Paleolitit të Sipërm në afërsi të fshatit të vjetër të Kamenicës (Gjipali 2006). Procesi i rëndësishëm neolitizimit i fundit të Mijëvjeçarit të 7 p.e.s. është përfaqësuar me zonat e hershme neolitike të Podgorit, Vashtëmit, Progërit, por edhe Sovjanit, siç tregohet nga gërmimet e fundit të ekipit franko-shqiptar dhe të botuar në disa studime (Lera, Prendi, Touchais 1994). Pjesa tjetër e neolitit është e përfaqësuar mirë në rajonin e Korçës në vendbanime të tilla si Dunavec, Burimas, Dersnik, por edhe Maliq, Sovjan, Tren dhe Kamnik (më tej në jug, në rajonin e Kolonjës). Maliqi ka origjinën nga parahistoria e vonë e Shqipërisë. Fillimi i Epokës së Metaleve (bakër dhe bronz) është i përfaqësuar gjerësisht në vende të tilla si Maliq, Sovjan, Tren (Korkuti 1971). Vende të hapura, shpella, banesa në shtylla druri në brigjet e liqenit dhe majat e kodrave janë llojet kryesore të vendbanimeve të identifikuar.

Shpërndarja e tyre në rajon ndjek një model të mirë konsoliduar: afër liqeneve, afër zonave me potencial të lartë bujqësor dhe në afërsi të zonave me biodiversitet të zhvilluar, të cilat në mënyrë tipike mbështesin një aktivitet ekonomik të larmishëm. Gjatë shekullit VI p.e.s., në pellgun e Korçës janë zbuluar disa tumula në Barç (Andrea 1985), Kuç i Zi (Andrea 1985), Kamenicë (Bejko 2004, 2006), por shumë më tepër janë identifikuar dhe regjistruar si të dëmtuar ose me tiparet arkeologjike pothuajse tërësisht të fshira.

Periudha e vonshme romake duket më e përfaqësuar në zonën e Korçës në Polenë, Rëmbec, Trajan, së bashku me prova të rëndësishme për okupimin në Mesjetë. Vëzhgimet sipërfaqësore zbulojnë shumë më tepër material arkeologjik në zonë për periudhën otomane dhe Moderne të hershme. Modeli i okupimit njerëzor që shfaqet është ai që fokusohet në disa periudha të veçanta historike: epoka neolitike, epoka e bronzit/hekurit dhe mesjetare/moderne e hershme.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

4.3.10 Transporti dhe Aksesi

Vendi i propozuar për ndërtimin e TEC Korçë ndodhet në pjesën veri-lindore të qytetit të Korçës, pranë impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Vendi është tashmë i aksesueshëm për shkak të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura që aktualisht është në punë. Rrugët në këtë zonë klasifikohen si rrugë rurale dhe janë të shtruara me çakëll. Pjesë të rrugëve përdoren gjithashtu nga banorët e zonës që hyjnë në tokat bujqësore, në jug të zonës së propozuar të Projektit.

4.3.11 Edukimi dhe Arsimi

Korça është një nga qendrat më të rëndësishme kulturore në Shqipëri. Edukimi dhe arsimi konsiderohen gjithmonë si një aspekt i rëndësishëm për zhvillimin e jetës shoqërore dhe profesionale për banorët e Korçës. Korça është e njohur edhe për shkollën e parë shqipe e cila u hap në këtë qytet në vitin 1887, si shkolla e parë në Shqipëri për vajzat, e ndjekur nga Liceu francez i ndërtuar në vitin 1917.

Korça sot numëron shumë shkolla fillore dhe të mesme dhe gjithashtu një universitet publik i cili operon në disa disiplina të teknologjisë dhe tregtisë, si dhe degëve ekonomike. Edhe fshatrat dhe komunitetet në rrethin e Korçës kanë shkolla fillore dhe në disa zona shkolla të mesme (të cilat janë një nivel i detyrueshëm arsimor), të cilat mbulojnë dhe edukojnë të gjithë fëmijët dhe adoleshentët nga zonat në afërsi.

Bazuar në statistikat, niveli i shkollës fillore gjatë vitit 2016 - 2017 kishte gjithsej 11,892 fëmijë që përfunduan klasën e 9-të të arsimit, ku 5,557 ishin femra. Në të njëjtin vit statistikor që raporton arsimin e mesëm (klasat X deri në XII) numërohen gjithsej 5,116 adoleshentë prej të cilëve 2,271 janë femra.

4.3.12 Shëndeti i Komunitetit

Përgjithësisht, në të gjithë fshatrat e Bashkisë së Korçës ka të paktën një qendër shëndetësore (ambulancë). Këto qendra shëndetësore ofrojnë shërbime bazë dhe ndihmën e parë. Qendra kryesore shëndetësore në territorin e Korçës është spitali i qytetit të Korçës. Informacioni përkatës lidhur me shëndetin e komunitetit në territorin e Bashkisë së Korçës do të grumbullohet gjatë fazës së studimit për VNMS.

4.3.13 Fokus Grupet

Intervista me një fokus grup është një formë interviste në grup në të cilën:

- Ka disa pjesëmarrës (duke përfshirë edhe konsulentin);
- Zhvillohet në formë pyetësorësh për një temë të caktuar; dhe,

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Vë theksin në ndërveprimin brenda grupeve të ndryshme dhe në ndërtimin e përbashkët të kuptimit për çështjen/temën e trajtuar.

Ndërveprimi brenda grupeve të ndryshme është një aspekt me interes dhe është më i fokusuar se sa një intervistë në grup. Fokus grupet ofrojnë një forum për pjesëtarët vulnerabël të shoqërisë dhe lejojnë diskutime të hapura për ndikimet e mundshme të projektit. Në çdo vendbanim të gjithë zonës së studimit, do të anketohen grupet vulnerabël si fermerët dhe të moshuarit, të cilët do të jenë në fokus të grupeve të interesit në komunitet. Zakonisht, gratë nuk marrin pjesë në takimet me komunitetin për arsye tradite dhe kulturore. Për të adresuar këto mangësi, takimet e fokus grupeve me gratë do të zhvillohen në të gjitha vendbanimet të cilët do jenë pjesë e studimit për të siguruar marrjen e mendimit të tyre dhe ngritjen e shqetësimeve apo komenteve që mund të kenë. Si përfundim, grupet vulnerabël në komunitetet gjatë fazës së studimit do të përfshijnë gratë, fermerët dhe të moshuarit.

Analiza e hollësishme për aspektet socio-ekonomike do të shqyrtohet gjatë fazës së studimit dhe mbledhjes së të dhënave për pjesën sociale me qëllim që të kuptohen më mirë grupet e ndryshme në komunitet dhe mënyra se si ato mund të ndikohen nga zhvillimi i propozuar.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

5 ANGAZHIMI ME PALËT E INTERESUARA

5.1 HYRJE

5.1.1 Të Dhëna të Përgjithshme

Ky Kapitull përshkruan aktivitetet që Konsulenti ka kryer për angazhimin dhe konsultimin me aktorët kryesorë gjatë fazës së studimit për VNMS. Në kapitull përshkruhet procesi me të cilin janë identifikuar palët e interesit, mjetet me të cilat janë kontaktuar dhe rezultatet e aktiviteteve të angazhimit me palët e interesuara deri në këtë fazë, si dhe veprimet që Konsulenti ka ndërmarrë për të shpërndarë dhe grumbulluar informacion për projektin të palët e interesuara.

Ky dokument gjithashtu paraqet një kornizë përmbledhëse të planit për Angazhimin me Palët e Interesuara në mënyrë që të sigurohet angazhimi edhe gjatë procesit të VNMS-së, ndërtimit të termocentralit, si dhe gjatë fazës së funksionimit.

5.1.2 Qëllimi i Angazhimit me Palët e Interesuara

Angazhimi me palët e interesuara është një proces i vazhdueshëm i ndarjes së informacionit në lidhje me projektin, kuptimit të shqetësimeve të palëve të interesuara dhe ndërtimit të marrëdhënieve të bazuara në bashkëpunim. Konsultimi me palët e interesuara është një element kyç i angazhimit gjatë procesit të VNMS dhe thelbësor për zhvillimin efektiv të projektit. Dhënia dhe publikimi i informacioneve është po aq vitale.

Nëse zhvillimi i një projekti të propozuar paraqet rreziqe ose ndikime të mundshme negative, konsultimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe t'u ofrojë palëve të interesuara mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre. Në përputhje me udhëzimet aktuale nga IFC, konsultimi duhet të sigurojë 'konsultim të lirë, paraprakë dhe të informojë komunitetin/et e ndikuara' (IFC, 2012). Me fjalë të tjera, konsultimi efektiv kërkon zbulimin paraprak të informacionit relevant rreth Projektit për t'u mundësuar palëve të interesuara të kuptojnë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë.

Programi i konsultimit të projektit synon të sigurojë që shqetësimet e palëve të interesuara të merren në konsideratë, të trajtohen dhe të përfshihen në procesin e zhvillimit, veçanërisht gjatë procesit të VNMS.

5.1.3 Objektivat

Procesi i angazhimit me palët e interesuara është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të përdorura, duke përfshirë Standardet e Performancës së IFC.

Për këtë Projekt, objektivat kryesorë për angazhimin me palët e interesuara janë:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- të informojë dhe këshillojë palët e interesuara për Projektin e propozuar;
- mbledhja e njohurive lokale për të përmirësuar kuptimin e kontekstit mjedisor dhe social;
- të kuptohen më mirë çështjet e rëndësishme për tu marrë në konsideratë në vendin/zonën e synuar për zhvillim;
- t'u mundësojë aktorëve dhe palëve të interesuara të përfshihen në procesin e planifikimit të projektit;
- të marrë parasysh pikëpamjet e palëve të interesit në zhvillimin e masave efektive zbutëse dhe planeve të menaxhimit; dhe
- të vendosen 'themelet' për angazhimin me palët e interesuara në të ardhmen.

5.1.4 *Plani i Angazhimit me Palët e Interesuara*

Në mënyrë që të përmbushen objektivat për angazhimin me palët e interesuara, Konsulenti ka hartuar një plan për angazhim gjatë gjithë ciklit të zhvillimit të Projektit.

Plani përcakton procesin për konsultim dhe zbulim të informacionit bazuar në Standardet e IFC. Plani përfshin katër faza për Angazhimin me Palët e Interesuara, të cilat listohen si më poshtë:

- Faza e Studimit;
- Faza e Studimit në Terren për VNMS;
- Faza e Zbulimit të Informacionit për VNMS; dhe
- Faza e Zhvillimit të Projektit (ndërtim dhe funksionim).

Në, vazhdim, paragrafet e mëposhtme ofrojnë një pasqyrë të aktiviteteve të angazhimit që janë kryer deri më sot dhe ato që janë planifikuar për secilën nga fazat e mëvonshme.

5.2 *FAZA E STUDIMIT*

5.2.1 *Identifikimi i Palëve të Interesuara*

Gjatë fazës së studimit (scoping) është përgatitur një listë paraprake e aktorëve apo palëve të interesuara për projektin. Kjo listë përbëhet nga individë, grupe dhe organizata/insitucione, të cilat mund të ndikohen pozitivisht apo negativisht nga zhvillimi i projektit. Lista është zhvilluar duke përdorur udhëzimet ndërkombëtare të IFC-së dhe ka marrë në konsideratë grupet e mëposhtme:

- institucionet qeveritare kombëtare, rajonale dhe lokale;
- udhëheqësit/drejtuesit e komunitetit/ve lokale;
- anëtarët e komunitetit duke përfshirë nën-grupe vulnerabël si gratë, fermerët dhe të moshuarit;
- organizatat jo-qeveritare mjedisore dhe sociale kombëtare, rajonale dhe lokale (OJQ);

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Kjo listë me palët e interesuara paraqitet në Tabelën 5.1 dhe do të rishikohet vazhdimisht (zgjerohet ose zvogëlohet sipas nevojës) gjatë gjithë studimit të VNMS.

5.2.2 *Përgatitja e Dokumentit Përmbledhës të Informacionit (DPI)*

Gjatë fazës së studimit, është hartuar një Dokument Përmbledhës Informacioni, i shkurtër, për angazhimin me palët e interesuara në lidhje me Projektin (Shtojca B). Ky dokument shpjegon projektin dhe procesin e VNMS-së në terma të thjeshtë, dhe ofron detaje se si dhe ku mund të jepen komentet dhe sugjerimet.

DPI është përdorur për të shpërndarë informacionin bazë të Projektit tek palët e interesuara në konsultimin publik të fazës së studimit, dhe do të përdoret gjithashtu si një mjet informimi për palët e interesit shtesë dhe për aktivitetet e takimeve me publikun dhe angazhimet e tjera gjatë procesit të VNMS.

5.2.3 *Njoftimi i Palëve të Interesuara gjatë Fazës së Studimit*

Njoftimi i palëve të interesuara është kryer përmes një letre ftesë, e cila është përgatitur për të kryer takimet/mbledhjet me palët e interesuara për të prezantuar Projektin e propozuar dhe për të ftuar personat e interesuar për pjesëmarrje në Fazën e Studimit të VNMS-së dhe Konsultimit Publik për këtë fazë. Këto letra njoftimi iu shpërndanë grupeve kryesore të identifikuar të palëve të interesit, të cilat paraqiten të listuara në Tabelën 5.1 më poshtë. Format të tjera të njoftimeve të përdorura për shpërndarjen e informacionit dhe kryerjen e konsultimeve për fazën e studimit përfshijnë vendosjen e posterave në fshatrat e ndikuar dhe në qytetin e Korçës, si dhe shpërndarjen e broshurave informuese.

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 5.1 Lista e Projektit për aktivitetet me Palët e Interesuara

Niveli i Grupit të Interesit	Palët e Interesuara të Identifikuara	Niveli i Grupit të Interesit			Aktiviteti i Angazhimit	
		Kombëtar	Rajonal	Lokal	Takim	Ftesë/Letër
<i>Nivel Kombëtar</i>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	X			X	X
	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural	X			X	X
	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	X			X	X
	Ministria e Kulturës	X			X	X
	Ministria e Drejtësisë	X			X	X
	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	X			X	X
	Ministria e Mbrojtjes	X				X
	Ministria e Financave dhe Ekonomise	X				X
	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	X			X	X
	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	X			X	X
	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	X			X	X
	Agjencia e Planifikimit Kombëtar të Territorit	X			X	X
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	X			X	X
	Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë	X			X	X
	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	X			X	X
	ERRE - Enti Rregullator i Energjisë	X			X	X
Inspektoriat Kombëtar i Ujit	X			X	X	
<i>Rajonal</i>	Prefektura e Korçës		X		X	X
	Agjencia e Zhvillimit Rajonal të Korçës		X		X	X
	Drejtoria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural		X		X	X
	Këshilli Rajonal i Korçës		X		X	X
	Drejtoria Rajonale Mjedisore Korçë		X		X	X

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Niveli i Grupit të Interesit	Palët e Interesuara të Identifikuara	Niveli i Grupit të Interesit			Aktiviteti i Angazhimit	
		Kombëtar	Rajonal	Lokal	Takim	Ftesë/Letër
	Drejtoria Rajonale e Pyjeve në Korçë		X		X	X
	Drejtoria Rajonale e Rrugëve		X		X	X
	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit		X		X	X
	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë		X		X	X
	Njësia Administrative Qender Bulgarec		X		X	X
	Maliq (Njësia Administrative Pojan)		X		X	X
	Bashkia e Korçës		X		X	X
(NGOs)	Agjencia për Zhvillimin Rural		X		X	
Takimet me Komunitetin Lokal	Qyteti i Korçës			X	X	
	Barç			X	X	
	Malavec			X	X	
	Çiflig			X	X	
	Dishnicë			X	X	
Konsultimi me Publikum Korçë (Zyrrat Lokale, Rajonale) Bld.Republika, Lagja 3, Korçë, Shqipëri	Institucione Rajonale dhe Lokale		X		X	
	OJQ's (përfshirë rajonale dhe lokale)			X	X	
	Organizata Akademike dhe Kërkimore të interesuara			X	X	
	Drejtuesit e Fshatrave (dhe kryepleqtë)			X	X	

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Niveli i Grupit të Interesit	Palët e Interesuara të Identifikuara	Niveli i Grupit të Interesit			Aktiviteti i Angazhimit	
		Kombëtar	Rajonal	Lokal	Takim	Ftesë/Letër
	Përfaqësues nga Shoqëria Civile (nëse ka)			X	X	

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

5.2.4 *Konsultimi me Publikun gjatë Fazës së Studimit*

Konsultimi fillestar për fazën e studimit u krye më anë të një dëgjese publike prej 1.5 orësh të mbajtur më 29 Maj 2018 në Hotel Grand, Korçë, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga komuniteti lokal, institucionet lokale dhe rajonale, si dhe palë të tjerë të interesuara. Banorët vendas nga komunitetet në dhe përreth zonës së Projektit u përfshinë gjithashtu në takimet fillestare të fazës së studimit të kryera nga Konsulenti. Megjithatë, angazhimi me komunitetin e ndikuar dhe palët e tjera të interesuara do të vazhdojë edhe gjatë VNMS.

Takimi për fazën e studimit u organizua nga ABKONS Ltd, GPP Korça dhe IVICOM Consulting, ku morën pjesë grupe të ndryshme të palëve të interesuara, përfshirë përfaqësues nga Bashkia e Korçës. Takimi i kësaj faze shërbeu për të dhënë informacion te palët e interesuara në lidhje me projektin dhe procesin e VNMS, si dhe për të marrë reagimet e tyre shqetësimet dhe çështjet kryesore që duhet të merren në konsideratë. Qëllimi ishte identifikimi i shqetësimeve kryesore ose çështjeve më rëndësi që palët e interesuara kishin në këtë fazë fillestare të procesit të VNMS.

Konsultimi me publikun u krye me anë të një prezantimi në PoëerPoint ku u pasyruan elementet hyrës të Projektit, një përmbledhje e procesit të VNMS, metodologjia e studimit në terren dhe zonat e influencës (AoI), si dhe metodologjia e vlerësimit të çështjeve mjedisore dhe sociale. Konsultimi me publikun përfshiu gjithashtu një forum të hapur për diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit. Diskutimet dhe komentet e ngritura u regjistruan dhe procesverbalet e mbledhjes dhe regjistri i pjesëmarrësve janë paraqitur në Shtojcën A (raporti i Minutat e Takimit).

5.3 *STUDIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE PËR VNMS*

5.3.1 *Hyrje*

Aktivitetet e angazhimit të kryera në fazën e studimit të VNMS-së do të përfshijnë konsultime për të informuar aktorët lokalë në lidhje me projektin, për të marrë shqetësimet e tyre kryesore, për të ngritur çështjet e rëndësishme dhe për të informuar rreth zbutjes së ndikimeve të mundshme të Projektit. Kjo mënyrë konsultimi do t'i mundësojë ekipit të ekspertëve të VNMS-së të përmirësojnë analizën e tyre duke marrë informacione shtesë mbi qasjen ndaj VNMS-së, çështjeve kyçe dhe analizën e ndikimeve të mundshme (të tilla si vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve).

5.3.2 *Angazhimi me Palët e Interesuara*

Konsultime të mëtejshme mund të kryhen me palët e interesuara të konsultuara më parë gjatë fazës së studimit. Kjo mund të përfshijë takime dhe shkëmbime informacioni gjatë procesit të VNMS-së me institucionet qeveritare të renditura më poshtë, por pa u kufizuar në:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
- Bashkia e Korçës;
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit Korçë (DRM Korçë);
- Institucione të tjera relevante.

5.3.3 *Angazhimi me Komunitetin*

Angazhimi me Komunitetin në këtë fazë të VNMS është vendosur në mënyrë të tillë që të mbledhë dhe grumbullojë të dhëna socio-ekonomike dhe do të shtrihet në fazën e studimit në terren. Të dhënat gjatë fazës së studimit në terren do të merren nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave, si një element kyç i studimit social dhe shëndetësor të komunitetit. Informacioni do të grumbullohet në zonat e identifikuara të interesit, brenda "Zonës së Influencës (AoI)", më saktësisht brenda rrezes 2 km nga vendi i propozuar i termocentralit të gazit dhe brenda një korridori prej 2 km të gjerë (1 km në të dy anët e vijës qendrore) për linjën elektrike ajrore (linja e transmetimi në NS Zëmlak).

Vëzhgimi në terren do të kryhet me anë të një pyetësori të plotë për personat e ndikuar drejtpërdrejtë dhe do të shërbejë si një mbledhje e të dhënave cilësore në vend. Nga ana tjetër, Zona e Influencës (AoI) do të merret në konsideratë dhe do të mbulohet në shkallë sipas zonave të banuara për zhvillimin e pyetësorëve në mënyrë që të studiohet e gjithë zona e ndikuar nga projekti i propozuar.

Përsa më sipër, do të kryhet një shpërndarje gjeografike paraprake e zonës, bazuar në:

- popullsinë/banorët e çdo fshati;
- zonën e fshatit (ndikimi nga projekti në m²);
- mbulimin e tipologjisë së tokës/parcelave/banesave të të gjithë zonës së projektit për çdo fshat (duke përfshirë tokën/kullotat/fermat/banesat/zonat e zhvillimit të biznesit, etj.);
- zbulimi i çdo pike interesi - për secilin fshat.

Aktivitete të tjera të rëndësishme përfshijnë të kuptuarit nëse ka zona të ndjeshme që mund të kenë nevojë për ndryshime në projektin e deritanishëm të, stacionet e ekspozimit ose zonat që kërkojnë zbatimin e masave të veçanta zbutëse. Përveç kësaj, ekipi duhet të vëzhgojë se si rriten vendbanimet, me çfarë shpejtësie dhe në cilin drejtim (dmth., në ose larg nga çdo vendodhje të objekteve) përveç zonave ku do të kryhet aktiviteti i planifikuar në të ardhmen.

Vëzhgimet në terren do të përfshijnë gjithashtu profilizimin e infrastrukturës sociale dhe shëndetësore dhe vëzhgime të nivelit të trafikut në zonë. Ekipi i ekspertëve të projektit do të përdorë studimet e mëparshme dhe zbulimin e pjesshëm të sipërfaqes së ndikuar për të identifikuar zonat apo vendet e klasifikuara si trashëgimni kulturore. Vëzhgimet në terren do të kërkojnë regjistrimin e pikave të studiuara me GPS dhe të paktën dy fotografive të

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

secilit prej vendeve në fjalë. Të gjitha informacionet, duke përfshirë një përshkrim të detajuar të zonave dhe çdo çështje të mundshme që do konsiderohet e rëndësishme nga ekspertët përkatës. Informacionet do të regjistrohen në një format raport më koordinatat përkatëse dhe fotografitë e zonës.

DIP ose dokumente të tjera informative (p.sh. fletushkat/broshurat) do t'i shpërndahen komunitetit përpara takimeve të konsultimit të planifikuara. Këto dokumente do të shpjegojnë projektin dhe procesin e VNMS-së në terma të thjeshtë dhe do të japin detaje mbi datat dhe vendet për konsultimet e ardhshme më komunitetin.

Rezultatet e këtyre konsultimeve dhe komentet/pyetjet e ndryshme do të paraqiten në raportin përfundimtar të VNMS.

5.3.4 *Angazhimi me Palët e Tjera të Interesuara dhe Publikun e Gjerë*

Dokumenti Përmbledhës i Informacionit (DPI) do të përdoret si mjet informimi sipas nevojës dhe mund të përdoret në mënyrat si më poshtë:

- DPI do t'i shpërndahet palëve të interesuara gjatë takimeve publike që do kryhen për të diskutuar mbi projektin, ndikimet e mundshme dhe masat e propozuara zbutëse; dhe
- DPI mund t'i bashkëngjitet një letre të dërguar palëve të interesuara kryesore që të njoftojë se është duke u zhvilluar procesi VNMS për projektin.

Informimi i palëve të interesuara mund të kryhet edhe nëpërmjet metodave të tjera si fletushka, postera, fletëpalosje, etj.

5.4 **ZBULIMI I INFORMACIONIT PËR VNMS**

5.4.1 *Metodologjia*

Pas publikimit online dhe dorëzimit të draft Raportit të Studimit të VNMS në MTE (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), parashikohet që ky raport do t'i nënshtrohet një rishikimi nga ekspertët e MTE, AKM-së dhe institucioneve të tjera kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe rishikimin nga specialistë të jashtëm të fushave përkatëse (ekspertë mjedisorë dhe socialë). Të gjitha komentet, sugjerimet dhe pyetjet që lidhen me raportin dhe projektin mund të adresohen në faqen zyrtare të GPP Korça. Pas periudhës së shqyrtimit të Raportit të Studimit për VNMS, gjetjet dhe komentet do të grumbullohen dhe do të adresohen sipas procedurave dhe udhëzimeve në përputhje me Standardet e IFC. Projekti pastaj do të duhet të ndërmerret veprimet e duhura për të adresuar këto gjetje dhe komentet e marra nga autoritetet publike dhe qeveritare për Raportin e Studimit të VNMS. Komentet mund të sjellin përfshirjen e studimeve shtesë për projektin; rishikimin e tekstit të Raportit të

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Studimit të VNMS për të korrigjuar ose sqaruar përmbajtjen e tij; ose marrjen e veprimeve shtesë të menaxhimit për fazat e ardhshme të VNMS.

Pas përfundimit të procesit dhe marrjes së veprimeve të nevojshme për të adresuar gjetjet, drafti i Raportit të Studimit VNMS do të finalizohet dhe MTE mund të lëshojë autorizimin për VNMS përfundimtare.

5.4.2 Mekanizmi i Ankesave

GPP Korça do të krijojë një mekanizëm ankimi për të qenë në dijeni të problematikave dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të palëve të interesit, si dhe për të lehtësuar zgjidhjet për ankesat e mundshme nga palët e interesit. Mekanizmi i ankesave do t'i adresojë shqetësimet menjëherë dhe në mënyrë efektive, duke praktikuar një proces të kuptueshëm dhe transparent, i cili është i përshtatshëm në aspektin kulturor dhe lehtësisht në ndihmë për të gjithë segmentet e palëve të ndikuara, pa kosto dhe pa masa administrative.

Praktikat më të mira ndërkombëtare përshkruajnë kërkesat e nevojshme për mekanizmat e ankesave. Mekanizmat e ankesave duhet të marrin dhe lehtësojnë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të komuniteteve të ndikuara. Ky proces përfshin një mekanizëm të pavarur dhe objektiv, i cili nuk do të pengojë qasjen në mjetet juridike apo administrative.

Procesi i marrjes së ankesave përfshin hapat e mëposhtëm:

- Identifikimin;
- Regjistrimin dhe kategorizimin;
- Njohjen e së Drejtës së personit ankimes;
- Hetimin / investigimin dhe përgjigjen;
- Komunikimin e përgjigjes dhe kërkesës për reagimet mbi çështjen nga ana e palëve të interesuara; dhe,
- Mbylljen e procesit.

Për të siguruar që mekanizmi i ankesave është aktiv dhe gjithëpërfshirës, palët e interesuara kanë disa metoda komunikimi në dispozicion të tyre për të raportuar një ankesë.

Këtu përfshihen ankesat:

- **Verbale:** Palët e interesuara mund të kontaktojnë Zyrën e GPP Korça në numrin e mëposhtëm 067 520 6606. Ankesat verbale u drejtohen përfaqësuesve të GPP Korçës, të cilët do të plotësojnë formularin e ankesave me të gjitha detajet e kërkuara dhe do t'ia kalojnë atë Menaxherit të Angazhimit me Palët e Interesuara në zyrën qendrore; dhe,
- **Me shkrim:** Palët e interesuara mund të dorëzojnë ankesën e tyre duke plotësuar një formular ankesë që do të jetë në dispozicion në zyrën qendrore ose më lehtësisht, ata mund të dorëzojnë shqetësimin e tyre me email në adresën qa@gppkorca.com ose me shkrim në adresën e mëposhtme:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

GPP KORÇA

Adresa: Lagjja Nr. 1, Pogradec, Shqipëri

Email: qa@gppkorca.com

Telefon: 067 520 6606

Në këtë mënyrë, është e rëndësishme të sigurohet që këto ankesa të pranohen, të hetohen dhe brenda një kohe të shkurtër të zgjidhen dhe më pas të jenë në gjendje të zgjidhen të gjithë ankesat e hapura për komunitetin. **Ankesat mund të jenë një tregues i shqetësimeve në rritje të palëve të interesuara (reale dhe të perceptuara) dhe mund të përshkallëzohen nëse nuk identifikohen dhe nuk zgjidhen. Menaxhimi i ankesave është një komponent vital i menaxhimit të palëve të interesuara dhe një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për një projekt.**

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

6 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMEVE PËR PROCESIN E VNMS

6.1 HYRJE

Një ndikim konsiderohet të jetë çdo ndryshim në një burim ose receptor i cili vjen si pasojë e pranisë së një komponenti të Projektit ose nga ekzekutimi i një aktiviteti të lidhur me Projektin. Vlerësimi i ndikimeve negative dhe pozitive të mundshme që lidhen me Projektin kërkon një metodologji të mirëpërcaktuar dhe sistematike në mënyrë që të përcaktojë saktësisht rëndësinë e ndikimit të parashikuar ose përfitimin nga mjedisi rrethues biofizik dhe/apo socio-ekonomik dhe të zvogëlojë subjektivitetin e përfshirë në vlerësim.


Për fazën e vlerësimin të ndikimit të procesit të VNMS-së do të përdoret një sistem i përcaktuar qartë për të vlerësuar ndikimet e mundshme në mënyrë që të arrihen objektivat e mëposhtme:

- të zbatojë një analizë rigorozë për vlerësimin dhe përcaktimin e shkallës së zhvillimit të impiantit të propozuar të energjisë dhe infrastrukturës mbështetëse;
- të prioritarizojë dhe të ofrojë masa zbutëse dhe përmirësuese për ndikimet e parashikuara; dhe,
- të sigurojë masa të sakta dhe të zbatueshme në mënyrë që të zvogëlohen ndikimet negative, të rriten përfitimet dhe të përcaktohet një program monitorimi për ndikimet e mundshme mbetëse në mjedis.

Procesi i vlerësimin të ndikimeve në mjedis dhe sociale paraqitet i përmbledhur në figurën 6.1. Në vijim, në paragrafet e mëposhtme përshkruhen parimet dhe hapat e metodologjisë së vlerësimin të ndikimeve.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 6.1 Përmbledhje e Procesit të VNMS



Burimi: Përshtatur nga Udhëzimet e IFC-së

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

6.2 FAZA E SHQYRTIMIT

Faza e Shqyrtimit (screening) është faza fillestare e procesit të bazuar në Procedurën e IFC për Shqyrtimin Mjedisor dhe Social të Projekteve për të vendosur nëse nevojitet një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për Projektin e propozuar dhe për të përcaktuar shtrirjen e nevojshme të analizës mjedisore. Qëllimi i fazës së shqyrtimit të projektit është të përcaktojë natyrën dhe shkallën e vlerësimit mjedisor të nevojshëm për projektin. Sipas manualit të IFC-së, OP.4.1, Vlerësimi Mjedisor, projektet kategorizohen sipas kategorive A, B, C ose FI të shqyrtimit mjedisor. Klasifikimi i një projekti varet nga lloji i projektit, vendndodhja, ndjeshmëria dhe shtrirja e projektit, si dhe nga natyra dhe magnituda e ndikimeve të mundshme të tij. Në përputhje me këto kërkesa, niveli i parë i vlerësimit të ndikimit përfshin identifikimin paraprak dhe shqyrtimin e ndikimeve të mundshme mjedisore duke parashikuar ndërveprimet e aktivitetiteve me mjedisin. Kjo kërkon një kuptim të aktivitetiteve të projektit (përshkrimi i projektit), vendodhjen e projektit (përshkrimi biofizik dhe socio-ekonomik), dhe ndërveprimin me komponentët e mjedisit.

6.3 FAZA E STUDIMIT

Në fazën e studimit (scoping), çështjet kryesore të identifikuar gjatë fazës së shqyrtimit do të hetohen më tej përmes analizës së shqyrtimit në zyrë dhe intervistave me palët e interesuara për të konstatuar nëse nevojitet informacion shtesë për të vlerësuar kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale, si dhe ndikimet e mundshme brenda Zonës së Influencës së Projektit. Vlerësimi dhe studimi i informacioneve në zyrë përfshin shqyrtimin e të dhënave mjedisore dhe sociale të mbledhura nga burime të jashtme, informacioneve të publikuara dhe studimeve të mëparshme në zonën apo përreth zonës së Projektit.

Konsulenti dhe përfaqësuesit e Investitorëve të Projektit kryejnë takime me grupet e palëve të interesuara të identifikuar (p.sh. autoritetet qeveritare, agjencitë, autoritetet rajonale dhe lokale dhe OJQ-të e interesuara) dhe përfaqësuesit e komuniteteve lokale për të diskutuar mbi projektin e propozuar dhe metodologjinë e studimeve, përfshirë alternativat dhe kriteret për vlerësimin e ndikimit, si dhe të përcaktojnë nëse do të nevojiten të dhëna plotësuese gjatë fazës së studimeve në terren për të kryer një analizë gjithëpërfshirëse përgjatë procesit. Objektivat kryesore për Fazën e Studimit janë:

- Identifikimi i palëve të interesuara dhe informimi i tyre për projektin e propozuar dhe procesin e VNMS;
- T'i ofrojë mundësinë palëve të interesuara për të identifikuar çdo çështje me rëndësi dhe/apo shqetësime të tyre, të cilat lidhen me Projektin e propozuar;
- Të identifikojë zonat që mund të jenë subjekt i ndikimeve të mundshme ose që mund të rezultojnë në shkaktimin e çështjet/problematikave mjedisore dhe sociale, të cilat mund të kërkojnë investigime të mëtejshme në procesin e VNMS-së (përfshirë rezultatet fillestare të fazës së shqyrtimit);

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Të sigurojë një përcaktim paraprak të Zonave të Influencës (AoI) për projektin me qëllim kryerjen e studimeve të thelluara gjatë fazës së studimit në terren të kushteve mjedisore dhe sociale të zonës;
- Të përcaktojë një përmbledhje të Termave të Referencës (ToR) për studimet në terren dhe vlerësimin e ndikimeve bazuar në të dhënat fillestare të grumbulluara nga takimet me palët e interesuara; dhe publikimin e Raportit të Studimit të VNMS-së për shqyrtim nga publiku i gjerë dhe marrja e komenteve nga palët e interesuara.

Pas identifikimit paraprak të ndikimeve gjatë fazës së shqyrtimit dhe fazës së studimit, do të kryhet një vlerësim i detajuar i të gjitha ndikimeve të mundshme mjedisore dhe socio-ekonomike si pjesë e VNMS-së së thelluar.

6.4 FAZA E STUDIMIT TË KUSHTEVE EKZISTUESE TË MJEDISIT DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE

Bazuar në çështjet kryesore të identifikuar në fazën e studimit, do të kryhet grumbullimi i informacioneve të disponueshme për kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale. Këto informacione do të plotësohen nga studimet në terren dhe vëzhgimet e detajuara aty ku do jetë e nevojshme. Studimi i kushteve ekzistuese të burimeve fizike, biologjike, socio-ekonomike (përfshirë aspektet sociale, ekonomike dhe shëndetësore) ofron një pikë referimi ndaj së cilës mund të vlerësohen ndryshimet në të ardhmen të cilat lidhen me projektin dhe do ofrojë informacion për monitorimin e mëtejshëm të performancës mjedisore.

Në përgjithësi, informacioni mbi kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale bazohet në studimet e specializuara në zonë, mbledhjen e të dhënave dytësore dhe marrjen e informacionit apo ndërveprimin në terren me palët e interesuara. Informacioni dytësor për kushtet ekzistuese të mjedisit do të burojë nga informacionet e publikuara, duke përfshirë artikujt e fundit shkencor, literaturën jo-teknike (raportet mjedisore, artikujt dhe dokumentet e tjera të VNM dhe VSM, në rastet kur janë të disponueshme), informacione në internet dhe burime të tjera dytësore të të dhënave.

Për projektin e propozuar të TEC Korçës do të kryhen studime të specializuara në mënyrë që të përshkruhen kushtet ekzistuese të mjedisit brenda Zonave të Influencës për projektin. Këto studime listohen si më poshtë:

- Studimi i Cilësinë e Ajrit dhe Modelimi i Shpërndarjes së Gazeve në Ajër;
- Studimi i Tokës;
- Studimi i Ujërave Nëntokësorë (përfshirë dy puset e nevojshme për termocentralin e gazit);
- Studimi i Ujërave Sipërfaqësorë;
- Studimi i Zhurmave dhe Ndriçimit;
- Studimi i Biodiversitetit (flora, fauna dhe zonat e mbrojtura);
- Studimi i Trashëgimisë Kulturore; dhe,
- Studimi Socio-ekonomik (përfshirë aspektin social, ekonomik dhe shëndetësor).

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

6.4.1 *Përkufizimi i Zonave të Influencës sipas BERZH*

VNMS qartë përcakton se çfarë nënkuptohet ndryshe si "zona e studimit" ose "zona e influencës" për Projektin dhe VNMS-në e saj. BERZH përcakton në mënyrë specifike zonat e influencës sipas termave të paraqitur më poshtë, të cilat përdoren si udhëzime për të përcaktuar elementët e projektit që i nënshtrohen studimit në këtë VNMS.

Zona e Influencës ndryshon në varësi të llojit të ndikimit që merret në konsideratë. Në çdo rast ajo përfshin të gjitha fushat brenda të cilave ka gjasë të ketë ndikime të konsiderueshme dhe merr parasysh shtrirjen fizike të punimeve/aktiviteteve të propozuara, të përcaktuara nga kufijtë e tokës që do të merren ose përdoren (në mënyrë të përkohshme apo të përhershme) nga projekti dhe natyra e mjedisit ekzistues, si dhe mënyrën në të cilën ndikimet ka të ngjarë të përhapen/shpërndahen përtej kufirit të projektit.

- i. "Asetet dhe pajisjet/objektet në pronësi të drejtpërdrejtë ose të menaxhuara nga klienti që lidhen me aktivitetet e projektit që do të financohen (të tilla si impiantet e prodhimit, linjat e transmetimit të energjisë, tubacionet, kanalet, portet, rrugët e aksesit dhe kampet e ndërtimit)." Këto çështje vlerësohen automatikisht në VNMS.
- ii. "Aktivitetet mbështetëse, asetet dhe objektet në pronësi ose nën kontrollin e palëve të kontraktuara për llogari të aktiviteteve të klientit ose për përfundimin e projektit (siç janë kontraktorët)."
- iii. "Objektet e shoqëruara ose punët e tjera që nuk financohen nga BERZH si pjesë e projektit dhe mund të jenë subjekte të ndara ligjore, por qëndrueshmëria dhe ekzistenca e të cilëve varet ekskluzivisht nga projekti dhe mallrat dhe shërbimet e të cilëve janë thelbësore për zhvillimin e suksesshëm të projektit".
- iv. "Objektet, operacionet dhe shërbimet e zotëruara ose të menaxhuara nga klienti të cilat janë pjesë e paketës së sigurisë të marrë përsipër në BERZH si kolateral".
- v. "Zonat dhe komunitetet mund të ndikohen nga: ndikimet kumulative nga zhvillimet e mëtejshme të planifikuara të projektit ose burime të tjera të ndikimeve të ngjashme në zonën gjeografike, çdo projekt ekzistues apo kusht ekzistues dhe zhvillime të tjera të lidhura me projektin që realisht mund të priten në kohën kur të ndërmerret due diligence". Këto çështje vlerësohen si pjesë e VNMS-së.
- vi. "Zonat dhe komunitetet potencialisht të prekura nga ndikimet si pasojë e zhvillimeve të paplanifikuara, por të parashikueshme të shkaktuara nga projekti të cilat mund të ndodhin më vonë ose në një vendodhje tjetër. Zona e Influencës nuk përfshin ndikimet e mundshme që do të ndodhin pa projektin ose pavërsisht nga zhvillimi i projektit". Këto çështje vlerësohen si pjesë e VNMS-së.

6.4.2 *Përcaktimi Përfundimtar i Zonave të Influencës për Projektin*

Shtrirja e efektit të një aktiviteti të projektit mbi një burim të veçantë fizik, biologjik ose social mund të ndryshojë dhe për këtë arsye përcaktohet një zonë e quajtur Zona e Influencës (AoI). Referuar projektit të propozuar, do të ketë një zonë të caktuar influencë për

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

secilin nga aspektet/elementët mjedisorë, përfshirë edhe aspektin socio-ekonomik. Paraprakisht është kryer një identifikim i Zonave të Influencës, megjithatë mund të ketë ndryshime gjatë fazës së studimeve të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale në rastet kur do të konsiderohet e nevojshme nga specialistët përkatës të fushave.

Në mënyrë të veçantë, Zonat e Influencës (AoI) përfshijnë:

- Zonat që kanë gjasa të ndikohen nga: Projekti, Aktivitetet e Projektit dhe Objektet/Pajisjet e Projektit (Zona e Influencës direkte); dhe zhvillimi i paplanifikuar por i parashikueshëm i shkaktuar nga zhvillimi i Projektit që mund të ndodhë më vonë apo në një zonë tjetër (Zona e Influencës indirekte);
- Objektet apo zonat në përdorim, të cilat janë zona apo objekte që nuk janë pjesë e projektit, por janë të nevojshme dhe të cilat nuk do të ndërtoheshin apo zgjeroheshin nëse Projekti nuk do ekzistonte dhe pa të cilat Projekti nuk do të ishte i zbatueshëm; dhe
- Ndikimet kumulative që rezultojnë nga impakti në rritje në fushat ose burimet e ndikuara drejtpërdrejt nga Projekti nga zhvillimet e tjera ekzistuese, të planifikuara ose të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme.

Konsulentit konsideron se Zonat e Influencës (AoI) do të ndryshojnë në varësi të llojit të efektit, por në secilin rast është përcaktuar që të përfshijnë të gjithë zonën e Projektit ku ka gjasa që mund të rezultojnë ndikime të rëndësishme.

6.4.3 Vlerësimi i Ndikimeve dhe Metodologjia

Faza e vlerësimit të ndikimit, e cila bazohet në rezultatet e studimit të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale për TEC Korçë, vlerëson rëndësinë e ndikimeve të mundshme të identifikuara, përfshirë efektet kumulative dhe identifikon masat zbutëse që mund të minimizojnë/zvogëlojnë ose kompensojnë ndikimet negative dhe/apo të rrisë përfitimet. Gjetjet biofizike dhe socio-ekonomike do të përfshihen në raportin e VNMS, i cili do të jetë dokumenti kryesor në të cilin bazohen vendimet mjedisore në lidhje me projektin. Hapat e përfshirë në fazën e vlerësimit të ndikimit përshkruhen më në detaje në paragrafin më poshtë.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis që do të përdoret për projektin e propozuar përfshin një qasje që kombinon *Magnitudën e Ndikimit* dhe *Ndjeshmërinë e Receptorit* për të përcaktuar *Rëndësinë e Ndikimit*. Metodologjia që do të përdoret për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme të Projektit të Propozuar paraqitet në figurën më poshtë.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 6.2 Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis



Burimi: ERM 2003

Hapi i parë i metodologjisë së vlerësimit mjedisor është parashikimi i ndikimeve të mundshme që lidhen me aktivitetet e projektit. Ky hap përfshin një parashikim të asaj që ka të ngjarë të ndodhë me burimet mjedisore dhe receptorët socialë si pasojë e ndërtimit dhe funksionimit të termocentralit të gazit.

Hapi i dytë konsiston në vlerësimin e ndikimeve të parashikuara. Ndikimet mjedisore dhe sociale mund të jenë të natyrave të ndryshme, llojit dhe shkallës së ndryshme. Në varësi të kushteve ekzistuese të mjedisit dhe bashkëveprimit me aktivitetet e projektit, efektet e ndikimit mund të jenë të drejtpërdrejta, të tërthorta, të nxitura apo kumulative. Për këtë VNMS teknikat sasiore dhe cilësore për të klasifikuar ndikimet janë paraqitur në Tabelën 6.1.

Tabela 6.1 Karakteristikat e Ndikimeve

Karakteristika	Përcaktimi
Natyra	<ul style="list-style-type: none"> • Pozitive; • Negative.
Lloji	<ul style="list-style-type: none"> • Direkte; • Indirekte; • E nxitur; • Kumulative.
Shtrirja	<ul style="list-style-type: none"> • Lokale; • Rajonale; • Ndërkombëtare; • Ndërkufitare.
Kohëzgjatja	<ul style="list-style-type: none"> • E përkohshme; • Afat-shkurtër; • Afat-gjatë; • E përhershme.
Shkalla	Nuk ka përcaktime fikse për këtë karakteristikë.
Frekuenca	Nuk ka përcaktime fikse për këtë karakteristikë.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Pasi karakteristikat e ndikimit të jenë të qarta dhe të kuptueshme, do të përdoren karakteristikat e treguara më sipër për t'i përcaktuar çdo ndikimi një magnitudë. Magnituda është një kombinim dhe funksion i karakteristikave të mëposhtme të ndikimit:

- Shtrirja;
- Kohëzgjatja;
- Shkalla;
- Frekuenca; dhe,
- Mundësia/Gjasat.

Në thelb, magnituda përshkruan shkallën e ndryshimit që impakti ka të ngjarë të sjellë mbi burimin/receptorin. Si në rastin e shtrirjes së ndikimeve dhe kohëzgjatjes, vetë emërtimet e magnitudës përdoren në mënyrë universale dhe për të gjithë burimet/ receptorët, por përkufizimet për këto përcaktime do të ndryshojnë në bazë të burimeve/receptorëve, siç diskutohet më poshtë. Përcaktimet universale të magnitudës janë:

- Ndikim Pozitiv;
- Ndikim i Neglizhueshëm;
- Ndikim i Vogël;
- Ndikim Mesatar;
- Ndikim i Madh.

Përveç karakterizimit të magnitudës (madhësisë) së ndikimit, hapi tjetër kryesor që nevojitet për të caktuar rëndësinë për një ndikim të caktuar është përcaktimi i ndjeshmërisë ose rëndësisë së burimit/receptorit të ndikuar. Ashtu si në rastin e magnitudës, vetë ndjeshmëria/renditja e rëndësisë është përgjithësisht universale, por përkufizimet për këto përcaktime do të ndryshojnë në bazë të burimeve/ receptorëve. Përcaktimet universale të ndjeshmërisë/vulnerabilitetit/rëndësisë janë:

- E Ulët;
- Mesatare; dhe,
- E Lartë.

Në momentin kur është karakterizuar magnituda (madhësia) e ndikimit dhe ndjeshmëria e burimit apo receptorit, mund të caktohet rëndësia për çdo ndikim. Për vlerësimin e kësaj VNMS do të zbatohen kategoritë në vijim për vlerësimin e rëndësisë së ndikimit:

- Ndikim Pozitiv;
- Rëndësi e Neglizhueshme;
- Rëndësi e Vogël;
- Rëndësi Mesatare; dhe
- Rëndësi e Madhe.

Hapi i tretë i metodologjisë së vlerësimit është përcaktimi i masave përkatëse zbutëse. Kjo konsiderohet si një komponent kyç i procesit të VNMS, i cili shqyrton mënyrat praktike për të shmangur ose zvogëluar ndikimet potencialisht të rëndësishme të projektit të propozuar.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Përveç kësaj, këto masa zbutëse të identifikuar përfshihen më pas në Projektin e propozuar si angazhime. Qëllimi i zbutjes së ndikimeve është parandalimi, zvogëlimi ose menaxhimi i impakteve të rëndësishme negative deri në një nivel sa më të ulët të mundshëm (ALARP)³ dhe optimizimi dhe maksimizimi i përfitimeve potenciale të Projektit, aty ku është e mundur. Për këtë VNMS, zbutja e ndikimeve do të synojë të sigurojë që aty ku është e mundur ndikimet potenciale të zbuten në burim dhe jo të lehtësohen nëpërmjet masave rehabilituese pasi të ketë ndodhur ndikimi.

Hapi i katërt i metodologjisë së vlerësimit është rivlerësimi i ndikimeve të mbetura pas zbatimit të masave zbutëse. Këto ndikime zakonisht njihen si ndikime të mbetura. Meqenëse masat zbutëse do të zbatohen për të zvogëluar ndikimet në 'sa më të ulëta të jetë e mundur' ALARP, ato nuk mund të eliminohen tërësisht. Është e rëndësishme të kuptohet rëndësia e këtyre ndikimeve të mbetura për të përcaktuar disa forma të monitorimit ose matjeve për të kontrolluar këto ndikime.

6.4.4 *Ballafaqimi me Pasiguritë në Procesin e Vlerësimit të Ndikimeve*

VNMS është një proces që merret me parashikimin e ndikimeve në të ardhmen dhe ka pasiguri të pashmangshme të cilat mund të lindin midis parashikimeve të kryera dhe asaj që do të ndodhë gjatë zhvillimit të projektit. Parashikimet e ndikimeve do të kryhen duke përdorur të dhënat e disponueshme, sa herë që të jetë e mundur, por në rastet kur mund të ketë paqartësi për çështje të rëndësishme, ato do të përfshihen në Raportin e VNMS. Aty ku ndjeshmëria e një burimi për një aktivitet të caktuar është e panjohur dhe magnituda e ndikimeve nuk mund të parashikohet. Ekipi specialistëve të VNMS-së do të përdorë një gjykim konservator, të bazuar në përvojën profesionale për të gjykuar nëse ka ndikime të rëndësishme ose jo, të cilat do të raportohen në përputhje me rrethanat apo kushtet e tjera mjedisore/sociale të zonës.

³ Koncepti “Sa më të ulëta të jetë e mundur (ALARP)” nënkupton pikën në të cilën kostoja dhe përpjekja (koha dhe vështirësia) e reduktimit të mëtejshëm të rrezikut është jashtëzakonisht joproporcionale ndaj reduktimit të rrezikut të arritur.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisin dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

7 IDENTIFIKIMI PARAPRAK I NDIKIMEVE TË MUNDSHME

7.1 HYRJE

Një pjesë kryesore e fazës së studimit është analiza paraprake e mënyrave në të cilat Projekti mund të ndërveprojë (pozitivisht dhe negativisht) me mjedisin (përfshirë receptorët fizik dhe biologjik) dhe burimet/aspektet sociale.

Ndikimet që identifikohen si potencialisht të rëndësishme gjatë procesit të studimit të VNMS ofrojnë fokus për studimet e mëtejshme që do të ndërmerren gjatë procesit të VNMS. Secili prej ndikimeve të mundshme do të diskutohet dhe vlerësohet në detaje në raportin përfundimtar të VNMS.

Ky Kapitull ofron një identifikim paraprak dhe vlerësim të ndikimeve mjedisore dhe sociale të Projektit. Ai përcakton ndikimet për fazat e ndryshme të projektit si më poshtë:

- aktivitetet e fazës së ndërtimit;
- aktivitetet e fazës së funksionimit; dhe
- aktivitetet në fazën e nxjerrjes jashtë përdorimit (dekomisionimit).

7.2 PROCESI I STUDIMIT TË VNMS

Procesi i studimit të VNMS identifikon ndikimet e mundshme përmes një procesi sistematik ku aktivitetet e lidhura me fazat e ndryshme të Projektit merren në konsideratë në lidhje me potencialin e tyre për të bashkëvepruar me burimet dhe receptorët/pritësit e identifikuar.

Ndërveprimet në këtë rast klasifikohen në një prej katër kategorive si më poshtë:

- **Nuk ka ndërveprim [-]**, aty ku Projekti nuk ka të ngjarë të ndërveprojë me burimin / receptorin;
- **Ndërveprim i mundshëm [I]**, por nuk ka të ngjarë të jetë i rëndësishëm: ka mundësi që të ketë një ndërveprim, por efekti rezultues nuk ka gjasa të ndryshojë kushtet ekzistuese të mjedisit në mënyrë të dukshme;
- **Ndërveprim i rëndësishëm [S]**, ku mund të ketë një ndërveprim dhe ndikimi që rezulton ka një potencial të arsyeshëm për të shkaktuar një efekt të rëndësishëm në burim ose receptor; dhe,
- **Ndërveprim pozitiv [P]**, ku ka të ngjarë të jetë një ndërveprim pozitiv dhe ndikimi që rezulton ka një efekt pozitiv në burim ose receptor.

Mbi këtë bazë, janë identifikuar aktivitete dhe procese të ndryshme të projektit të cilat mund të veprojnë apo ndikojnë në burim / receptorë mjedisor-socialë. Këto aktivitete janë të paraqitura në boshtin vertikal të Matricën e Fazës së Studimit (referojuni Tabelës 7.1 më poshtë). Burimet dhe receptorët që lidhen me elementët e mjedisit ekzistues janë renditur në boshtin horizontal të matricës. Çdo qelizë që rezulton në matricën e fazës së studimit, përfaqëson një ndërveprim të mundshëm midis një aktiviteti të projektit dhe një burimi ose

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

receptori. Këto ndërveprime të mundshme do të konsiderohen më tej dhe do të nënshtrohen një vlerësimi të hollësishëm gjatë procesit të VNMS në vazhdim për të përcaktuar rëndësinë e ndikimeve.

Aktivitetet e marra në konsideratë për secilën nga fazat e Projektit paraqiten si më poshtë:

Faza e Ndërtimit

- Rrethimi dhe pastrimi i bimësisë;
- Përgatitja e zonave të punës dhe procesi i gërmimit;
- Vendosja e pilave për ndërtimin e themeleve;
- Ndërtimi i rrugëve të aksesit;
- Ndërtimi i termocentralit;
- Ndërtimi i tubacionit të gazit dhe vendosja e pajiseve ndihmëse;
- Ndërtimi i linjës elektrike të transmetimit për lidhjen me NS Zëmbllak;
- Operimi i makinerive të ndërtimit, pajisjeve dhe gjeratorëve;
- Gjenerimi i mbetjeve, mbledhja, transporti dhe depozitimi;
- Gjenerimi i ujërave të ndotur, mbledhja, transporti dhe depozitimi / asgjësimi;
- Transporti i materialeve, njerëzve dhe pajisjeve në kantier;
- Shpimi i puseve dhe devijimi i rrjedhave ujore sipërfaqësore;
- Përdorimi i materialeve të rrezikshme;
- Mobilizimi i fuqisë punëtore për ndërtim;
- Ndriçimi;
- Vendosja e kabinave të qëndrimit në kantier;
- Punësimi dhe prokurimi i të mirave dhe shërbimeve;

Faza e Funkcionimit

- Operimi dhe mirëmbajtja e termocentralit;
- Operimi i makinerive mbështetëse, pajisjeve dhe gjeneratorëve;
- Mirëmbajtja periodike (p.sh. mirëmbajtjet e mëdha çdo 6 vjet);
- Gjenerimi i mbetjeve, mbledhja, transporti dhe depozitimi;
- Gjenerimi i ujërave të ndotur, mbledhja, transporti dhe depozitimi / asgjësimi;
- Transporti i materialeve, njerëzve dhe pajisjeve në zonën e punës;
- Nxjerrja e ujit nëntokësor nga puset (në rastet e emergjencës);
- Përdorimi i materialeve të rrezikshme;
- Mobilizimi i fuqisë punëtore për ndërtim;
- Ndriçimi;
- Punësimi dhe prokurimi i të mirave dhe shërbimeve;

Faza e Dekomisionimit

- Lëvizjet e automjeteve dhe trafiku;
- Shëmbja e objekteve dhe heqja e strukturave;

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Gjenerimi i mbetjeve, mbledhja, transporti dhe depozitimi;
- Gjenerimi i ujërave të ndotur, mbledhja, transporti dhe depozitimi / asgjësimi;

Aksidentet dhe Ngjarjet e Paplanifikuara

- Shkarkimet aksidentale të pajisjeve të lëndëve djegëse dhe vajrave;
- Shkarkime aksidentale të gazit nga tubacioni apo pajisjet e tij;
- Aksidentet automobilistike;
- Shpërthimet apo rënia e zjarrit në termocentral apo në tubacionin e gazit;
- Depozitimi jo i duhur i mbetjeve.

Matriksi përfundimtar i fazës së studimit paraqitet në Tabelën 7.1.

		 LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 7.1 Matriksi i Fazës së Studimit

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike										
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	
<i>Faza e Ndërtimit</i>																						
Rrethimi dhe pastrimi i bimësisë	-	-	-	-	-	I	S	I	I	-	-	-	I	-	-	S	-	-	S	-	-	
Përgatitja e zonave të punës dhe procesi i gërmimit	S	S	S	I	I	S	S	I	S	-	-	I	I	-	-	S	P	-	S	-	-	
Vendosja e pilave për ndërtimin e themeleve	S	S	S	I	S	S	-	I	S	-	-	I	S	-	-	-	-	-	S	-	-	
Ndërtimi i rrugëve të aksesit	S	S	S	I	I	S	I	I	S	I	-	S	S	-	-	-	P	P	S	-	-	

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike									
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>
Ndërtimi i termocentralit	S	S	S	I	I	S	S	S	S	I	-	-	S	-	-	S	-	-	S	-	-
Ndërtimi i tubacionit të gazit dhe vendosja e pajisjeve ndihmëse	S	S	S	I	I	S	S	S	S	S	-	I	S	-	-	S	-	-	I	-	-
Ndërtimi i linjës elektrike të transmetimit për lidhjen me NS Zëmbllak	S	S	S	I	I	I	I	I	S	-	-	I	S	-	-	I	P	P	I	-	-
Operimi i makinerive të ndërtimit, pajisjeve dhe gjeratorëve	S	S	S	-	-	I	I	S	S	-	-	I	S	-	-	-	-	-	-	-	-

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike									
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>
Gjenerimi i mbetjeve, mbledhja, transporti dhe depozitimi	I	I	I	-	-	I	-	-	-	-	-	-	S	-	-	-	-	-	S	-	-
Gjenerimi i ujërave të ndotur, mbledhja, transporti dhe depozitimi / asgjësimi	I	-	-	S	I	I	I	I	S	-	S	S	-	-	-	-	-	-	I	-	-
Transporti i materialeve, njerëzve dhe pajisjeve në kantier	I	S	-	-	-	S	-	I	S	-	-	S	S	-	-	S	-	-	S	-	-
Shpimi i puseve dhe devijimi i rrjedhave ujore sipërfaqësore	-	-	I	I	I	-	S	S	S	S	-	I	I	I	I	-	-	S	S	-	-

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike										
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	
Përdorimi i materialeve të rrezikshme	I	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	I	S	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mobilizimi i fuqisë punëtore për ndërtim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	S	I	I	-	P	I	-	-	-	-
Ndriçimi	-	-	-	-	-	S	-	I	S	-	-	-	-	-	I	-	-	-	-	I	-	-
Vendosja e kabinave të qëndrimit në kantier	-	I	-	-	-	I	-	I	I	-	-	-	-	-	-	-	P	S	-	-	-	-
Punësimi dhe prokurimi i të	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	P	P	P	P	-	-	-	-	-

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike										
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	
mirave dhe shërbimeve																						
<i>Faza e Funkionimit</i>																						
Operimi dhe mirëmbajtja e termocentralit	S	S	-	-	-	I	I	I	I	-	-	I	S	-	-	-	P	P	-	-	-	-
Operimi i makinerive mbështetëse, pajisjeve dhe gjeneratorëve	S	S	-	-	-	S	-	I	I	-	-	I	S	I	-	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja periodike (p.sh,	S	S	-	-	-	-	-	-	-	-	-	I	S	I	-	-	P	-	I	-	-	-

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike										
	<i>Cilësia e Ajrit</i>	<i>Zhurmat</i>	<i>Toka dhe Gjeologjia</i>	<i>Ujërat Sipërfaqësorë</i>	<i>Ujërat Nëntokësorë</i>	<i>Peizazhi dhe Aspekti Vizual</i>	<i>Flora</i>	<i>Fauna</i>	<i>Avifauna (zogjtë)</i>	<i>Ekologjia e Ujërave Sipërfaqësorë</i>	<i>Zonat e Mbrojtura</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit</i>	<i>Siguria dhe Shëndeti i Punonjësve</i>	<i>Demografia e Komunitetit Lokal</i>	<i>Struktura Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Përdorimi i Tokës dhe Jetesa</i>	<i>Ekonomia Lokale dhe Makro</i>	<i>Infrastruktura dhe Shërbimet</i>	<i>Trafiku dhe Transporti</i>	<i>Turizmi / Argëtimi</i>	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	
mirëmbajtjet e mëdha çdo 6 vjet)																						
Gjenerimi i mbetjeve të ngurta, mbledhja, transporti dhe depozitimi	I	I	-	-	-	-	-	-	-	-	-		I	-	-	-	P	-	-	-	-	-
Gjenerimi i ujërave të ndotur, mbledhja, transporti dhe depozitimi / asgjësimi	I	I	-	I	-	-	I	I	I	S	-	I	I	-	-	I	-	-	-	-	-	-
Transporti i materialeve, njerëzve dhe pajisjeve në zonën e punës	I	S	-	-	-	I	-	I	S	-	-	I	S	-	-	-	-	-	I	-	-	-

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aktivitetet e Projektit	Aspektet Fizike						Aspektet Biologjike					Aspektet Socio-Ekonomike										
9	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social, përfshirë dekomisionimin	The ESMP ëill draë together the possible mitigation measures; group them logically into components ëith common themes; define the specific actions required and timetable for implementation; identify training needs, institutional roles and responsibilities for implementation; and estimate the costs of the measures. PMMS-ja do të mbledhë së bashku masat e mundshme zbutëse; do i grupojë ato logjikisht në komponentë me tema të përbashkët; do përcaktojë veprimet specifike të nevojshme dhe afatet kohore për zbatim; do identifikojnë nevojat për trajnim, rolet dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin; dhe do vlerësojë kostot e masave.
10	Konsultimi me	Ky kapitull do të paraqesë rezultatet e

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Numri i Kapitullit	Përmbajtja	Shënime Shpjeguese
	Publikun, Plani i Komunikimit dhe të Dhënat	konsultimeve të ndërmarra si pjesë e VNMS, plus planin dhe dokumentet e komunikimit, si dhe planet për konsultime të mundshme në të ardhmen. Ai do të identifikojë palët kryesore të interesuara të projektit dhe do të paraqesë reagimet e tyre mbi Projektin GPP Korçë.
Konkluzione		Ky kapitull do të përmbledhë përfundimet që janë kryer në bazë të vlerësimit, si dhe do të nënvizojë çdo rekomandim për fazat e mëtejshme.
Referencat		Në raport do të paraqiten të gjithë referencat dhe dokumentet të cilat janë përdorur për kryerjen e studimit dhe vlerësimit.
Shtojcat		Këto do të përfshijnë shtojcat teknike me detaje të vëzhgimeve specifike teknike, bibliografinë dhe listën e akronimeve.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

9 REFERENCAT

TAP Project, AAL00-ERM-641-Y-TAE-1008_REV03 - ESIA Albania SECTION 6_Environmental, Socioeconomic and Cultural Heritage Baseline;

TAP Project, AAL00-ERM-641-Y-TAE-1008_ REV02 - ESIA Albania ANNEX 6.1_Onshore Physical Environment;

TAP Project, AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010_REV03-ESIA Albania SECTION 8_Assessment of Impacts and Mitigation Measures;

TAP Project, TAP Scoping Report for the ESIA in Albania;

International Finance Corporation (IFC) Operational Policies: OP 4.01 - Environmental Assessment;

Social-Economic, Environmental and Strategic Assessment Report - GPP KORÇA sh.p.k;

Strategic Environmental Assessment for the General Local Plan of Korça's Municipality;

CCCPP Korça Presentation (IVICOM Consulting & GPP Korça);

Municipality of Korça, ëebite <http://ëëë.bashkiakorçe.gov.al/>;

Design Manual for Roads and Bridges: Volume 11, Section 2, Part 5, Assessment and Management of Environmental Effects

<http://ëëë.standardsforhighëays.co.uk/ha/standards/dmrb/vol11/section2/ha20508.pdf>

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) - Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

10 SHTOJCAT

10.1 Shtojca A

Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara.

10.2 Shtojca B

Dokumenti Përmbledhës i Informacionit.



LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

PËRMBLEDHJA E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	TERMOCENTRALI ME GAZ NË KORÇË (GPP KORÇA)
TITULLI I DOKUMENTIT	RAPORTI I ANGAZHIMIT ME PALËT E INTERESUARA PËR FAZËN E STUDIMIT TË VNMS - GPP KORÇA (Shtojca A)

RISH.	QËLLIMI I PUBLIKIMIT	PËRSHKRIMI	EMRI	DATA
1	Draft Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara		Abkons	01/06/2018
2	Draft Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara		Abkons	22/06/2018

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR PËR PUBLIKIM

	KONSULENTI			KONTRAKTORI	
	Punoi	Kontrolloi	Miratoi	Kontrolloi	Miratoi
Emri/ Mbiemri	Abkons	Abkons	Abkons		
Firma					
Data					
Statusi i Dokumentit					

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

Përmbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTIMET	4
1 HYRJE.....	5
2 STUDIMI PARAPRAK	7
3 MJETET E KOMUNIKIMIT DHE MATERIALET	9
4 ANGAZHIMI ME PALËT E INTERESUARA (API).....	14
4.1 TAKIMET ME PALËT E INTERESUARA	14
4.1.1 Nivel Kombëtar.....	14
4.1.2 Nivel Rajonal dhe Lokal	22
4.2 TAKIMET ME KOMUNITETIN LOKAL.....	30
4.2.1 Angazhimi me OJQ-të	43
4.2.2 Konsultimet me Shoqërinë e Hapur në Dëgjesën Publike	43
4.3 PËRFUNDIME DHE OPINIONE MBI PROJEKTIN	50
5 MEKANIZMI I ANKESAVE.....	51

Tabelat

Tabela 3.1 Programi i Takimeve – Nivel Kombëtar	9
Tabela 3.2 Programi i Takimeve – Nivel Lokal dhe Rajonal	11
Tabela 4.1 Aktivitet e zhvilluara dhe aktivitetet e planifikuara	14
Tabela 4.2 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me autoritetet në Nivel Kombëtar	18
Tabela 4.3 Pyetësi i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Nivel Kombëtar	22
Tabela 4.4 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me autoritetet në Nivel Rajonal dhe Lokal	26
Tabela 4.5 Pyetësi i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Nivel Rajonal dhe Lokal	29
Tabela 4.6 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me Komunitetin.....	35
Tabela 4.7 Pyetësi i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Komuniteti.....	42
Tabela 4.8 Organizata OJQ/ Shoqëria Civile të identifikuar.....	43
Tabela 4.9 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga takimi i Konsultimit me Publikun.....	44

Figurat

Figura 1.1 Metodologjia për Angazhimin me Palët e Interesuara.....	6
Figura 2.1 Harta për identifikimin e zonave të ndikuara dhe palëve të interesuara	7
Figura 2.2 Harta e Projektit.....	8

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

Figura 3.1 Pamje ilustruese të Letrave Zyrtare të dërguara	12
Figura 4.1 Prezantimi i qëllimit të PAPI-it, ndikimet dhe aktivitetet.....	15
Figura 4.2 Fotografi gjatë takimeve me institucionet në Nivel Kombëtar	16
Figura 4.3 Fotografi nga takimet e zhvilluara	24
Figura 4.4 Paraqitje ilustruese e Dokumentit Përmbledhës të Informacionit.....	48
Figura 4.5 Pamje ilustruese gjatë takimit për Konsultimin me Publikun	48
Figura 5.1 Paraqitja skematike e procedurës për Mekanizmin e Ankesave.....	51

Grafikët

Grafiku 4.1 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes – Nivel Kombëtar	21
Grafiku 4.2 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes – Nivel Rajonal dhe Lokal	29
Grafiku 4.3 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes - Komuniteti	41

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

AKRONIMET DHE SHKURTIMET

GPP	Termocentral me Gaz
TEC	Termocentral
CCCPP	Termocentral me Cikël të Kombinuar Kogjenerimi
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Social
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
ASE	Anketimi Socio-Ekonomik
PVAPI	Plani i Veprimit për Angazhimin me Palët e Interesuara
MA	Mekanizmi i Ankesave
PAPI	Plani i Angazhimit me Palët e Interesuara
SE	Angazhimi me Palët e Interesuara
MT	Minutat e Takimit
DPI	Dokumenti Përmbledhës i Informacionit
IFC	Korporata Ndërkombëtare e Financimit
BAT	Teknikat më të Mira të Disponueshme
BEP	Praktikat më të Mira Mjedisore

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

1 HYRJE

Angazhimi me Palët e Interesit është konsideruar nga Kooperata Ndërkombëtare e Financave (IFC) si domosdoshmëri dhe është një proces i rëndësishëm i cili synon të ndërtojë dhe të mbajë një marrëdhënie të hapur dhe konstruktive me palët e interesuara dhe në këtë mënyrë të lehtësojë dhe përmirësojë menaxhimin e veprimtarisë dhe aktivitetëve gjatë gjithë fazave të implementimit të projektit, duke përfshirë efektet dhe rreziqet në fushën mjedisore dhe sociale.

Sot, termi “*angazhim më palët e interesit*” po shfaqet si një mjet për të përshkruar një proces më të gjerë, më gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm midis një kompanie dhe atyre që mund të ndikohen potencialisht, proces që përfshin një sërë aktivitetesh dhe qasje përgjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit.




Abkons sh.p.k (konsulenti) është duke ndërmarrë Fazën e Studimit (Scoping Phase) për përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale (VNMS). Në këtë kuadër Abkons ka përpiluar Planin e Angazhimit me Palët e Interesit (PAPI), plan i cili do të zbatohet në përputhje me Standardet e kërkuara sipas IFC (PS1). Ky dokument përshkruan metodologjinë dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe planet e komunikimit, në lidhje me përfshirjen e tyre në këtë proces.

Objektivi i këtij Plani (PAPI) është që të përmirësojë dhe të lehtësojë vendim-marrjen që lidhet me projektin dhe t’i ofrojë mundësi për përfshirje aktive dhe në kohë, të të gjithë palëve të interesit, dhe t’i ofrojë mundësi këtyre të fundit të shprehin opinionet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë vendimet për zbatimin e Projektit.

Ky është një dokument në zhvillim dhe do të përditësohet sipas nevojës. Ky botim i PAPI-t përqendrohet kryesisht në angazhimin e planifikuar gjatë fazës përgatitore të procesit të VNMS-së. Aktivitetet e propozuara në këtë plan janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, gjithashtu të bazuara në praktikatat më të mira ndërkombëtare të kërkuara nga IFC.


IFC PS1 – Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut dhe Ndikimit Social dhe Mjedisor: natyra, frekuenca dhe niveli i përpjekjeve për angazhimin e palëve të interesuara mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe do të jenë në përpjestim me rreziqet dhe ndikimet negative të projektit dhe fazave të tij të zbatimit.



Ky raport do të japë një përmbledhje të të gjithë aktivitetëve të kryera në këtë fazë të parë studimore (Faza e Studimit për VNMS) ku janë përfshirë palë të niveleve të ndryshme duke nisur nga ato në nivel qeveritar, institucional, rajonal dhe lokal.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

Metodologjia e përdorur për të hartuar këtë angazhim me palët e interesit është paraqitur në një diagramë si më poshtë:

Figura 1.1 Metodologjia për Angazhimin me Palët e Interesuara



				 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)				

2 STUDIMI PARAPRAK

Abkons ka ndërmarrë fazën e studimit për projektin në mënyrë që të përcaktojë çështjet kryesore të projektit, qëllimin e plotë të studimit të VNMS-së dhe të identifikojë palët e interesuara në proces.


Shqyrtimi në Zyrë

Me qëllim përcaktimin e studimeve të mëtejshme të kushteve ekzistuese socio-ekonomike dhe mjedisore, ishte e rëndësishme identifikimi i palëve të interesuara në procesin e VNMS-së.

GIS, Vendosja në Hartë dhe Treguesit


Zona e ndikuar dhe fshatrat janë të integruara në një aplikacion interaktiv duke përdorur GIS. Abkons ka zhvilluar harta për interpretim të dobishëm të të dhënave të grumbulluara për analizimin dhe paraqitjen e informacioneve relevante mbi hartat dhe grafikët e zonës së studimit. Kjo hartë është përdorur më pas në terren gjatë aktiviteteve të angazhimit me palët e interesuara.

Figura 2.1 Harta për identifikimin e zonave të ndikuara dhe palëve të interesuara



Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Figura 2.2 Harta e Projektit



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

3 MJETET E KOMUNIKIMIT DHE MATERIALET

Abkons ka identifikuar grupet e mëposhtme të palëve të interesuara:

- Autoritete të Nivelit Kombëtar, të cilat përfshijnë institucionet qeveritare dhe ministrinë;
- Autoritete të Nivelit Lokal, të cilat do të përfshihen në proces për mbështetjen e tyre gjatë fazës së studimit në terren, duke përfshirë OJQ-të dhe organizatat e tjera lokale që kanë njohuri të konsiderueshme për zhvillimet në komunitet;
- Fokus grupet;
- Komuniteti.

Duke qenë një proces gjithëpërfshirës dhe kulturor, konsultimi me palët e interesit konsistoi në shkëmbimin e informacionit dhe njohurive, për të kuptuar shqetësimet e këtyre palëve dhe për të ndërtuar marrëdhënie në bazë të bashkëpunimit për projektin. Kjo u lejoi palëve të interesuara të kuptojnë rreziqet, ndikimet dhe mundësitë/përfitimet e projektit për të arritur rezultate pozitive.

Objektivat kryesorë të përfshirjes së palëve të interesuara janë:

- Të sigurohej ofrimi i informacionit të duhur në kohën e duhur për palët e ndikuara apo ato që kanë interes për projektin;
- Të sigurohej që këtyre grupeve t'u jepet një mundësi për të shprehur mendimet dhe shqetësimet e tyre;
- Të sigurohej që komentet të kryhen në kohë në mënyrë që të mund të merren parasysh këto kërkesa në vendimet e projektit.


Pasi hartimit të programit për palët e interesuara në të gjitha nivelet, skuadra e punës për VNMS përgatiti dhe organizoi konsultimet me grupet e interesit si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3.1 Programi i Takimeve - Nivel Kombëtar

Autoriteti	Departamenti	Data	Ora
<i>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</i>	Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm e Mjedisit	14 Maj 2018	14:00
	Drejtoria e Rregullimit, Lejeve dhe Licencave dhe Monitorimit	14 Maj 2018	14:00
	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit	14 Maj 2018	14:00
	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit	14 Maj 2018	14:00
<i>Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)</i>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	14 Maj 2018	10:00
	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura - MTM	14 Maj 2018	14:00

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Autoriteti	Departamenti	Data	Ora
	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit - MTM	14 Maj 2018	14:00
	Inpektoriati Kombëtar i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujit - MTM	14 Maj 2018	14:00
	(AIDA) - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	14 Maj 2018	12:00
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural	15 Maj 2018	14:00
	Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore	15 Maj 2018	14:00
	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave	15 Maj 2018	14:00
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë	15 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë	15 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Programit për Zhvillim të Industrisë dhe Energjisë	15 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit	15 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Programit për Zhvillim të Infrastrukturës dhe Territorit	15 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit	15 Maj 2018	10:00
Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)	Agjencia e Përgjithshme e Kanalizimeve dhe Furnizimit me Ujë	15 Maj 2018	10:00
	Inspektoriati Kombëtar Teknik dhe Industrial - MIE	15 Maj 2018	10:00
	OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit	15 Maj 2018	10:00
Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)	Sekretariati Teknik i Ujit	16 Maj 2018	13:00
Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)	OSSHE - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	16 Maj 2018	10:00
Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)	ERRE - Enti Rregullator i Energjisë	16 Maj 2018	15:00
Ministria e Kulturës	Drejtoria e Strategjive	17 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore	17 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor	17 Maj 2018	10:00
	Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën	17 Maj 2018	10:00

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

Autoriteti	Departamenti	Data	Ora
<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	Drejtoria e Shërbimeve të Shëndetit Publik	31 Maj 2018	15:00
<i>Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)</i>	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - MIE	17 Maj 2018	13:00
<i>Agjencitë Kombëtare (sipas institucioneve të varësisë nga ministrinë)</i>	ASHA - Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (Ministria e Kulturës)	17 Maj 2018	10:00

Tabela 3.2 Programi i Takimeve - Nivel Lokal dhe Rajonal

Autoriteti	Data	Ora
Drejtoria Rajonale e Mjedisit - Korçë	17 Maj 2018	12:00
Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Korçë	17 Maj 2018	12:00
Inspektoriati Rajonal i Mjedisit dhe Pyjeve	17 Maj 2018	12:00
Drejtoria Rajonale e Bujqësisë	17 Maj 2018	13:30
Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit - Korçë	18 Maj 2018	10:00
Drejtoria Rajonale e Rrugëve dhe Transportit	18 Maj 2018	9:00
Agjencia Rajonale e Zhvillimit - OJQ	18 Maj 2018	12:00 - 13:00
Agjencia Rajonale e Shëndetit Publik	18 Maj 2018	11:00
Bashkia e Korçës	18 Maj 2018	14:00
Prefektura e Qarkut Korçë	21 Maj 2018	10:00
AZHR - Agjencia e Zhvillimit Rajonal	21 Maj 2018	9:00
Këshilli Rajonal i Korçës	21 Maj 2018	12:00

Për të gjitha takimet e planifikuara, vendi i takimeve u përzgjedh në bashkëpunim me pjesëmarrësit kryesorë dhe lista përfundimtare e ftesave u finalizua me përfaqësuesit përkatës rajonalë dhe lokalë. Njoftimet janë bërë me anë të paketës së ftesës dhe informatave për pjesëmarrësit rreth takimit.

A. Qasja


Mjetet e komunikimit që janë përdorur për informimin dhe takimet me palët e interesuara përfshijnë:

- **Letër drejtuar autoriteteve**

Secili prej autoriteteve të identifikuar (në nivel kombëtar dhe rajonal) u ftua të merrte pjesë në një takim nëpërmjet njoftimit më letër zyrtare. Letrat zyrtare u dërguan tek autoritetet në një periudhë prej 10-15 ditësh përpara datave dhe orarit të planifikuar.

  	
<p style="text-align: right;">LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</p>	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtojca A)

Figura 3.1 Pamje ilustruese të Letrave Zyrtare të dërguara



- **Poster**

Posteri, i cili është miratuar nga GPP Korça, paraqet njoftimin në lidhje me zbatimin e projektit dhe gjithashtu fton komunitetin për të marrë pjesë në një takim të hapur me komunitetin. Posterat u vendosën në secilën prej fshatrave të identifikuara (dhe në qytetin e Korçës) dhe të marra në konsideratë për qëllimin e punës. Gjithashtu u shpërndanë

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtojca A)

fletushka në komunitet në mënyrë që të arrihej ndërgjegjësimi i publikut, informimi për fazat e projektit dhe gjithashtu për qëllimin e studimit të VNMS.

Përse Korça si lokacion?

- Ngritje qendrore për qytetin e Korçës
- Ngritja e serave do realizohet me anë të një lugeje me ngjyrim qendrore
- Impant trajtimi i ujrave të nditura si burim uji për impiant
- Alternivë me burimin e gazit (gazajellëna TAP)
- Mundësia e marrjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike (Zëmbëk)

Përse një termocentral?

- Mungesa e impiantëve për prodhimin e energjisë në Shqipëri
- Në Shqipëri, energjia varet nga importi saj
- Mungesa e kapacitetit gjenerues për të plotësuar nevojat në një
- Mungesa e shumëllojshmërisë së resursov energjetike
- Emetimi të ulët krahasuar me lëndët tjera djegëse

41

Konsultimi dhe angazhimi me palët e interesuara është një proces integrues e procesit të VNMS-it në fazën e studimit, si pjesë e procesit të VNMS-it, është diskutimi dhe konsultimi me palët e prekura dhe palët e interesuara, për të realizuar një proces të përfshirë dhe të përbashkët, duke përfshirë shprehjen e informacionit dhe rrethimit, për të ndërtuar në tërësi aftësitë, mundësitë të bazuara në rrethim dhe besimin reciprok. Ajo do të vëzhgohet në fazat e mëtejshme dhe përfshirë gjithë kohëzgjatjen e projektit në tërësi.

42

Në këtë kontekst GPP Korça dhe Abkons Sh.p.k, do të kryejnë të tjerë të gjitha palët e interesuara relevante gjatë përfaqësimit të VNMS-it në mënyrë që:

- Ti gjitha palët e interesuara të jenë të informuara për Projektin dhe progresin e tij
- Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social të mos të gjithë informacionet e disponueshme dhe të nevojshme, mbi procesin për të vlerësuar të gjitha aspektet (pozitive dhe pozitive) që mund të ketë projekti në mjedis dhe në komunitet
- Palët e interesuara të sigurojnë një feedback përpara fillimit të procesit të VNMS-it
- Ti gjitha çështjet relevante të jenë të identifikueshme
- Përfaqësuesit e Abkons dhe GPP Korça Sh.p.k, do të jenë të pranishëm në takime

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

4 ANGAZHIMI ME PALËT E INTERESUARA (API)

Angazhimi me Palët e Interesuara është një aktivitet i vazhdueshëm në përputhje me angazhimet e mëparshme, i cili siguron shënime të detajuara të konsultimit dhe aktiviteteteve në kuadër të Vlerësimit Socio-Ekonomik. Tabela më poshtë tregon aktivitetet e zhvilluara:

Tabela 4.1 Aktivitet e zhvilluara dhe aktivitetet e planifikuara

<i>Faza 6 Hapat e Angazhimit</i>	<i>Përfunduar; Në proces; E planifikuar</i>	<i>Periudha Kohore</i>
<i>Hapi 1: Takimet për Angazhimin me Palët e Interesuara</i>	<i>Përfunduar</i>	Maj 2018
Njoftimi i publikut me anë të posterave	<i>Përfunduar</i>	
Njoftimi i autoriteteve me anë të letrës zyrtare	<i>Përfunduar</i>	
Takimet me Komunitetin	<i>Përfunduar</i>	
Finalizimi i të gjithë takimeve	<i>Përfunduar</i>	
<i>Hapi 2: Anketimi Socio-Ekonomik (ASM)</i>	<i>Në proces</i>	Qershor 2018 – Korrik 2018
Njoftimi për studimin në terren në zonat e mbuluara nga ASM	<i>Në proces</i>	
Zbatimi i ASM – Studim në terren	<i>Në proces</i>	
Analiza Socio-Ekonomike	<i>Në proces</i>	

Takimet e zhvilluara janë kryer sipas formave të listuara më poshtë:

- Takime ballë për ballë me palët e interesuara në nivel kombëtar. Gjatë takimeve kanë qënë të pranishëm përfaqësues të ndryshëm të departamenteve të institucioneve të cilët u ftuan të marrin pjesë në të njëjtin takim;
- Takimet në nivel rajonal/lokal: takimet janë organizuar në nivel rajonal/lokal brenda zonës së studimit të projektit;
- Mbledhjet me Komunitetin në secilën prej fshatrave të zonës së projektit;
- Intervistat e grupeve të fokusit për të evidentuar ndikimin e këtij projekti në jetën dhe aktivitetet e tyre të përditshme.

4.1 TAKIMET ME PALËT E INTERESUARA

4.1.1 Nivel Kombëtar

Takimet në nivel kombëtar u zhvilluan brenda ambienteve të secilit institucion me praninë e Abkons, përfaqësuesve të GPP Korçës dhe IVICOM Consulting, si dhe përfaqësuesit e ministrive/autoriteteve shtetërore. Për secilën prej takimeve u krye një prezantim në Poërpoin në lidhje me qëllimin e punës, prezantimin e projektit, afatin kohor dhe qëllimin e angazhimit me palët e interesuara.


					
				<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtojca A)				

Figura 4.1 Prezantimi i qëllimit të PAPI-it, ndikimet dhe aktivitetet



Secili prej takimeve të zhvilluara është shoqëruar me diskutime të hapura për çdo pyetje dhe përgjigje nga të gjithë pjesëmarrësit. Prezantimi ishte i domosdoshëm për të përmbledhur të gjitha fazat që Projekti ka ndërmarrë deri më tani me objektivin që të përfshijë plotësisht publikun në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar, kërkesat e IFC dhe qasjen GPP Korçës në Angazhimin me Palët e Interesit dhe gjithashtu shërben si bazë e mirë për diskutimet në vazhdim gjatë procesit të VNMS-së.

Në vazhdim, pjesëmarrësve u janë shpërndarë formate pyetësorësh të shkurtër për të mbledhur vlerësimin dhe reagimet në lidhje me të gjitha aktivitetet e fazës së studimit. Të gjithë pjesëmarrësit janë regjistruar nëpërmjet një flete identifikimi, ku plotsohen të gjitha informacionet e nevojshme të pjesëmarrësit, siç janë pozicioni, numri i kontaktit, e-maili dhe nënshkrimi. Të gjitha takimet janë regjistruar me fotografi dhe përmes Minutave të Takimit për secilin prej takimeve të zhvilluara.








  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Figura 4.2 Fotografi gjatë takimeve me institucionet në Nivel Kombëtar



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtojca A)		





OSSHE – Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike



MIE – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë



Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Drejtori i Përgjithshëm

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

A. Rezultatet e konsultimeve me institucionet në Nivelit Kombëtar dhe marrja e opinioneve

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të çështjeve kryesore të adresuara (komenteve të marra) dhe përgjigjeve respektive sipas rastit.

Tabela 4.2 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me autoritetet në Nivel Kombëtar



Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
<i>Mjedis</i>	A ka dorëzuar kompania ndonjë studim mbi kushtet ekzistuese të mjedisit?	GPP Korça ka kryer disa studime paraprake në zonën ku është propozuar ndërtimi i termocentralit. Megjithatë, të dhënat janë paraprake dhe të përgjithshme deri në këtë fazë, pasi gjatë procesit të VNMS-së do të kryhet një studim i thelluar i aspekteve mjedisore dhe do të kryhen matje në terren për të evidentuar kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale të zonës.
<i>Angazhimi i komunitetit në shprehjen e opinionit</i>	Si do të kryhet angazhimi me komunitetin dhe publikun në mënyrë që të shprehin interesin e tyre dhe të ngrenë komentet e tyre gjatë fazës së studimit të VNMS?	Do të kryhen takime me autoritetet shtetërore, autoritetet lokale dhe rajonale dhe me komunitetin duke filluar në këtë fazë të hershme (faza e studimit) në kuadër të procesit të VNMS-së dhe angazhimi me palët e interesuara do të vazhdojë gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit.
<i>Strategjia Kombëtare e Energjisë, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe statusi Strategjik i projektit</i>	A parashikohet projekti brenda këtyre strategjive?	Projekti është vlerësuar si Projekt Strategjik sipas Masterplanit të Gazit dhe gjithashtu do të jetë në linjë me planet zhvillimore vendore të qytetit të Korçës. Konsulenti dhe GPP Korça do të verifikojnë informacionet në Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.
<i>Përdorimi i ujit nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane të Korçës dhe ndikimi i emisioneve të tij në zonë</i>	Çfarë shkarkimesh shtesë mund të kemi nga termocentrali nga përdorimi i ujit të trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane Korçë?	Për procesin teknologjik të ftohjes, projekti ka parashikuar përdorimin e ujit nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane. GPP Korça dhe Konsulenti do të analizojnë çdo ndikim potencial të përdorimit të këtij uji gjatë fazave të mëtejshme të procesit të VNMS.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

<i>Shkarkimi i ujit të ngrohtë gjatë fazës operacionale të impiantit</i>	A do të ketë shkarkime të ujit të ngrohtë në mjedis si pasojë e proceseve të impiantit? Nëse po, cili do të jetë efekti në mjedis?	Rreth 20% e ujit të ngrohtë nga procesi i ftohjes së termocentralit do të shkarkohet në lumin lokal (rreth 25 l/s). Konsulenti, IVICOM dhe GPP Korça do të shqyrtojnë teknologjinë e impiantit dhe do të vlerësojnë çdo ndikim të mundshëm në mjedis. Do të kryhen matjet në terren të gjendjes së burimeve ujore dhe do të parashikohet ndikimi në mjedis i këtyre shkarkimeve.
<i>Parametrat fiziko-kimik të ujit gjatë shkarkimit</i>	A pritet të ndryshojnë parametrat fiziko-kimik të trupit ujqor prites dhe çfarë përberje mund të përmbajë uji i shkarkimit?	Në këtë fazë, nuk mund të shprehim përfundime pasi duhet të kryhen fillimisht matje të parametrave dhe gjendjes ekzistuese të burimeve ujore. Interpretimet do të kryhen pas marrjes së rezultateve, megjithatë vlen të theksohet se teknologjia që do të përdoret për termocentralin është një teknologji moderne dhe gjatë procesit të ftohjes së ujit në sistem mund të çlirohen nivele të ulta të substancave dhe parashikohet ndryshim i vogël i parametrave.
<i>Shpërndarja e avullit të prodhuar nga operimi i impiantit</i>	Si do të menaxhohet avulli i ngrohtë gjatë fazës së funksionimi në periudhën e verës?	GPP Korça dhe IVICOM do të zhvillojnë plane të detajuara për shpërndarjen e avullit të ngrohtë të prodhuar.
<i>Kategoria e tokës mbi të cilën do të ndërtohet impianti</i>	Çfarë lloji është toka ku do ndërtohet termocentrali?	Zona e propozuar për ndërtimin e GPP Korçës është 100% tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës ku do ndërtohet termocentrali është klasifikuar si tokë e kategorisë së V.
<i>Punimet e rehabilitimit</i>	Si do të kryhen punimet e rehabilitimit të tokave të ndikuara pas fazës së ndërtimit?	Procesi i rehabilitimit do të kryhet nëpërmjet një plani rehabilitimi në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme (BAT) dhe praktikatat më të mira mjedisore (BEP). Të gjitha sipërfaqet e tokave të ndikuara do të rehabilitohen dhe do të kthehen njësoj si në gjendjen para fillimit të punimeve.
<i>Blerja e tokës së përhershme</i>	Metodologjia për blerjen e tokës në çfarë çmimi reference do të bazohet?	GPP Korça ka vlerësuar çmimet reference të vendosura nga shteti dhe gjithashtu duke marrë parasysh çmimet e tregut, do të vijë me një studim dhe me një Udhëzues për çmimet reference.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)


<i>Kanalet e ujitjes dhe kullimit</i>	A do të ketë ndërprerje të kanaleve të ujitjes dhe kanaleve të kullimit gjatë procesit të ndërtimit në zonë?	GPP Korça dhe IVICOM do të përgatisin plane të hollësishme për punimet e kalimit të ujit gjatë fazës së ndërtimit. Mund të ketë ndërprerje të përkohshme të kanaleve të ujitjes dhe kanaleve të kullimit gjatë punimeve të ndërtimit. Kontraktori në çdo rast do të ruajë funksionalitetin e skemes ekzistuese për kanalet e ujitjes dhe kullimin të ujit.
<i>Ndikimet në transport dhe infrastrukturën locale gjatë ndërtimit</i>	A do të ndikojë faza e ndërtimit në transportin lokal dhe në bllokimin e rrugëve?	GPP Korca dhe IVICOM do të zhvillojnë një plan të detajuar për menaxhimin e trafikut, duke marrë në konsideratë të gjithë bllokimet rrugore dhe devijimet e mundshme të rrugëve.
<i>Studim fizibiliteti</i>	A ka kryer kompania një studim fizibiliteti për projektin?	Stduimi i fizibilitetit është kryer gjatë vitit të kaluar dhe është mbështetur nga IFC.
<i>Rreziku dhe ndikimi social</i>	A ka kryer kompania ndonjë analizë për riskun social?	Studimi i kushteve ekzistuese do të sigurojë analiza të detajuara dhe informacione (të dhëna sasiore dhe cilësore) për të zhvilluar një vlerësim të plotë të risqeve, ndikimeve dhe nevojës për masa zbutëse.
<i>Përfshirja gjinore</i>	Si është siguruar përfshirja gjinore gjatë angazhimit me palët e interesuara?	Angazhimi me palët e interesit është ndërtuar në përputhje me standardin e IFC, I cili kërkon fuqimisht përfshirjen gjinore duke u nisur nga fazat e hershme të përgatitjes së projektit (përfshirë VNMS) dhe gjatë gjithë zbatimit të projektit. Faza e studimeve të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale siguron angazhimin si fokus grup me grate gjatë procesit të vendim-marrjes për VNMS dhe shprehjeve të opinionëve.
<i>Punësimi lokal</i>	Çfarë kriteresh do të përdorë kompania për të punësuar banorët vendas në zonën ku do të ndërtohet termocentrali?	Kompania do të zhvillojë (faza para fillimit të ndërtimit) një plan punësimi dhe do të rekomandohet nga Konsulenti për të përdorur linjën zyrtare (Bashkinë) për punësimin e banorëve të zonës dhe zonave përreth. Duhet të ndiqet bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve Sociale dhe ministrinë e linjës (Ministria e Shëndetësisë) me qëllim që të bëhet lista e azhornuar e banoreve të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara nga IVICOM dhe GPP Korça për pozicione specifike të punës.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

<i>Trashëgimia kulturore</i>	Si është parashikuar procesi i vlerësimit arkeologjik?	Gjatë studimeve të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale do të kryhen vëzhgime arkeologjike për të dhënë analiza dhe vlerësime ashtu siç e kërkon studimi për VNMS.
------------------------------	--	---

Shumica e çështjeve të diskutuara ishin të lidhura me vlerësimin e ndikimeve në mjedis, por duke mos lënë pa përmendur pyetjet për çështjet teknike të cilat ishin më të pakta.

Grafiku 4.1 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes – Nivel Kombëtar



B. Metoda e vlerësimit dhe rezultatet

Në fillim të çdo takimi, pjesëmarrësve iu kërkua të ngrinin pyetje dhe të hapnin diskutime gjatë prezantimit ose në fund të tij. Gjithashtu, pjesëmarrësve iu shpërnda një format pyetësori vlerësimi për të maksimizuar përfundimin e informacionit të shpërndarë në këtë fazë paraprake të studimit të VNMS. Pyetjet e përfshira në format u bazuan në nxjerrjen e konkluzioneve nëse takimet e zhvilluara u konsideruan të jenë:

- Organizuar në mënyrë të duhur, të mbajtura në një format të përshtatshëm dhe në mënyrë të lehtë për të shpërndarë informacione mbi projektin dhe proceset në vijim;
- Pa manipulime, ndërhyrje, detyrime dhe/apo kërcënime; dhe,
- Kryer në bazë të informacioneve të përshtatshme, të zhvilluara në kohë, duke trajtuar çështje relevante, të kuptueshme dhe të arritshme nga palët e interesuara.

Rezultatet e vlerësimit janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

Tabela 4.3 Pyetësi i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Nivel Kombëtar



Pyetje	Po	Jo
Në përgjithësi, a ishte i përshtatshëm procesi i mbledhjes së komenteve nga ana juaj në këtë fazë të projektit? (Prezantimi dhe Informacioni në lidhje me Projektin)	33 97%	1 3%
Në mënyrë të veçantë: A ishte informacioni që ju dha juve përpara dhe gjatë takimit i mjaftueshëm që ju të jepni komentet tuaja?	12 Inf. të Plota/ 18 Inf. Mes	1 Pa Inf.
A ishte informacioni që ju dha juve dhe gjatë takimit i prezantuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme?	33 100%	0 0%
Keni pasur mundësinë të jepni komentet tuaja përgjatë takimit dhe në përgjithësi?	33 97%	1 3%
A ishte i organizuar takimi në mënyrë që ju të kishit mundësinë të merrnit pjesë dhe të bënit komentet tuaja lehtësisht?	35 97%	1 3%
A jeni frikësuar apo detyruar me ndonjë formë përgjatë procesit të konsultimit?	1 3%	35 97%
A jeni stimuluar në ndonjë formë jokorrekte për të qënë mbështetës i projektit?	1 3%	35 97%

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se pjesëmarrësit e vlerësuar takimin si të duhur nga pikëpamja e përmbajtjes, si dhe nga pikëpamja organizative. Në vazhdim, 97% e pjesëmarrësve vlerësuan se informacioni i dhënë gjatë takimit ishte i kuptueshëm, gjë që u mundësoi atyre gjithashtu të japin komente dhe sugjerime gjatë takimit.

4.1.2 Nivel Rajonal dhe Lokal

Angazhimi me palët e interesit në nivel lokal dhe rajonal për projektin përfshiu takime me drejtoritë dhe agjencitë përkatëse në një afat kohor prej 3 ditësh, si dhe takime me komunitetin në fshatra.

Në nivel rajonal, institucionet u ftuan të marrin pjesë në një takim përmes njoftimit me letrë zyrtare, të cilat janë dërguar në adresë të tyre. Çdo takim u zhvillua brenda ambienteve të secilit institucion të kontaktuar, në prani të përfaqësuesve të ekipit Abkons dhe specialistit/ve të secilës zyrë rajonale. Prezantimi i fazave të projektit dhe procesit të VNMS-së u krye nëpërmjet një prezantimi në Poërpoinit i cili përfshiu detaje të përmbledhura teknike të projektit, gjurmën e ndikuar nga zhvillimi i projektit dhe zonat e influencës, të cilat do të jenë subjekt i studimeve për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, hartën e angazhimit me palët e interesuara dhe gjithashtu gjetjet gjatë fazës së shqyrtimit të VNMS-së në mënyrë që të vlerësohet prania e vlerave të rëndësishme mjedisore dhe socio-ekonomike,

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

duke përfshirë ndikimet e mundshme në receptorët e ekosistemit dhe habitatet në afërsi dhe jetesën e komunitetit lokal.

Në secilën prej takimeve të zhvilluara u theksua qartë se pyetjet mund të ngrihen në çdo kohë, me qëllim ndërtimin e një qasje bashkëpunimi dhe zhvillimin e procesit në mënyrë transparente dhe qasje gjithëpërfshirëse në vendim-marrje.

Më poshtë paraqiten disa prej fotografive të takimeve të zhvilluara:







  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Figura 4.3 Fotografi nga takimet e zhvilluara



  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)



Gjatë takimeve iu drejtuan ftesa disa OJQ-ve, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve arsimore si Universiteti Shtetëror i Korçës, të cilët shprehën dëshirën e tyre për pjesëmarrje në Konsultimin Publik të Hapur në 29 Maj 2018.

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)	

A. Rezultatet e takimeve të konsultimeve dhe marrja e mendimeve




Të gjitha takimet janë regjistruar nëpërmjet fotografive dhe përmes Minutave të Takimit, të cilat japin detajet e rezultateve për secilin takim të zhvilluar. Çështjet kryesore dhe pyetjet e ngritura paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4.4 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me autoritetet në Nivel Rajonal dhe Lokal

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
<i>Ndikime në mjedis</i>	Niveli i emetimeve në ajër si një ndikim në mjedis.	GPP Korca dhe IVICOM do të zbatojnë një teknologji të përparuar që do të prodhojë energji dhe ngrohje në të njëjtën kohë, e parashikuar me emetime brenda niveleve të lejuara të ndotjes. Gjatë studimit të kushteve ekzistuese të mjedisit do të kryhen matje të ndryshme dhe analiza mjedisore në lidhje me cilësinë e ajrit, nivelin e zhurmave, cilësinë e tokës, cilësinë e burimeve ujore, biodiversitetin (flora dhe fauna) dhe analiza të tjera të rëndësishme të aspekteve mjedisore dhe sociale. Për ajrin do të kryhen matje të parametrave të cilësisë së tij në pika të ndryshme dhe do të kryhet një modelim i shpërndarjes së gazeve në ajër, bazuar në kushtet ekzistuese klimatike dhe drejtimin e erës.
<i>Drejtimi i gazeve bazuar në shkarkimet dhe ndotjen e mundshme</i>	Si do të kryhet vlerësimi i ndikimeve?	Faza e studimeve në terren dhe studimeve të gjendjes ekzistuese të mjedisit do të përfshijë gjithashtu analizimin e ndikimeve të identifikuar gjatë fazës së studimit (studimet paraprake) në mënyrë që të përcaktohet natyra/lloji i risqeve, shtrirja kohore dhe hapësinore, kthyeshmëria, magnitudo, mundësia /probabiliteti dhe rëndësia e efektit.
<i>Ndikimet në bimësi dhe prodhimtarinë e tokave bujqësore</i>	Bazuar në shkarkimet në ajër dhe në tokë (përmes shkarkimeve të ujit), cilat janë ndikimet e mundshme që priten?	Projekti do të zbatojë një teknologji të tillë që do të ketë ndikime minimale në mjedis (brenda niveleve të lejuara të ndotjes referuar standardeve ndërkombëtare). Cilësia e ajrit, cilësia e tokës, cilësia e ujit, biodiversiteti (flora dhe fauna) dhe analiza të tjera të rëndësishme të aspekteve mjedisore dhe sociale, janë disa nga elementët dhe parametrat që do të studiohen hollësisht gjatë procesit të studimeve në terren dhe

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
		studimeve të kushteve ekzistuese.
<i>Kanalet e ujitjes dhe kanalet e kullimit</i>	Ndërprerja e rrjedhave ujore gjatë ndërtimit; a do të ketë ndonjë ndërprerje të kanaleve të ujitjes dhe kanaleve të kullimit në zonë?	GPP Korça dhe IVICOM do të përgatisin plane të hollësishme për punimet e kalimit të ujit gjatë fazës së ndërtimit. Gjatë punimeve mund të ketë ndërprerje të përkohshme të kanaleve të ujitjes dhe kanaleve të kullimit. Kontraktori do të ruajë funksionalitetin e skemës ekzistuese për kanalet e ujitjes dhe kanalet e kullimit të ujit.
<i>Shkarkimet e ujit të ngrohtë gjatë procesit të ftohjes</i>	Uji i ngrohtë i shkarkuar	Rreth 20% e ujit të ngrohtë nga procesi i ftohjes së termocentralit do të shkarkohet në lumin lokal (rreth 25 l/s). Konsulenti, IVICOM dhe GPP Korça do të shqyrtojnë teknologjinë e impiantit dhe do të vlerësojnë çdo ndikim të mundshëm në mjedis. Do të kryhen matjet në terren të gjendjes së burimeve ujore dhe do të parashikohet ndikimi në mjedis i këtyre shkarkimeve.
<i>Uji i ngrohtë sanitar</i>	Ku do të përdoret uji i ngrohtë sanitar? Për çfarë shërbimesh?	Teknologjia e termocentralit është e tillë që do të prodhojë edhe ujë të ngrohtë përveç energjisë dhe avullit të ngrohtë. Në të ardhmen, uji i ngrohtë sanitar mund të përdoret në bujqësi, duke marrë parasysh edhe faktin se zona përreth vendit ku do ndërtohet TEC-i është tokë bujqësore. Ky ujë mund të përdoret për serrat bujqësore në zonë.
<i>Niveli i ujërave nëntokësore</i>	A do të ndikohet niveli i ujërave nëntokësore? A do të ketë studime për ujërat nëntokësore?	IVICOM dhe GPP Korça kanë parashikuar të kryejnë një studim të thelluar në zonën e propozuar. Do të bëhen matjet në zonë dhe do të kryhet marrja e mostrave të ujërave nëntokësore brenda zonës së influencës së projektit. Gjithashtu, Konsulenti do të kryejë një vlerësim të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe masave zbutëse përkatëse.
<i>Toka bujqësore dhe blerja e tokës</i>	Lloji i tokës së kërkuar.	Toka në të cilën është propozuar zbatimi i projektit është klasifikuar si tokë e Kategorisë V. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit (tokë e përhershme) është rreth 24 ha.
<i>Prodhimi i energjisë që do të përfshihet në</i>	A ka nevojë sektori energjitik shqiptar për një prodhim kaq të madh të energjisë?	Kompania është e vetëdijshme se impianti do të prodhojë një fuqi më të madhe të energjisë dhe ngrohjes me avull në krahasim me nevojat reale të qytetit të Korçës. Pjesa tjetër e


		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)	

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
<i>sektorin Shqiptar</i>		energjisë dhe ngrohjes me avull do të eksportohen.
<i>Plani i Shëndetit dhe Sigurisë dhe emergjencat</i>	Cilat janë standartet që duhet të zbatohen për sigurinë?	GPP Korça do të zhvillojë një plan të detajuar për Sigurinë dhe Shëndetin, gjithashtu dhe planin për emergjencat. Këto plane do të bazohen në standartet dhe udhëzimet ndërkombëtare. Në projektimin paraprak të TEC-it (faza konceptuale) është bërë një hartim paraprak i elementëve që do përfshihen, duke përfshirë këtu edhe sistemin e emergjencave për masat kundër zjarrit gjatë fazës së funksionimit.
<i>Informacion për Angazhimin me Palët e Interesit</i>	Konsultim public dhe informimi i publikut	Siç përshkruhet edhe në prezantim, konsultimet dhe informimi publik fillon në fazë të hershme, që në fillimin e procesit të VNMS-së në përputhje me Standardet e Përformacës së IFC. Gjatë fazës së studimit (faza aktuale) janë zhvilluar zhvilluar takime me institucionet në nivel kombëtar dhe po vazhdojnë të kryhen takimet në nivel rajonal dhe local. Gjithashtu është planifikuar një takim I hapur dhe konsultim me publikun në 29 Maj 2018 në qytetin e Korçës, ku janë të ftuar të marrin pjesë të gjithë personat e interesuar për projektin.

Pjesa më e madhe e çështjeve të ngritura gjatë takimeve i përkonte çështjeve të ujit (përfshirë dhe sistemin e ujitjes) dhe çështjeve mjedisore dhe vlerësimit të ndikimeve, por pa harruar të përmenden pyetjet teknike që u zhvilluan të cilat ishin më të pakta në numër.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)

Grafiku 4.2 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes – Nivel Rajonal dhe Lokal



B. Metoda e vlerësimit dhe rezultatet




Në fillim të çdo takimi, pjesëmarrësve iu kërkua të ngrinin pyetje dhe të hapnin diskutime gjatë prezantimit ose në fund të tij. Gjithashtu, pjesëmarrësve iu shpërnda një format pyetësori vlerësimi për të maksimizuar përfundimin e informacionit të shpërndarë në këtë fazë paraprake të studimit të VNMS. Pyetjet e përfshira në format u bazuan në nxjerrjen e konkluzioneve nëse takimet e zhvilluara u konsideruan të jenë:

- Organizuar në mënyrë të duhur, të mbajtura në një format të përshtatshëm dhe në mënyrë të lehtë për të shpërndarë informacione mbi projektin dhe proceset në vijim;
- Pa manipulime, ndërhyrje, detyrime dhe/apo kërcënime; dhe,
- Kryer në bazë të informacioneve të përshtatshme, të zhvilluara në kohë, duke trajtuar çështje relevante, të kuptueshme dhe të arritshme nga palët e interesuara.

Rezultatet e vlerësimit janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4.5 Pyetësori i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Nivel Rajonal dhe Lokal

Pyetje	Po	Jo
Në përgjithësi, a ishte i përshtatshëm procesi i mbledhjes së komenteve nga ana juaj në këtë fazë të projektit? (Prezantimi dhe Informacioni në lidhje me Projektin)	55 100%	0
Në mënyrë të veçantë: A ishte informacioni që ju dha juve përpara dhe gjatë takimit i mjaftueshëm që ju të jepni komentet tuaja?	23 Inf. të Plotë/ 32 Inf. Mes	0 Pa Inf.
A ishte informacioni që ju dha juve dhe gjatë takimit të prezantuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme?	55 100%	0
Keni pasur mundësinë të jepni komentet tuaja përgjatë takimit dhe në	55	0

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

përgjithësi?	100%	
A ishte i organizuar takimi në mënyrë që ju të kishit mundësinë të merrnit pjesë dhe të bënit komentet tuaja lehtësisht?	55	0
	100%	
A jeni frikësuar apo detyruar me ndonjë formë përgjatë procesit të konsultimit?	0	55
		100%
A jeni stimuluar në ndonjë formë jokorrekte për të qënë mbështetës i projektit?	0	55
		100%

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se pjesëmarrësit e vlerësuan takimin si të duhur nga pikëpamja e përmbajtjes së informacionit, si dhe nga pikëpamja organizative e takimit.




4.2 TAKIMET ME KOMUNITETIN LOKAL

Takimet u organizuan në secilën prej fshatrave të zonës së ndikuar nga projekti si më poshtë:

- Barç;
- Dishnicë;
- Malavec;
- Qyteti i Korçës;
- Komuna e Bulgarec;
- Çiflig.

Njoftimi për të gjithë takimet e planifikuara u krye më anë të vendosjes së posterave në qendrat e zonave publike të fshatrave dhe përmes shpërndarjes së fletushkave informuese për projektin. Vendi i mbajtjes së takimeve në secilën zonë u organizua nga ekipi i Abkons. Takimet u organizuan për t'u mbajtur në baret locale të fshatrave/qytetit, me qëllim që të gjithë banorët e interesuar të ndjehen rehat në zonën e tyre të jetesës, si dhe për ti dhënë mundësinë për të paraqitur dhe shpërndarë informacion të detajuar rreth fazat e ndryshme të projektit dhe të angazhimit me palët e interesuara gjatë Fazës së Studimit të VNMS-së. Në fshatin Çiflig, për shkak të mungesës së një vendi të hapur publik, ekipi i Abkons ka mbledhur njerëzit përpara qendrës së Shëndetit (ambulancës së fshatit), si një vend kryesor për t'i pasur të gjithë së bashku. Megjithëse qëllimi dhe objektivi i angazhimit me palët e interesuara ishte që të kryhen të gjitha mbledhjet/takimet e planifikuara, banorët e fshatit Malavec nuk shfaqën interes për të marrë pjesë në takime. Informacioni u shpërndarë me postera dhe fletushka konsiderohet si një fazë fillestare për arritjen e një qasje më të afërt në të ardhmen kundrejt komunitetit lokal. Në secilin prej takimeve u theksua qartë se pyetjet mund të ngrihen në çdo kohë, me qëllim ndërtimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e një qasje transparente të procesit dhe marrjes së opinioneve.

Në figurat më poshtë paraqiten disa nga fotot e takimeve me komunitetin:

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)




DISHNICË




Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

ÇIFLIG



  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)




QYTETI I KORÇES



BULGAREC - Zyra e Njësisë Administrative




U krye takimi me Administratorin e Njësisë Administrative Bulgarec. Kjo njësi administrative përfshin fshatrat Dishnicë, Barç, Mlalavec, të cilat janë identifikuar si zonë të ndikuara drejtpërdrejt nga projekti.

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

BARÇ



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

A. Rezultatet e takimeve të konsultimit dhe marrja e opinioneve

Në secilën prej takimeve në komunitet u ngriten pyetje të llojeve të ndryshme. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e çështjeve kryesore gjatë takimeve të zhvilluara:

Tabela 4.6 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga konsultimet me Komunitetin

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
ÇIFLIG	<i>Ndikimi ne mjedis</i>	Çfarë lloj ndikimi do të këtë ky projekt? Kjo krahasuar me impiantin e vjetër të termocentralit në Korçë.	GPP Korça dhe IVICOM do të zbatojnë një teknologji të avancuar për ndërtimin e termocentralit. Impianti do të prodhojë njëkohësisht energji dhe nxehtësi, dhe niveli i emetimeve parashikohet të jeta brenda niveleve të lejuara të ndotjes për shkak të teknologjisë së përdorur. Gjatë studimit të kushteve ekzistuese të mjedisit do të kryhen matje dhe analiza të ndryshme, veçanërisht për cilësinë e ajrit, nivelin e zhurmave, cilësinë e tokës, cilësinë e ujit, biodiversitetin (flora dhe fauna) dhe analiza të tjera të rëndësishme të aspekteve mjedisore dhe sociale.
	<i>Ndikimi ne mënyrën sesi ata jetojnë</i>	Çfarë ndikimi mund të sjellë ky ndërtim?	Vendodhja e këtij fshati (Çiflig) është pranë zonës ku do të zhvillohet ndërtimi i termocentralit, por është edhe fshati në të cilin do të kalojë tubacioni që do lidhet me Projektin TAP për furnizimin e impiantin. Gjatë fazës së studimit të kushteve ekzistuese të mjedisit dhe vëzhgimeve në terren do të kryhen matje dhe analiza të ndryshme për aspektet mjedisore dhe sociale. Në vijim, vlen për tu përmendur se një zbatim i një teknologjie të tillë dhe projekti duhet të konsiderohen si një mundësi e mirë për zhvillimin e zonës dhe për shfrytëzimin e burimit të gazit nga Projekti TAP për furnizimin në të

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
			ardhmen të qytetit të Korçës me avull të ngrohtë me qëllim përdorimin për ngrohje. Toka bujqësore përreth që banorët kanë në posedim nuk parashikohet të ndikohet nga ndërtimi për projektin. Në fund të procesit ndërtimor, do të rehabilitohet çdo sipërfaqe e ndikuar.
	<i>Sociale dhe punësimi</i>	Çfarë shkalle punësimi do të rezultojë nga zhvillimi i këtij projekti për fazën e ndërtimit?	Si parashikim paraprak GPP Korça dhe IVICOM kanë planifikuar të angazhojnë rreth 600 punonjës në total gjatë fazës së ndërtimit. (përfshirë punëtorë, specialistë dhe profesionistë të fushës).
DISHNICË (Shenim 1)	<i>Përdorimi i tokës bujqësore dhe produktiviteti</i>	Është fakt se tokat në afërsi të impiantit të trajtimit të ujit, të cilat janë private dhe/apo në përdorim nga banorët e Dishnicës, përdorin ujin pas procesit të trajtimit i cili kalon në kanalin e kullimit dhe shpërndahet përmes pompave të ujit. Këto janë mjetet që fermerët përdorin për të mbjellë tokat e tyre.	GPP Korça do ta shqyrtojë çështjen e ngritur për ujin e trajtuar nga impianti dhe do të vijojë me një përshtkrim dhe studim të burimeve ujorë në zonë, si dhe një analizë të detajuar për kapacitetin e burimeve ujore që do përdoren në bujqësi.
	<i>Produktet bujqësore do të reduktohen për shkak të mungesës së burimit të ujit</i>	Është një fakt tashme që përafërsisht 100 familje (të vetëpunësuar në bujqësi) përdorin	GPP Korça do ta shqyrtojë çështjen e ngritur për ujin e trajtuar nga impianti dhe do të vijojë me një përshtkrim dhe studim të burimeve ujorë në zonë, si dhe një analizë të detajuar për

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
		ujin e trajtuar nga impianti për ujitjen e tokave.	kapacitetin e burimeve ujore që do përdoren në bujqësi.
	<i>Shkarkimet në mjedis dhe emetimet e gazeve</i>	Çfarë masash do të ndërmerren për të analizuar e shkarkimet e gazeve nga termocentrali?	<p>Matjet e parametrave mjedisore do të shqyrtohen dhe analizohen gjatë gjatë fazës së studimit të kushteve ekzistuese, të cilat do të përfshijnë matjet e cilësisë së ajrit, nivelin e zhurmave, cilësinë e tokës, cilësinë e burimeve ujore, biodiversitetit (flora dhe fauna) dhe analiza të tjera të rëndësishme të aspekteve sociale dhe mjedisore.</p> <p>Ndikimi kryesor potencial i parashikuar për projektin është cilësia e ajrit, e cila do të jetë subjekt i një studimi të hollësishëm, matjes së parametrave ekzistues të cilësisë së ajrit dhe modelimit të shpërndarjes së gazeve të parashikuara në ajrër. Në përputhje me rezultatet e këtyre matjeve dhe modelimit do të vlerësohen ndikimet e mundshme në ajër.</p> <p>Megjithatë, duke iu referuar teknologjisë së propozuar, rasteve të ngjashme të ndërtimit të impianteve të tilla në botë, CCCPP-të janë provuar të jenë efikase, të dizenuara me teknikat më të mira në dispozicion dhe prodhojnë emetime të vogla në ajër.</p>
KORÇA (Lagja Franceze)	<i>Burimet ujore</i>	A do të ketë projekti ndërtim dhe shpime të puseve të ujit?	Projekti parashikon që për procesin e ftohjes teknologjike do të përdoret uji nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura dhe në raste emergjence do të përdoren dy puse uji të cilat do të

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
			ndërtohen nga projekti. GPP Korça dhe IVICOM do të vijjnë me një plan më të detajuar në fazën e ndërtimit.
	<i>Emetimet e Gazit</i>	Ndërtimi i termocentralit do të zhvillohet në afërsi të qytetit të Korçës dhe në afërsi të zonave të banuara. A do të ndikohen banorët nga shkarkimet në ajër?	Aktualisht kjo është faza e parë e procesit të VNMS-së, faza e studimit. Në këtë fazë nuk mund të nxjerrim përfundime nëse do ketë apo jo ndikime në mjedis apo në cilësinë e ajrit. Gjatë fazës së studimit të kushteve ekzistues do të kryhen matje të parametrave të ajrit dhe do të kryhet një modelim i shpërndarjes së gazeve të parashikuara nga termocentrali në ajër. Mëgjithatë, teknologjia e parashikuar na lejon që paraprakisht të evidentojmë se impiante të tilla rezultojnë në emetime të vogla në ajër të cilat zakonisht janë brenda niveleve të lejuara.
	<i>Punësimi lokal</i>	Çfarë kriteresh (klasifikimi) do të përdorë kompania për punësimin e banorëve vendas në zonën ku do të ndërtohet impianti?	Kompania do të zhvillojë (gjatë fazës përgatitore, para ndërtimit) një plan punësimi dhe do të rekomandohet nga Konsulenti për të përdorur linjat zyrtare (Bashkia Korçë) për punësimin e banorëve të zonës dhe zonave përreth (fshatrave).
	<i>Përdorimi i gazit dhe ujit të ngrohtë për banorët e qytetit të Korçës</i>	Cila është zona e mbulimit të këtij kapaciteti prodhimi të termocentralit për qytetin e Korçës?	Ky impiant do të jetë burimi i parë i prodhimit të energjisë dhe avullit të ngrohtë nëpërmjet shfrytëzimit të gazit në rajon, i cili mund të jetë burim dhe një për çdo projekt tjetër në nivel lokal dhe rajonal në kuadër të zhvillimit rural. Gazifikimi i qytetit të Korçës i përket projekteve të zhvillimit rajonal.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
BARÇ (shënim 2)	<i>Blerja e tokës</i>	Blerja e sipërfaqes së tokës së ndikuar.	Përfaqsesit e GPP Korçës shpjeguan në mënyrë të qetë se sipërfaqja e nevojshme e përhershme për ndërtimin e termocentralit është afërsisht 24 ha.
	<i>Çmimi i blerjes së tokës</i>	Çmimi i ulët i paraqitur krahasuar me tregun dhe vlerën reale të tokës	Sqarimi u krye duke evidentuar se janë kryer studime të hollësishme dhe me referencë për të përcaktuar çmimin e tokës. Meqënëse kategoria e tokës është klasifikuar nga autoritet shtetërore si tokë bujqësore e kategorisë V, ata kanë bërë testimin e mostrave të tokës dhe parametrave të cilësisë së dheut. Referenca për çmimin e tokës është bazuar në çmimin e tregut për këtë kategori toke si dhe në çmimin e referencës shtetërore për tokat.
	<i>Impakti mjedisor</i>	Cila është rrezja e ndikimit për impaktet mjedisore gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit?	Paraprakisht u treguan zonat e influencës për secilin prej elementëve mjedisorë dhe sociale. Në këtë fazë, faza e studimit, kryhet një evidentim paraprak i zonave që mund të ndikohen nga zhvillimi i projektit, për të cilat do të kryhen studime të thelluara gjatë fazave në vijim për procesin e VNMS-së. Këto studime do të kryhen duke bërë matje në terren dhe në varësi të rezultateve do të kryhen interpretimet përkatëse të vlerave bazuar në standardet ndërkombëtare dhe shqiptare. Në këtë mënyrë do të përcaktohen edhe ndikime e mundshme për secilin element mjedisor dhe sa mund të jetë rrezja e ndikimit.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
	<i>Ndotja e ajrit</i>	Ndërtimi i impiantit do të sjellë ndotjeë shtesë të ajrit (veçanërisht në periudhën e dimrit).	GPP Korça dhe IVICOM kanë kryer studime paraprake dhe studim fizibiliteti për të përcaktuar vendodhjen duke marrë në konsideratë edhe kushtet atmosferike sezonale dhe gjithashtu shkarkimet në ajër. Në lidhje me teknologjinë u shpjegua së ndërtimi i një impianti të tillë do të përdorë teknologjinë më të fundit, modern, çka nënkupton së shkarkimet në mjedis dhe në ajër do të jenë më të vogla dhe do të sigurohet një nivel mjedisi më i pastër. Përveç kësaj, gjatë studimeve për cilësinë e ajrit do të kryhet modelimi dhe matja e simuluar e parametrave të mjedisit gjatë të katërt sezoneve të vitit duke dhënë qartësisht treguesit më domethënës për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në ajër.
	<i>Ndotja e ujit</i>	A do të kemi ndotje të burimeve ujore?	Gjatë fazës së studimit të kushteve ekzistuese mjedisore do të kryhen matje të ndryshme të parametrave, midis të cilave matje të parametrave të burimeve ujore (nëntokësore dhe sipërfaqësore). Gjithashtu u shpjegua se një nga produktet dhe përfitimet e termocentralit do të jetë prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar, i cili mund të jetë një burim për zhvillimin e produktivitetit të serrave për rritjen e kulturave bujqësore.
	<i>Punësimi lokal</i>	Çfarë kriteresh do të përdore kompania për të punësuar banorët vendas në impiantin që do	Kompania do të zhvillojë (gjatë fazës përgatitore, para ndërtimit) një plan punësimi dhe do të rekomandohet nga Konsulenti për të përdorur linjat zyrtare (Bashkia Korçë) për punësimin

					
		<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>			
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)				

Fshati	Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
		ndërtohet?	e banorëve të zonës dhe zonave përreth (fshatrave).


Shënim 1: Në Dishnicë është e rëndësishme të përmendet se shqetësimet kryesore të banorëve dhe çështjet e evidentuara si problematike kanë të bëjnë me ujin për vaditje dhe mungesën e ujit për qëllime bujqësore në të ardhmen, pas fillimit të ndërtimit të termocentralit. Rreth 100 familje janë të vetëpunësuar në bujqësi sipas të dhënave të mbledhura prej tyre. Kulturat bujqësore që këta fermerë kanë, janë burimi i vetëm i të ardhurave për familjet e tyre.

Shënim 2: Gjatë konsultimeve dhe diskutimeve, çështja e përdorimit të ujit për qëllime bujqësore u ngrit disa herë. Është sqaruar qartë se termocentrali nuk do të përdorë drejtpërdrejt burimet ujore të zonës, por për procesin teknologjik do të përdorë ujin e trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

Gjithashtu u shpjegua se termocentrali do të prodhojë ujë të ngrohtë sanitar, i cili mund të jetë një burim për zhvillimin e bujqësisë në zonë dhe përdorimin e tij në serrat përreth për rritjen e prodhimeve bujqësore.

Grafiku më poshtë paraqet një përmbledhje të çështjeve kryesore të ngritura dhe të diskutuara gjatë takimeve me komunitetin.

Grafiku 4.3 Grafiku ilustrues për llojin e çështjeve të ngritura sipas përqindjes - Komuniteti



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

B. Metoda e Vlerësimit dhe Rezultatet

Secili prej takim përfundoi me nënshkrimin e fletës së pjesëmarrjes dhe gjithashtu me plotësimin e formularit të vlerësimit dhe marrjes së reagimeve për takimin. Pyetjet e përfshira në format u bazuan në nxjerrjen e konkluzioneve nëse takimet e zhvilluara u konsideruan të jenë:

- Organizuar në mënyrë të duhur, të mbajtura në një format të përshtatshëm dhe në mënyrë të lehtë për të shpërndarë informacione mbi projektin dhe proceset në vijim;
- Pa manipulime, ndërhyrje, detyrime dhe/apo kërcënime; dhe,
- Kryer në bazë të informacioneve të përshtatshme, të zhvilluara në kohë, duke trajtuar çështje relevante, të kuptueshme dhe të arritshme nga palët e interesuara.



Rezultatet e vlerësimit janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Në takimin e zhvilluar në fshatin Barç, banorët që morën pjesë në takim nuk pranuan të plotësonin formatin e vlerësimit edhe pse Konsulenti u përpoq ti shpjegonte se plotësimi i këtij formulari është pjesë e procesit të VNMS ku duhet të grumbullohen komentet e tyre mbi procesin e studimit dhe më pas ata mund të lënë komentet e tyre të çdo lloji, pa manipulime dhe pa u frikësuar në shprehjen e opinionit të tyre.

Rezultatet e vlerësimit janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4.7 Pyetësi i vlerësimit për takimet gjatë fazës së studimit – Komuniteti

Pyetje	Po	Jo
Në përgjithësi, a ishte i përshtatshëm procesi i mbledhjes së komenteve nga ana juaj në këtë fazë të projektit? (Prezantimi dhe Informacioni në lidhje me Projektin)	61 100%	0
Në mënyrë të veçantë: A ishte informacioni që ju dha juve përpara dhe gjatë takimit i mjaftueshëm që ju të jepni komentet tuaja?		
A ishte informacioni që ju dha juve dhe gjatë takimit të prezantuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme?	61 100%	0
Keni pasur mundësinë të jepni komentet tuaja përgjatë takimit dhe në përgjithësi?	61 100%	0
A ishte i organizuar takimi në mënyrë që ju të kishit mundësinë të merrnit pjesë dhe të bënit komentet tuaja lehtësisht?	61 100%	0
A jeni frikësuar apo detyruar me ndonjë formë përgjatë procesit të konsultimit?	0	61 100%
A jeni stimuluar në ndonjë formë jokorrekte për të qënë mbështetës i projektit?	0	61 100%

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

4.2.1 *Angazhimi me OJQ-të*

OJQ-të janë tashme të identifikuar si palë kryesore të interesuara për të patur bashkëpunim të hapur dhe “proaktiv”.

Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) dhe veçanërisht ato që përfaqësojnë komunitetet e ndikuara drejtpërdrejt nga një project, mund të jenë palë të rëndësishme për kompanitë në mënyrë që të identifikojnë çështje dhe të angazhohen mbi një bazë proaktive. OJQ-të mund të kenë ekspertizë të vlefshme për një angazhim efektiv me palët e interesuara. Për shembull, ato mund të jenë burime të njohurive/informacioneve lokale, si borde të dëgjimit për projektimin dhe zbutjen e ndikimeve, duke kryer konsultime me grupet sensitive apo dhe duke qene vetë partnere në panifikim, implementim dhe monitorim në projekte të ndryshme dhe programe të lidhura me vetë projektin. Më poshtë paraqitet një listë e OJQ-ve dhe Shoqërive civile të cilat janë kontaktuar dhe ftuar për të marrë pjesë në takimet/ diskutimet publike.

Ata u njoftuan për pjesëmarrje në Konsultimin Publik të Hapura për fazën e studimit i mbajtur në 29 Maj 2018 në qytetin e Korçës.

Tabela 4.8 Organizata OJQ/ Shoqëria Civile të identifikuar

Emri i Përfaqësuesit	Organizata OJQ/ Shoqëria Civile
Ilia Dishnica	Dorcas Aid
Genti Mico	Vision Fund
Ereandra Taipllari	CSDS
Aurel Grabocka	ARZH
Ian Loring	Kenedi
Mikel Vllahu	Kryqi i Kuq
Alketa Zallemi	TAP
Lazjon Petri	Green Action
TBD	Korca Eoman Association
TBCD	Association of users of forester and pasture Prespa
TBD	E ardhmja per te shkuaren

4.2.2 *Konsultimet me Shoqërine e Hapur në Dëgjuesën Publike*

Në përputhje me qëllimin e planit të punës dhe gjithashtu në përmbushje të Standardeve të Performancës së IFC-së, u zhvilluan konsultimet e hapura publike në qytetin e Korçës, në Grand Hotel më datë 29 Maj 2018, në orën 11:00. Qëllimi i këtij takimi ishte që të kryhej një prezantim i projektit që në fazë të hershme, në mënyrë që të përfshihen të gjithë palët e interesuara dhe komuniteti lokal në këtë proces konsultimi për VNMS-në, si dhe për vendim-marrje në bashkëpunim dhe marrjen e komenteve/sugjerimeve që mund të rezultojnë nga dëgjesa.

Në konsultimin me publikun morën pjesë 51 persona, të ftuar përmes ftesave me letër dhe ftesave në mënyrë elektronike, si dhe me shpalljen e posterave. Pjesëmarrësit ishin persona

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)		

që përfaqësonin Pronarët e Tokave, (nga zonat e ndikuara në mënyrë të drejtpërdrejtë), kryetarët e komunave, pjesëtarë të Këshillit të Bashkisë, përfaqësues të Administratës së Zonave të Mbrojtura, Agjencisë së Zhvillimit Rural (OJQ), përfaqësues të OJQ-ve dhe autoritete të tjera të interesuara për projektin. **Lista e pjesëmarrësve gjatë konsultimit me publikun për fazën e studimit gjendet bashkëngjitur në këtë raport.**

Në panel ishin përfaqësuesit e IVICOM Consulting, GPP Korçës dhe Abkons, të cilët kryen një prezantim të shkurtër të projektit, shpjeguan fazat e procesit të VNMS-së, metodologjinë që do ndiqet për VNMS dhe studimet e planifikuara për tu kryer gjatë fazave në vijim. Të gjithë pjesëmarrësit në takim u ftuan që të bënin komente dhe diskutime mbi çështjet e konsideruara prej tyre si të rëndësishme dhe të bënin pyetje/sugjerime të mundshme për projektin dhe procesin e VNMS-së në mënyrë që të gjithë opinionet dhe komentet e tyre të adresohen në kohë për të zhvilluar një proces gjithëpërfshirës me të gjithë palët e interesuara në projekt.

Tabela 4.9 Përmbledhja e çështjeve kryesore nga takimi i Konsultimit me Publikun

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
<i>Çmimi i Blerjes së Tokës</i>	Disa nga pronarët e ndikuar drejtpërdrejt të tokave (saktësisht katër prej tyre) nga fshati Barç ishin të shqetësuar për çmimin e tokës. Ata nuk u pajtuan me çmimin e tokës së propozuar dhe refuzuan ta shesin tokën e tyre, gjithashtu ata kërkuan se pse kompania doli me këtë çmim.	Çmimi i blerjes së tokës do të jetë subjekt i takimeve të mëtejshme të konsultimit. Nga përfaqësuesit e IVICOM Consulting u shpjegua se ky çmim bazohet në disa kriteret të përcaktuara, mbi bazën e të dhënave zyrtare të publikuara nga ligji shqiptar dhe marrjen parasysh të çmimit të tregut. Është kryer marrja e mostrave të tokës për analizën e parametrave të saj në mënyrë që të përcaktohet produktiviteti i tokës dhe gjithashtu është thirrur një ekspert i pavarur për tokën i cili ka kryer vlerësimin për çmimin e tokës, ku më pas ky vlerësim i është bashkëngjitur ofertës së kompensimit. Po ashtu është marrë parasysh çmimi i tregut për këtë lloj toke, dhe një tjetër fakt i rëndësishëm për tu përmendur është se çmimi që ofrohet nga kompania është përafërsisht dy herë më i lartë se çmimi i përcaktuar nga VKM, i cili gjendet edhe i bashkëngjitur në ofertë.
<i>Ndotja e Mjedisit</i>	A do të ndikojë ky projekt në furnizimin me ujë, a do të ketë 24 orë ujë pas zbatimit të këtij projekti? A do të shkaktojë ky projekt zhurma akustike gjatë funksionimit?	Diskutimi sot bazohet në prezantimin e projekti dhe paraqitjen e informacioneve në linjë të përgjithshme dhe paneli do të mirëpresë çdo pyetje në interes të fazës aktuale, faza e studimit për VNMS. Ndërsa në lidhje me emetimet në ajër dhe ndikimet e tjera të mundshme, këto çështje mund të



Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
	<p>A do të ndërtojë investitori edhe sistemin e shpërndarjes për ngrohjen me avull?</p> <p>Ndërsa jemi të vetëdijshëm për përmbajtjen e lartë të sqfurit në gaz, çfarë lloj shkarkimesh do të jenë në ajër?</p>	<p>diskutohen pas përfundimit të fazës së studimeve specifike të gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe modelimit të shpërndarjes së gazeve në ajër, sikurse u përmend në prezantimin e shpjeguar pak më parë.</p> <p>Pra, për ndikimet e mundshme mjedisore, diskutimi mund të bëhet në detaje pas përfundimit të studimit dhe këto të dhëna do të paraqiten gjatë fazës së dëgjësës me publikun për VNMS e thelluar të projektit.</p>
<i>Drejtimi i erës dhe studimet përkatëse</i>	<p>Shqetësim i ngritur për ndotjen e shtuar të ajrit në qytet, veçanërisht gjatë stinës së dimrit</p>	<p>Të gjithë elementet mjedisore që përmendët si ajri, uji, toka dhe elementë të tjera që mund të ndikohen nga zhvillimi i projektit ishin të përfshirë në prezantimin e bërë pak më parë dhe do të studiohen më tej në detaje gjatë procesit të VNMS-së.</p> <p>Për ajrin është konsideruar paraprakisht që zona e influencës dhe zona e studimit do të shtrihet në një rreze prej 5 km nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit. Në këtë rreze do të merren mostra të ndryshme dhe do të analizohen parametrat ekzistues të cilësisë së ajrit sipas udhëzimeve të specialistit përkatës. Gjithashtu do të kryhet një modelim i shpërndarjes së gazeve të parashikuara në ajër.</p> <p>Pas përfundimit të studimit, Konsulenti dhe Kompania do të dalin me një raport paraprak të VNMS-së dhe do të takohemi përsëri në një dëgjësë/konsultim publik për të diskutuar ndikimet e mundshme bazuar në rezultatet e analizave. Gjithashtu, analiza e përmbajtjes së gazit (lëndës djegëse) dhe parametrat e tij do të përfshihen në raportin përfundimtar të VNMS-së.</p>
<i>Sipërfaqja e ndërtimit që përfshihet për projektin</i>	<p>Projekti do të zbatohet në një sipërfaqe të konsiderueshme, e cila do të ndikojë në ekonominë e zonës.</p>	<p>Termocentrali me Gaz do të zbatohet në një sipërfaqe prej rreth 24 ha (toka e përhershme). Dëshiroj të theksoj faktin se kompania ka zhvilluar diskutime të vazhdueshme me autoritetet qeveritare për të përdorur gjurmët ekzistuese të përdorura për Projektin TAP, p.sh. lidhjen e rrjetit të linjës së transmetimit në NS Zëmlak. Në këtë mënyrë, ndikimet në mjedis paraprakisht janë</p>

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS – GPP Korça (Shtocja A)

Çështjet	Çështjet kryesore të adresuara/Pyetjet	Përgjigjia
		reduktuar ndjeshëm dhe kompania synon të mbrojë mjedisin që në fazën e parë të projektit, e cila është projektimi i termocentralit.
<i>Përdorimi i Gazit dhe ujit të ngrohtë për qytetin e Korçës</i>	Prodhimi i avullit të ngrohtë dhe nese qyteti i Korçës do përdorë këtë produkt për shtëpitë e banimit.	Përsa i përket shpërndarjes së avullit të ngrohtë në qytet, ka një studim fizibiliteti i cili është duke u kryer nga Bashkia dhe po diskutohen mundësitë e përdorimit të burimeve ngrohëse me IFC (Korporata Ndërkombëtare e Financimit).
<i>Alternativat e vendodhjes së ndërtimit për termocentralin e propozuar</i>	Cilat janë vendodhjet e ndryshme për ndërtimin e TEC-it? Përse është zgjedhur kjo zonë?	Ka disa arsye për zgjedhjen e vendodhjes aktuale të propozuar për ndërtimin e TEC Korçë. Së pari, Master Plani i Gazit në Shqipëri ka përcaktuar vendin për ndërtimin e TEC Korçës pas disa propozimeve dhe diskutimeve me autoritetet përkatëse qeveritare. Përveç kësaj, vendi i propozuar paraqet disa përparësi/ avantazhe. Së pari, Impianti i ri do të jetë pranë tubacionit të gazit (Projektit TAP). Së dyti, termocentrali i ri do të përdorë ujin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane të Korçës për qëllime industrial dhe për procesin e ftohjes për termocentralin, prandaj vendi i propozuar duhet të jetë pranë Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane. Së treti, zona është afër qytetit të Korçës, e cila përbën një avantazh për investimet e ardhshme në rrjetin e shpërndarjes së qytetit për ngrohjen me avull. Së fundmi, zona përreth është tokë bujqësore dhe termocentrali mund të kontribuojë në zhvillimin e serrave dhe investimeve të ardhshme në zonë për këtë sektor. Uji i ngrohtë sanitar që do prodhohet nga termocentrali mund të përdoret për qëllime bujqësore dhe aktivitete të ndryshme për serrat aktive në zonë.

Takimi përfundoi me shpërndarjen e Dokumenteve Përmbledhës të Informacionit (DPI) për të gjithë pjesëmarrësit si një mekanizëm informimi dhe regjistrimi i cili mbledhet dhe ruhet si dokument zyrtar për mbajtjen e të dhënave dhe komenteve/sugjerimeve të pjesëmarrësve.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

Më poshtë paraqitet në formën e shëmbullit një format i printuar i këtij dokumenti dhe i plotësuar prej një pjesëmarrësi.

  	
<p style="text-align: right;"><i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i></p>	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtojça A)




Figura 4.4 Paraqitje ilustruese e Dokumentit Përmbledhës të Informacionit



The figure displays several pages from the 'KUSHI PËR FAZËN VNMS-07' report. On the left, there is a table of contents titled 'KUSHI I KRYEVE DOKUMENTI' listing various sections like 'Dokumenti i Përmbledhës i Informacionit' and 'Përmbledhja e Informacionit'. In the center, a flowchart titled 'KUSHI PËR FAZËN VNMS-07' illustrates the process flow from 'Faza Aktuale e punës' through 'Vlerësimi' to 'Përfundimi'. On the right, a map shows the project location in Korça, with a legend and scale. Below the map is a registration form titled 'PLETA E REGJISTRIMIT DHE KOMENTET' with fields for name, date, and comments.

Figura 4.5 Pamje ilustruese gjatë takimit për Konsultimin me Publikun



  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtojça A)




			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

4.3 PËRFUNDIME DHE OPINIONE MBI PROJEKTIN

Të gjitha grupet e identifikuara të interesit u informuan dhe u takuan gjatë kësaj faze të hershme të procesit të VNMS-së, Faza e Studimit. Takimet dhe konsultimet rezultuan në arritje mjaft pozitive ku shumica e çështjeve të ngritura dhe pyetjeve/komenteve me të cilat përballlemi në këtë fazë, janë tashmë të njohura dhe të adresuara. Sugjerimet kryesore dhe përfundimet e nxjerra nga kjo fazë studimore dhe konsultuese për projektin, rezultojnë të jenë ndikimet e mundshme në cilësinë e parametrave të mjedisit dhe ndikimet e drejtpërdrejta si pasojë e zhvillimit të aktivitetit (duke përfshirë në mënyrë të veçantë ndikimin në ajër dhe ndikimin në burimet ujore). Gjithashtu, një prej shqetësimeve kryesore të komunitetit lokal është procesi i blerjes së tokës dhe përdorimi i tokave bujqësore dhe produktiviteti i tyre në të ardhmen.

Përsa më sipër, këto çështje do të konsiderohen më hollësi dhe do të përpunohen më në detaje gjatë procesit të VNMS-së. Raportimi mbi Angazhimin me Palët e Interesuara do të pasohet me fazën e studimit të kushteve ekzistuese mjedisore dhe studimin në terren, i cili do të përfshijë grupet e interesit dhe angazhimin me palët kryesore në këtë aspekt.


			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Raporti i Angazhimit me Palët e Interesuara për Fazën e Studimit të VNMS - GPP Korça (Shtocja A)		

5 MEKANIZMI I ANKESAVE

Gjatë fazës para fillimit të punës së ndërtimit (faza e procesit të VNMS) dhe gjatë procesit të ndërtimit mund të parashikohet që njerëzit e ndikuar apo komuniteti të kenë ankesa në kudoër të projektit. Në këtë mënyrë është e rëndësishme të sigurohet që këto ankesa të pranohen, të hetohen dhe në një kohë të shkurtër të zgjidhen dhe Kompania të jenë në gjendje të zgjidhë të gjitha ankesat e hapura nga komuniteti.

Grafiku i paraqitur më poshtë jep një përshkrim të shkurtër të hapave dhe procedurës për zgjidhjen e një ankese:

Figura 5.1 Paraqitja skematike e procedurës për Mekanizmin e Ankesave



**PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (VNMS)
PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR “TERMOCENTRAL ME GAZ”, GPP KORÇA**

DOKUMENT PËRMBLEDHËS INFORMACIONI



QËLLIMI I KËTIJ DOKUMENTI

Ky Dokument Përmbledhës Informacioni (DPI) ka si qëllim të informojë Palët e Interesuara dhe të Ndiuara (PI & N) për procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për ndërtimin dhe funksionimin e projektit të propozuar, Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça).

Ky dokument ka si qëllim të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të projektit të propozuar dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) që do ndiqet, si dhe njëkohësisht do i sigurojë pjesëmarrësve, mundësinë për:

- Regjistrimin si palë e interesuar në procesin e pjesëmarrjes së publikut; dhe
- Të dhënë komente paraprake për çdo çështje mjedisore, sociale dhe ekonomike që lidhet me zhvillimin e propozuar.

Gjatë procesit të VNMS-së që do të ndiqet, do të vlerësohen çështjet më të rëndësishme, si dhe impaktet e mundshme mjedisore dhe sociale. Komentet e juaja do sigurojnë që çështjet relevante të vlerësohen dhe do bëhen pjesë e procesit të VNMS-së. Autoriteti vendim-marrës është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Standardet e Performancës nga Korporata Ndërkombëtare e Financës (IFC).

PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Projekti i propozuar ka si qëllim, ndërtimin dhe funksionimin e një termocentrali me cikël të kombinuar me lëndë djegëse gazin natyror, CCCPP Korça, pranë qytetit të Korçës, në Shqipëri, bazuar në nivelin e tanishëm të njohurive dhe zhvillimin e teknologjisë, si dhe zgjidhjet e konfirmuara teknike të përdorura si

referencë për projekte të ngjashme me cikël të ombinuar (CCCPP) të ndërtuara në mbarë botën. Impianti CCCPP (apo ndryshe GPP Korça) do të prodhojë deri në 500 MW energji duke përfshirë 80 MW për ngrohje me avull dhe 5 MW për ujë të ngrohtë sanitar. Lënda djegëse gaz do të furnizohet nga tubacioni i Projektit Trans Adriatik Pipeline (TAP) që kalon 2.1 km në drejtim të veriut.

Për procesin e ftohjes dhe plotësimin e nevojave të kullës ftohëse të termocentralit, do të përdoret uji i marrë nga impianti i trajtimit të ujrave të ndotur Korçë, si dhe në raste emergjencash, do të plotësohet kërkesa e nevojshme me anë të dy puseve të vendosura brenda zonës së projektit të termocentralit. Lidhja me rrjetin elektrik do të kryhet me anë të një linje transmetimi të dy-fishtë 400 kW në drejtim të nën-stacionit Zëmlak në distance rreth 11.2 km.

Periodha e ndërtimit të projektit parashikohet të jetë 28-34 muaj, kjo në varësi të punës paraprake; projektimit paraprak dhe kushtet e tjera të nevojshme. Centrali është projektuar për të punuar të paktën 7,500 orë në vit ose më shumë, për një kohë shërbimi prej 200,000 orësh. Centrali do të projektohet për të arritur një shkallë të lartë të automatizimit dhe operimit të centralizuar duke përdorur një Sistem të Shpërndarë të Kontrollit për kontrollin e gazit të termocentralit GPP Korça.

Objektivat e përgjithshme të projektit janë si më poshtë:

- Rritja e përdorimit të gazit në dobi të ekonomisë kombëtare;
- Diversifikimi i burimeve të energjisë dhe rrugëve të furnizimit për të rritur sigurinë e nevojshme dhe qëndrueshmërinë energjetike në Shqipëri;
- Futja e teknologjive të përparuara të përdorimit të gazit;

Në përputhje me prioritetet kombëtare, projekti do të jetë në gjendje të ofrojë një teknologji të avancuar, ekologjikisht miqësore, që përmirëson optimizimin e

burimeve energjetike, përmbushjen e kërkesave lokale dhe rajonale dhe arritjen e objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen.

Impianti përfaqëson një teknologji efikase që siguron shfrytëzimin optimal të energjisë duke siguruar ndikimin më të ulët të mundshëm në mjedis, zhvillimin e qëndrueshëm të të gjithë sektorëve të tjerë ekonomikë dhe socialë, si dhe rritjen e cilësisë së jetës së popullatës lokale. Përparësitë kryesore të zhvillimit të propozuar janë:

- 80 MW për ngrohjen me avull të qytetit të Korçës (pas ndërtimit të rrjetit qendror të shpërndarës);
- 5 MW për ujë të nxehtë sanitar që mund të përdoret për qëllime bujqësore (përdorimi nga serat ekzistuese në zonë dhe promovimin e serave të tjera në të ardhmen nëpërmjet ndërtimit të termocentralit);
- Përdorimi i ujit të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura Korçë, si burim për proceset e termocentralit, duke ruajtur kështu burimet ujore të zonës;
- Hapja e rreth 600 vendeve pune gjatë fazës së ndërtimit dhe mbi 100 punonjës të punësuar gjatë fazës së funksionimit.

ÇFARË ËSHTË VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL?

Një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është një mjet planifikimi dhe vendim-marrës që përdoret për të identifikuar ndikimet mjedisore të një projekti të propozuar, përpara zhvillimit të tij. Qëllimi i VNMS-së është të përshkruajë ndikimet e mundshme të zhvillimit të propozuar në terma mjedisorë, ekonomik dhe social. Për këtë arsye, duhet të identifikohen në mënyrë të menjëhershme, çështjet dhe shqetësimet publike, në mënyrë që këto të mund të regjistrohen dhe të përgjigjen në VNMS. Të gjitha komentet e pranuar me shkrim do të përfshihen në raportet që do dorëzohen tek autoritetet kompetentë për shqyrtimin e tyre.

Bazuar në Standardet e Performancës nga Korporata Ndërkombëtare e Financës (IFC), procesi i VNMS-së përbëhet nga dy faza. **Faza e parë** është faza e Studimit ose Scoping, e cila identifikon çështjet potenciale që kërkojnë investigime më të hollësishme nëpërmjet studimeve të specializuara. Një listë e plotë e studimeve të specializuara dhe çështjet që duhet të adresojnë, do të detajohen në Draftin e Raportit të Studimit, i cili do të

vihet në dispozicion për rishikimin/shqyrtimin e publikut dhe të autoriteteve përkatëse.

Faza e dytë është faza e Vlerësimit të Ndikimit, gjatë së cilës do të ndërmerren investigime të hollësishme për çështjet e identifikuar gjatë studimit. Studimet e specializuara, të identifikuar deri në këtë fazë ndër të tjera do të përfshijnë: ajrin (modelimi i shpërndarjes së emetimeve në ajër), ujin (ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë), tokën, llojin e tokës, studimin dhe vlerësimin e biodiversitetit, vlerësimin vizual, studimin socio-ekonomik dhe vlerësimin e ndikimeve (opinione profesionale); zonat e mbrojtura dhe vlerësimin e ndikimit në trashëgiminë kulturore.

PJESËMARRJA PUBLIKE

Pjesëmarrja e publikut është thelbësore në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Parimet e Standardeve të Performancës IFC dhe të Bankës Botërore rregullojnë shumicën e aspekteve të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis, duke përfshirë pjesëmarrjen e publikut. Këto standarde përfshijnë ofrimin e vazhdueshëm të informacionit të nevojshëm (në mënyrë transparente) të Palët e Interesuara dhe të Ndikuara (PI&N).

Gjatë Procesit të Dëgjësës Publike, do të mblidhen të dhëna nga aplikuesi, ekspertët teknikë, autoritetet qeveritare dhe publiku i gjerë, për të sjellë një kuptim më të mirë të projektit për të gjithë të përfshirët dhe vendim-marrje më të informuar gjatë gjithë procesit. Palëve të Interesuara dhe të Ndikuara (PI&N) do t'u jepet mundësia për të komentuar gjetjet e raportit të Studimit (Scoping) dhe Raportit të Thelluar të VNMS-së, si dhe gjetjet e studimeve të specialistëve gjatë periudhës së specifikuar të dhënies së komenteve.

Regjistrohuni duke filluar nga data 29 maj 2018

Jeni të ftuar për të regjistruar interesin tuaj në aktivitetin e propozuar dhe për të siguruar të dhënat tuaja duke plotësuar Formularin e Regjistrimit & Komenteve, në fund të këtij dokumenti ose duke dërguar komentet/sugjerimet tuaja përmes email-it, postës ose faksit në:

GPP KORÇA
Adresa: Lagjja Nr. 1,
Pogradec/Shqipëri
www.gppkorca.com
qa@gppkorca.com

KUSH PO E KRYEN VNMS-në?

Në lidhje me rregulloret e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), duhet të emërohet një Praktikant i pavarur për Vlerësimin e Mjedisit që të realizojë VNMS-në. ABKONS sh.p.k është emëruar për të kryer VNMS-në. ABKONS do të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore që lidhen me aktivitetin e propozuar duke kryer një proces objektiv dhe të pavarur të VNMS-së në të cilin të gjitha informacionet dhe opinionet relevante të Palëve të Interesuara dhe të Ndikuara (PI&N) do të mblidhen dhe do t'i kalohen Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisi (MTM), si dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në këtë mënyrë mund të bëhet një proces i informuar i vendim-marrjes.

Figure 1: Procesi dhe Fazat e VNMS-së në përputhje me Standardet e Performancës së IFC-së





Figura 2: Harta dhe vendodhja e projektit të termocentralit GPP Korça



Topographic map of GPP Korça

Legend

- Facility**
- Gas Pipeline
 - Gas Power Plant
 - Gas Power Plant + Transmission line
 - Gas Power Plant+Gas Pipeline
 - Transmission line
 - Gas Pipeline
 - Transmission line
 - Gas Power Plant

Date: 21/06/2018

Table of coordinate systems

OBJECTID	Point number	Facility	UTM		Gauss Kruger	
			X	Y	X	Y
1	Point 1	Gas Power Plant	481906.5156	4489867.145	481906.5156	4489867.145
2	Point 2	Gas Power Plant	481794.7408	4489115.965	481794.7408	4489115.965
3	Point 3	Gas Power Plant	481711.101	4489145.256	481711.101	4489145.256
4	Point 4	Gas Power Plant	481787.9622	4489168.277	481787.9622	4489168.277
5	Point 5	Gas Power Plant	481775.3052	4489188.228	481775.3052	4489188.228
6	Point 6	Gas Power Plant	481693.5318	4489205.18	481693.5318	4489205.18
7	Point 7	Gas Power Plant	481698.1664	4489225.4	481698.1664	4489225.4
8	Point 8	Gas Power Plant	481743.5158	4489212.662	481743.5158	4489212.662
9	Point 9	Gas Power Plant + Gas Pipeline	481778.8168	4489309.608	481778.8168	4489309.608
10	Point 10	Gas Power Plant + Gas Pipeline	481786.1016	4489385.511	481786.1016	4489385.511
11	Point 11	Gas Power Plant + Gas Pipeline	481801.1818	4489444.025	481801.1818	4489444.025
12	Point 12	Gas Power Plant	481817.8334	4489438.862	481817.8334	4489438.862
13	Point 13	Gas Power Plant	481842.9178	4489583.318	481842.9178	4489583.318
14	Point 14	Gas Power Plant	481868.4462	4489593.704	481868.4462	4489593.704
15	Point 15	Gas Power Plant	481878.261	4489596.266	481878.261	4489596.266
16	Point 16	Gas Power Plant + Transmission line	482077.815	4489528.543	482077.815	4489528.543
17	Point 17	Gas Power Plant + Transmission line	482108.8788	4489561.983	482108.8788	4489561.983
18	Point 18	Gas Power Plant + Transmission line	482136.3248	4489583.386	482136.3248	4489583.386
19	Point 19	Gas Power Plant + Transmission line	482164.4211	4489581.983	482164.4211	4489581.983
20	Point 20	Gas Power Plant + Transmission line	482117.6715	4489551.686	482117.6715	4489551.686
21	Point 21	Gas Power Plant	482113.7027	4489496.821	482113.7027	4489496.821
22	Point 22	Gas Power Plant	482217.6842	4489496.138	482217.6842	4489496.138
23	Point 23	Gas Power Plant	482161.4383	4489343.149	482161.4383	4489343.149
24	Point 24	Gas Power Plant	481877.2968	4489208.805	481877.2968	4489208.805
25	Point 25	Gas Pipeline	481885.6878	4489583.304	481885.6878	4489583.304
26	Point 26	Gas Pipeline	481888.2366	4501182.73	481888.2366	4501182.73
27	Point 27	Transmission line	482468.6516	4501828.648	482468.6516	4501828.648
28	Point 28	Transmission line	484002.8471	4503268.345	484002.8471	4503268.345
29	Point 29	Transmission line	487411.4204	4505444.812	487411.4204	4505444.812
30	Point 30	Transmission line	488863.6882	4502603.6882	488863.6882	4502603.6882
31	Point 31	Transmission line	488034.1763	4502651.833	488034.1763	4502651.833

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
 Projection: Transverse Mercator
 Datum: WGS 1984
 False Easting: 500.000.000
 False Northing: 0.0000
 Central Meridian: 21.0000
 Scale Factor: 0.9996
 Latitude Of Origin: 0.0000
 Units: Meter



Scale: 1:40,000



Adresa: Rr: Themistokil Gemenj,
 Tirana/Albania
 Email: info@abkons.com
 Tel/Fax: +355 4 22 58 326
 Web: www.abkons.com



FLETA E REGJISTRIMIT DHE KOMENTEVE

PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (VNMS) PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR “TERMOCENTRAL ME GAZ”, GPP KORÇA

Unë kërkoj që të regjistrohem si Palë e Interesuar dhe e Ndikuar (PI&N) në lidhje me projektin e propozuar. Ju lutemi, sigurohuni që unë të marr të gjithë informacionet e përditësuara dhe që unë të jem i/e ftuar në takime, si dhe të mbahem plotësisht i/e informuar për procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS).

Emri/Mbiemri:	
Organizata/Institucioni:	
Titulli/Pozicioni:	
Adresa postare/Qyteti:	
Telefon/Celular:	
Fax:	
Email:	
Interesi im në këtë projekt:	
Komentet dhe çështjet e rëndësishme: <i>Unë sugjeroj që çështjet e listuara më poshtë, të rëndësishme të investigohen dhe të shqyrtohen në procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social.</i>	
Firma:	Data:

FALEMINDERIT PËR KONTRIBUTIN TUAJ!